

8 SH - 32
A73



novelë

FATOS ARAPI

PATATE EGRA



891.983-32

5

A 73

FATOS ARAPI

PATAT E EGRA

Novelë

~~51890~~

210.

"LIQUTERA E SHKALLËS
GJYKGJAKUËS"

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

GR. 347.

I

Dera e dhomës u hap ngadalë. Mbi qilim rrëshqiti këmba e veshur me çorape të leshta e usta Vangjelit. Pastaj ai vetë i téri hyri brenda. Duke ecur mbi majë të këmbëve, u afroa te shtrati i vajzës. Ajo flinte, e kthyer në një krahë, me dorën grusht mbledhur para fytyrës së vet. Në atë dorë, në errësirën e dhomës, usta Vangjeli pa unazën. Plaku u përkul e, për një çast, qëndroi ashtu. Pastaj u zgjat, po në vend të unazës kapi çarçafin e bardhë. Me të mbuloi supet e zhveshura të vajzës. Ashtu e shtrirë në shtrat dhe e mbuluar me çarçafin e bardhë, Drita iu duk atij më e madhe nga çishte në të vërtetë. Plaku murmuriti diçka me vete.

Ngadalë ai u drejtua te dritarja karshi.

Lumi, si gjithnjë, derdhej atje tej. Nën dritat e forta të llambave të kantierit, i argjendtë, shëndriste e gjarpëronte matanë rrugës, në fushë. Po shushurima e tij nuk ishte më ajo e dikurshmja, nuk ishte ajo që usta Vangjeli kishte dëgjuar vjet e vjet, qysh nga fëminia e tij. Në këtë shtëpi ai kishte lindur, ishte burrëuar dhe ishte plakur. Së bashku me atë të lumit, këtu kishte rrjedhur edhejeta e tij. Dritat e forta të llambave të kantierit, binin mbi valët, që aty shuheshin, aty përfakeshin në kurrizin e lumit, si ca luspa gjigante,

që mbulojnë lëkurën e një zvarraniku të stërlashtë e që usta Vangjeli kur kish qenë fëmijë, nuk i kujtohet mirë, se në cilën ikonë e kish parë. Me çapokët e vet, zvarraniku rrëshqet, e prapë qëndron aty, shtrirë në mes të fushës, ballë drıtares së shtëpisë. Dhe rënkon. Po vëngima e lumit nuk është më ajo e mëparshmjë, e natyrshmja, e njo-hura dhe e dëshëruara qysh në fëmini. Jeta e këtij njeriu rrođhi këtu, së bashku me atë të lumit, **dhe, ashtu si lumi, që derdhet e gjithnjë qëndron atje tej** në fushë, ashtu dhe jeta e tij rrjedh e qëndron këtu, brenda kësaj shtëpie. Usta Vangjeli e njihte shushurimën e gjëmimin e lumit dhe dallonte nëpër të shinë, që kishte rënë diku, apo borën, që kishte filluar të shkrinte nëpër male. Nga gjëmimi i lumit ai mund të dallonte motin, kurse tani ai vjen i përzier e i mbytur me krisma të motorëve dhe aggregateve të tjera të kantierit. Duke qëndruar në këmbë, aty te dritarja e shtëpisë, plaku do të dëshéronte ta dëgjonte edhe tani, si dikur, atë gjëmim të afërt, të njojur e të shtruar, të lumit, po tani ai s'është më. «S'ke ç'i bën! Jeta dhe ajo rrjedh si lumi», deshi të thoshte plaku një mendim kaq herë të dëgjuar. Po aty për aty, në kokën e tij mendime të tjera u ngritën e padashur usta Vangjeli foli me zë: «Jo, jo... jeta e njeriut nuk rrjedhka si lumi...»

Mbështeti fytyrën e vet te parmaku i drıtares. Ftohtësia e drurit e rrënqethi dhe ai mori frymë thellë: «E hoqa edhe këtë mal nga shpatullat» murmuriti duke shikuar thellë në errësirën e natës e duke menduar fejesën e sotme të çupës. «E hoqa dhe këtë mal... Tani ai tjetri le të mendojë për të...»

Ai i mbylli kanatet e dritares.

Nata ishte thyer, po Efigjeni akoma s'kishte rënë të flinte. Lante e pastronte qelqet e pjatat. Usta Vangjeli u ul mbi nim të kuzhinës.

— E hodhëm edhe këtë, o grua... — tha burri.
— E hodhëm, Vangjel.

Plaka mori në dorë një gotë të bardhë kristali, e fshiu, i fryu që të vishej me afsh e prapë e fshiu.

— Mjaft tani, të flemë... — tha burri.
— Unë duhet t'i laj e t'i pastroj këto. Nesër ato që janë të fqinjëve do t'ua kthej, se na thyhen e turpërohemë. Ngjelina na bëri nder të madh, — thotë gruaja, duke e vënë gotën e kristaltë mbi tabakanë e madhe që ka përpara.

— Vjen dita e ja shpérblejmë...
Efigjeni shikon prapë nga i shoqi. Ajo mendon diçka pér dhëndrrin, po atij i thotë:

— More thonë: «ç'bie ora, s'bie viti». Ja, si u bënë të gjitha fët e fët.

— Brinja është brinja, — thotë usta Vangjeli, duke i zvarritur fjalët nëpër buzë, se diçka e sëmboi në zemër. Sot disa herë ajo i është lloko-çitur në kraharon. Po plaku s'i tha gjë njeriu. Të paktën kësaj here s'dëshiron t'i shqetësojë me sëmundjen e vet.

— Ti je i lodhur, bjerë të flesh — tha gruaja. Burri u ngrit.

Efigjenit i kishte pëlqyer shumë dhëndrri. Asaj i kishin thënë se është një djalë i mirë, mësues. Po ndryshe është ta shohësh vetë. Dhe sot sa e pa, ajo ndjeu t'i përpëlitez zemra, sikur të ishte ajo që fejohej e jo e bija. Prej sa vjetësh zemra s'i kishte rrahu ashtu... As ahore, kur ishte

fejuar vetë me Vangjelin. Sa kohë kish kaluar nga ajo ditë? Asaj s'i kujtohej... Bile asaj i dukej sikur jetat gjithnjë kish qenë e këtillë, siç ishte tani. Gjithnjë kish jetuar bashkë me Vangjelin. Po dhëndrrri ishte i mirë. I gjatë e syzi.

«Fati i Dritës», murmurin me vete nëna.

Duke fshirë gotat, kthen kokën e sheh Vangjelin, që del prej kuzhine.

«Shyqyr» thotë ajo me vete. «Të qetësohet pak edhe babai. Tani mendjen e kemi të mble-dhur...»

Asaj i kujtohet prapë dhëndrrri, i gjatë, që, duke mbajtur unazën në njérën dorë, me tjetrën zinte dorën e Dritës.

«Kur është brinja...» përsërit ajo ngadalë fjalët e të shoqit...

Dita lindi e kthjellët dhe e freskët. Nga gryka e lumit frynte një erë e lehtë.

Usta Vangjeli u zgjua shpejt, piu kafenë e i tha së shoqes:

— Nuk është ngritur Drita?

— Akoma...

— Sa të çohet, e rregulloni shtëpinë, se do t'ju vijnë për urim.

Dhe plaku ngadalë zbriti rrugën e ngushtë e të kalldrëmtë. Pas asaj lodhjes së djeshme, tani ndjehej më lehtë:

— Të na trashëgohen!

Ishte usta Miti që e përshëndeti i pari.

— Ju falemi nderit. Në gëzime edhé tek ju...

Usta Vangjeli shkel ngadalë pllakat e bloqet e gurta. Është mëngjerez e ai do të shkojë anës së lumit, në park. Zbret poshtë. Kthehet më të

majtë dhe hyn në rrugën e xhokaxhinjve...

Çupa flinte si shqerrkë dhe asaj i erdhi këq ta zgjonte nga gjumi. «Nëna si nënë» murmuriti me vete e, duke futur duart e veta nën përparëse, u ul te cepi i krevatit.

E bija nuk i ngjante asaj. E gjatë, me fytyrë të hequr, ajo shembellente më tepër me të emën e Vangjelit, vjehrrën, se sa me atë të shkurtër, që edhe në pleqëri kishte një fytyrë të rrumbullakët e gjithë tul. Edhe vjehrra, kur ishte gjallë, kështu thoshte: «sikur e kam pjellë vetë...» Po atë cupë me shpatulla të gjera e kishte pjellë ajo, Efigjeni e vogël dhe e heshtur. «Nuk qahem dot nga nusja, thoshte vjehrra, milingonë është... Kurse çupën e kam pjellë vetë...» Veç Efigjeni e dinte që e kishte pjellë ajo dhe ajo ishte nëna.

Dhe si nënë, brenda mureve të shtëpisë së usta Vangjelit, ajo ishte drithëruar mbi çdo ditë dhe mbi çdo natë të së bijës. E shihte të rritej, të hidhte shtat e të bëhej grua, po fati s'po i dilte gjékundi. Edhe kur i dilte, nuk i mbarohej. Kurse te çupa jo vetëm ndryshonin gjitë e shtati, po gjithnjë e më shumë një shqetësim i brendshëm, i padukshëm e një trishtim i heshtur mbulonin fytyrën e saj. Kur flinte, nëna e shihte më thellë trishtimin e së bijës. Ahere vajza asgjë nuk fshihte dot nga sytë përgjonjës të së emës. Trishtimi çelte mbi fytyrën e së bijës, si një lule nate në errësirë. Efigjeni e shihte dhe dridhej. Çupa vuante, po s'e thoshte.

Kurse një gjumë të këtillë, të kthjellët e të qetë, ajo s'e kish parë veç ahene kur Drita ishte e vogël, e vogël. Thua sikur thellë në fytyrën e saj një shkujdesje e çlodhje lëshonte një dritë të

bardhë e të gjueshme mëngjezore. Vetë nëna ishte e lodhur, dhe, duke parë atë gjumë të thellë të çupës, ndjente se edhe asaj po i rëndoheshin qerpiqët, gjumi i tyre shkrihej, bëhej një...

Ajo u mbështet te cepi i krevatit të së bijës.

Me një palë pantallona të zeza, të gjera, me këpucë e borsalinë të përdorur, usta Vangjeli ecën ngadalë në këtë rrugë të njojur për të. Sa herë shkon këtu, plakut sikur i priten këmbët, e lenë fuqitë e i duket se nuk po shkel mbi gurë, po sikur kridhet nëpër baltë të kujtimeve të veta. Sepse, po të mbyllë sytë e tij të lodhur e mbi ata sy të vëré dorën e tij të madhe, usta Vangjeli e sheh edhe tani këtë rrugë të gjallë, ashtu siç ka qenë aty e 40 apo 50 vjet të shkuar. Po të doni ju, ai edhe tani mund ta shohë këtë rrugë të përlindur, si ahene kur ishte fëmijë.

Sapo fekste, i ati, Leksi, ngrihej e, pasi pinte kafenë në shtëpi, dalëngadalë zbriste nëpër këtë rrugë ku zbret tani usta Vangjeli dhe shkonte e hapte dyqanin e tij të xhokaxhiut. Duke mbajtur fenerët në dorë, në rrugë hynin një nga një mjeshtrat e kallfët e tjerë. Kanatet e dyqaneve hapeshin. Gérshëret e gjilpërat fillonin të punonin. Kurse, kur hoxha këndonte këngën e parë, Vangjeli i vogël, i veshur me një palë pantallona shajaku, merrte nga duart e së ëmës pecetën me bukë e ja çonte babait në dyqan...

Po të mbyllë sytë e lodhur dhe mbi ata sy të vëré dorën e zhurbavitur, usta Vangjeli edhe tani sheh grumbull-grumbull fshatarë, që vinë nëpër ditë pazari e qëndrojnë para dyqaneve mbushur me shajakë e kadife. Ata hynin ku të donin, në cilin

dyqan që t'u pëlqente. Askush nuk ja merrte mysh-terinë tjetrit. Askush s'kishte të drejtë të lavdë-ron-te punën e vet e të shante mallin e mjeshtrit tjetër, pa hyrë blerësi në dyqan të tij. Kjo ishte rruga e xhokaxhinjve dhe usta Vangjeli e mban mend që kur ishte fëmijë, jo vetëm usta Leksin, të atin, po edhe usta Kriston, që kishte, ja, këtë dyqan të vogël, të futur te ky cep i muranës, apo usta Andrenë me atë trup të madh e krahë të shkurtër. «Krahëshkurtëri», si i thërrisin ahore.

Dhe vetë ai, usta Vangjeli, këtu punoi e jetoi. Dëgjohej hoxha. Binte sahati i madh i qytetit. Ashtu fillonte punën dhe ashtu e mbaronte, në aksham prapë me zërin e hoxhës dhe tingullin e vetëmuar të sahatit. Ahore kjo rrugë s'ishte kështu si është tani. Çezma e vogël prej guri ahore rridhte pa pushim dhe mjeshtrat, mbasi hanin bukën nëpër tezgat e punës, venin atje të pinin ujë të ftohtë. Drekës nuk ngjiteshin lart në shtëpi, sepse nuk mund të linin punën.

Tani rrugën sikur e kanë kafshuar përgjysmë. Kantieri rritet ditë pér ditë dhe gjithnjë i këput rrugës së xhokaxhinjve pjesë nga trupi i saj.

Usta Vangjeli qëndroi pak në rrëzë të murit pér të parë buldozerin që gërryente tokën; bashkë me të ai gërryente edhe gjysmën e dyqanit të usta Nikos. Muret e gurta binin me një zhurmë të mbytur, duke shfryrë shtëllunga pluhuri e tymi. Në noçkat e hekurta të buldozerit, dyqani u për-thye sikur të ishte prej kartoni të mykur. Kurse usta Vangjeli e dinte se me atë dyqan usta Nikua kishte ushqyer me nder të pesë fëmijët e vet, gjersa vdiq i sëmurë nga veshkat. Dhe vdiq i ziu ahore kur fëmijët iu rritën pak e mund t'i jepnin

një dorë e ta ndihmonin. «Po ku i dihet kësaj jallane — gënjeshtare...». Ja buldozeri, si ndonjë derr i hekurt, tek po gérhin e palos tani dyqanin e tij. As do t'i kishte shkuar në mend kjo usta Nikos.

Pa shkuar më pas, usta Vangjeli doli nga rruga e xhokaxhinjve. Pensionistët, shokët e tij, akoma nuk kishin zbritur prej shtëpive të veta. Në park nuk kishte njeri. Ai u ul në një fron aty, buzë lumi, ku vala vinte e shtruar, me atë gurgullimën e pérherershme të saj. Këtu, zhurma e kantierit dhe e buldozerëve kishte mbetur prapa. I ulur në fron, usta Vangjeli hoqi kapelën, e férkoi me dorë kokën e vet tullace. Era e mëngjezit, e freskoi. Mbi majën e malit qielli shndritte. Plaku, i heshtur, i nguli sytë rrjedhjes së lumi. Uji ecte si gjithnjë. Asgjë të jashtëzakonshme e të papritur nuk kishte me atë vërshim të pandalshëm. Kushedi sa herë në jetën e vet ai kishte qëndruar buzë lumi. Kishte soditur rrjedhjen. Dhe kështu gjithnjë. Dhe kështu pérherë. Duke ndjekur me sy ecjen e gurgullueshme të dallgës, njeriu harrohej në vetëvete e çlodhej. Dhe tani plaku ja nguli sytë atij uji, që ecte i pandryshueshëm dhe i panjohur me fatet e njerëzve, të rru-gabe e të qyteteve. Lumi rriddhe si gjithnjë, kurse usta Vangjeli, duke ardhur këtu, sikur e mori dhe e solli me vete të gjallë, ashtu siç ishte atëhere, atë rrugën e ngushtë e të kalldrëmtë të xhokaxhinjve. Në kokën e tij akoma dëgjoheshin zërat e usta Andresë dhe të usta Nikos:

— Si shkove sot, usta?

— Ashtu, si gjithnjë...

— Nuk shkon më zanati ynë, — thotë usta

Kristua, me atë trup të imtë e të përkultur përra. Ai përpjek pëllëmbët e veta: — Një kafe me pak, — i thërret kafexhiut, që qëndron më këmbë, te dyqani karshi.

— Kështu e ka zanati sot — thotë usta Andrea ngadalë. — S'të lë frëngu... Kanë filluar të vishen allafranga njerëzit...

— Mos e prish zemrën se zanati zanat éshtë, pa bukë s'të lë kurrë.

Kafexhiu vë filxhanin mbi tabakanë me do-rezë e, sa del te praku i dyqanit, gërvisht me brisk edhe një vijë, në rreshtin ku janë shënuar kafetë hua të usta Kristos.

Te këmbët e usta Vangjelit lumi rrjedh i qetë e i pangatërruar me fatet e njerëzve. Kështu ka rrjedhur ai gjithnjë.

II

Ai që kishte ëndërruar, më në fund u shfaq; ai që kishte kërkuar, më në fund erdhi, ai që kishte pritur, — ja ku ishte më në fund. Po cilin kishte ëndërruar dhe cilin kishte pritur ajo? Qysh atëhere, kur në të po lidheshin ndjenjat e para të femrës, ajo ndjente nevojën pér dikë, e ëndërronte netve në gjumë, bisedonte me të kur ishte e vetme dhe e lodhur. E kërkonte. Në bankat e shkollës i dukej sikur ai që dëshëronte do të ishte ndonjë nga bashkënxënësit e saj. Po kur mbrëmjeve binte në shtrat, kuptonte se te çdo shok i vet mund të gjente diçka të njeriut të dashur e të papërcaktuar. Dhe prapë asnjëri prej tyre nuk

Efigjeni nuk do ta kishte lënë të shoqin plak e të sëmurë nga zemra të zbriste e të ngjitte ato rrugë të gurta, të lodhshme, sikur të mos e dinte se Vangjeli edhe një herë do të shkonte të bisedonte për çështjen e vajzës. Ai do të bisedonte me Lefterin për një dhëndërr të ri. Efigjeni nuk e thoshte këtë para Dritës. Ajo vetëm e pyette të shoqin:

— Do dalësh në qytet?

— Po ç'të bëj...

— Mbështetje del edhe fati ynë... — dhe gruaja pshërëtinte me vete.

Ahere vajza e kuptonte që fjala ishte prapë për ndonjë dhëndërr. Ndonjë mbles përsëri ishte futur e babai do të shkonte të bisedonte me të. Çupa ish mësuar me këto dhe, kur nëna pshërëtinte e murmuriste me vete, ajo e dinte që thoshte: «Mbështetje del dhe fati ynë...»

Dhe para saj prapë shfaqeja ai, njeriu i pritur e i kërkuar. Qëndronte diku, prapa një bisede në kafenenë e mbushur me tym, si nëpër një mjer-gull. Ai qëndronte i heshtur e i trishtuar. Vajza e shihte nëpërmjet asaj mjergulle dhe zemra i rrihte në krahor, si një zog i trembur, — ai të kish qenë?!

Herën e parë kur u bisedua për fejesë, çupa nuk bëzajti. «Këtë punë e ndreq babai», i kishin thënë edhe ajo ish bindur. Po kur mori vesh se «nuk kishin ardhur në një mendje...», siç thoshte Efigjeni dhe se «fati i çupës nuk dihet se ku është...», ahore ndjeu turpin ta mbulojë, ashtu si na mbulon neve hija e zezë e një reje të dëndur, kur fluturon ulët mbi kryet tona. Dhe kishte dashur të thërrasë:

— Askush të mos shkojë e të kërkojë burrë për mua. — E gjej vetë...

Po sytë e zgurdulluar të nënës ishin ngulur mbi të. «Ti s'je pa baba», kishte murmuritur ajo. Dhe çupa kishte heshtur.

Lumi rrjedh i qetë aty te këmbët e usta Vangjelit. Ashtu ka rrjedhur ai vjet e vjet. E njériu, tek e sheh, nuk e kuption se kush ka rrjedhur më shpejt, lumi apo vjetët. Po lumi është lumë, e njériu njeri. Lumi di të gjëmojë i egërsuar g'y-kave të maleve, të rrjedhë e të vërshojë pastaj fushave të gjera. Kurse jeta e njériut... Kthen kokën pas e nuk e kuption se si ka rrjedhur. Vjet, muaj, javë e ditë të zakonshme. Të duket sikur asgjë e rëndësishme s'ka ndodhur në ty. Po koha është e shkëputur, tamam si ai shkëmbi, që shkëputet nga mali e rrotullohet te poshtë.

Jeta e usta Vangjelit, si një lastar i ri, shpërtheu dikur në tregun e jetës së usta Leksit, babait të tij. Dhe kur ky vdiq, Vangjeli vazhdoi të jetojë mbi këtë trung e po mbi ato rrënëjë: shtëpinë, dyqanin, zanatin. Ai s'kishte pse të qahej. Në fund të fundit, Leksi diçka i kishte lënë. Prej të atit ai trashëgoi edhe èndrrat. Sepse edhe èndrrat lihen trashëgim, ashtu si lihet shtëpia, si lihet dyqani, si lihet zanati. Dhe Vangjeli, ashtu si dikur dhe usta Leksi, gjatë gjithë jetës së tij ka èndërruar, që ta zinte pak veten, të blente një dyqan tjetër më të madh. Atij edhe tanë i kujtohet i ati, me atë xhokë shajaku në krahë, tek rrinte mbështetur te dera e dyqanit.

«Eh, ta kisha unë atë dyqanin e madh të usta Ahmetit, pa të më shihnin...»

Po usta Leksi nuk e pati kurrë atë dyqanin e madh të usta Ahmetit. Ai aty vdiq, te dyqani përdhes në rrugën e xhokaxhinjve.

Vangjeli e rregulloi pak dyqanin e të atit, e zgjeroi anash dhe i hapi më tepër dritaret e banakut. Dhe ajo ëndrra e usta Leksit edhe atë e ndoqi pas gjatë gjithë jetës së tij.

«Sikur të kisha një dyqan si të usta Ahmetit. Do të pajtoja 5 shegertë... ahere puna do të shkonte vetë».

Usta Vangjeli mblođhi disa lekë. I hoqi më-njanë. Po erdhë kriza. Papandehur. Në fillim dukej sikur edhe ato ditë ishin të zakonshme. Asgjë e keqe. Gjithshka rridhte njëlloj. Po papritur e pakujtuar qëlloi që leku s'gjëndeje gjékundi. E kërkon. Po ku? Shajakun s'e blente njeri. Fshatarët nuk venin grumbull aty para banakut, të zinin xhoket apo poturet me dorë, duke pyetur për çmimin e tyre. Ata vetë endeshin rrugëve të qytetit për të shitur një kosh fiq dy lekë e gjysmë. Dhe s'ua blente njeri.

Usta Andrea del jashtë dyqanit e kur sheh atë myshteriu, që hyn në rrugën e xhokaxhinjve, i thërrret:

— Hajde këtu, myshteri... malli është më i mirë dhe më i lirë... — Dhe i del përpara që ta fusë në dyqanin e vet. Po përpara se të shkosh në dyqan të Andresë, duhet të kalosh dyqanin e Kristos. Dhe ky myshteri, sikur të mos i dilte përpara usta Andrea, do të shkonte e të blente te usta Kristua.

Usta Andrea bëri poshtërsi që i thirri dhe i doli përpara myshteriut. Prandaj usta Kristua rrëmbeu drurin e qepenit e me të në dorë hyn në dyqan të usta Andresë. Dhe ja jep me hu...

— I poshtër — thërret Kristua.

— I poshtër je ti.... — jo unë — përgjigjet Andrea.

Dhe fillojnë të rrihen e të gérthasin, aty para dyqaneve në rrugën e xhokaxhinjeve. Mjeshtrit e tjerë i shohin e s'lëvizin nga vendet e tyre. Rruga e xhokaxhinjeve sheh e s'bëzan.

— Andrea bëri poshtërsi...

Kjo është krizë. Dhe kriza hëngri edhe ato pak pare të usta Vangjelit. Pastaj erdhi lufta. Dikush fitoi, dikush humbi. Fituan tregëtarët e matrapazët, po xhokaxhinjtë... ç'të fitonin ata? Të gjithë, fshatarë e qytetarë, u veshën me rroba ushtarakësh. Ku mbeti për xhokaxhinjtë! Ata vetë shkonin punëtorë, për të ndrekur rrugët.

Po usta Vangjeli e dinte ç'do të thoshte punëtor. Leksi, i ati, i kishte thënë: «Në zanat, prapë je në zanat... Kurse argat, ja ke shitur lëkurën atij tjetrit». Dhe usta Vangjeli nuk ja shiti lëkurën e vet kurkujt. Me atë dyqanin e vogël të tij e nxori luftën. Bëri si bëri, po dyqanin e mbajti. Dhe ai nuk e la pa bukë. Pak-pak. Po prapë në punë të tij. Zanati që i la trashëgim i ati ishte i bekuar.

Pas çlirimt u ngrit kooperativa. Tashmë usta Vangjeli ishte plak njeri. As këmba, as dora nuk i punonin, si më parë. Pastaj zemra... veç ai donte që ashtu si ai, Vangjeli, u rrit mbi trungun e jetës së të atit, ashtu dhe djali i tij, Pirrua, të hidhte rrënjet e tij në trungun e jetës së babait

të vet. Ëndrrat edhe ato lihen trashëgim, ashtu si lihet shiëpia, dyqani e zanati. Dhe usta Vangjeli do t'ja linte Pirros zanatin e ëndrrat e veta. Kushedi, me zanatin e të atit në dorë djali mund të shihte dritë. Prandaj, kur plakut i thanë që të hynte në kooperativën që po hapej, ai tha: «Mirë, po do të marr edhe djalin që t'i jap zanatin...» «Merre», i thanë. Po Pirrua nuk deshi. U bë luftë e madhe në shtëpi. Ustai edhe e rrahu të birin. Ashtu i rrithnin çirakët në atë rrugën e xhokaxhinxve. Po djali s'pranoi:

— Do të vazhdoj shkollën — thoshte.

Eh, si rrjedhjeta e njeriut! Ja, kështu sì lumë nën këmbët e plakut. Po lumi është lumë, kurse njeriu është diçka tjetër. Do të ishte mirë, sikur edhejeta e njeriut të rridhete ashtu e qelë dhe e patrazuar. Po jeta është jetë. E në të çdo gjë mund të ndodhë.

«Do të shkoj në shkollë» thoshte djali. Kurse i ati e dinte që Pirrua s'para e kishte qejf shkollën. Pastaj «shkolla vërtet është shkollë e të hap sytë, po bukë ajo s'të jep. Që të kesh gjithnjë koromanen, prapë duhet t'i lësh krahët diku. Prapë çirak i tjetrit je. Kurse zanati është «zanat». Në zanatin tënd je usta. Më tepër shkollë Pirros s'i duhet. Të vazhdojë tani zanatin tim, ashtu si unë, atë të usta Leksit. Kjo është jeta».

Po djali s'donte dhe usta Vangjeli u helmua. — Kurse me çupën, puna është ndryshe. Ajo është femër e femra është risku i atij tjetrit. Ajo do të shkojë të hapë shtëpinë e burrit.

— Të na trashegohen, Vangjel.

— Në gëzim edhe tek ju.

Një shok i tij pensionist vjen e ulet aty buzë

lumit, në froniñ ku është ulur edhe Vangjeli.

— U gjëzuan shumë, — thotë ai ngadalë. —
Për atë fanua çupë më tepër . . .

— Gëzim paçi.

— Edhe dhëndrrri qenka i mirë, siç na thanë.

Herë-herë ai është flokëzi, herë-herë flokë-verdhë. Këtu ka qenë djalosh i shkathët, atje burrë i pjekur. Po gjithnjë ka mbetur pér ty i papërcaktuar e ti vetë nuk e ke ditur mirë, se cili qenka ai, njeriu që e pret me vjet të tërë. Nëpér këtë jetë ti ke ndjerë të folurit e tij, ke dëgjuar të qeshurit e tij. Po cili është ai? Ti ecën drejt tij e çdo ditë që kalon, e afron atë pranë teje. Dhe prapë mbetet larg. I papërcaktuar. Kur ja, në mes tē kësaj qetësie të dhomës të mbushur me të ftuar, ti e sheh atë ashtu siç është, ashtu siç duhet të jetë ai, i gjatë, me një fytyrë të vogël të skalitur si në bust, me unazën e florinjtë që mban në dorë e vjen drejt teje. . . Dhe ti ndjen se thellë në ty diçka po lëkundet, po gurgullon. Drejt teje vjen ai njeriu i pritur, i kërkuar e i dëshëruar. Ai i pakapshmi, i papërcaktuari, vjen drejt teje i gjallë, real, konkret. Dora e tij kap dorën tënde, që dridhet . . .

Dhe ti e ndjen: s'je më ajo e djeshmja. Diçka ka ndodhur me ty. As vala e lumit, që rrjedh atje tej, s'është më ajo e djeshmja. Duket se nga malet ka rënë shi dhe lumi nuk është i kthjellët, si dje. Ai rrjedh i rrëmbyeshëm dhe i turbullt. Ti s'je më ajo e djeshmja. Tani ti e di, se kudo të kesh qenë dhe pér cilindo të kesh ëndërruar, vetëm drejt këtij njeriu ke ecur. Gjithë ata djelmoshë apo burra, bjondë e sykaltër, shpatullgjerë e të gjatë,

kanë qenë si udhërrëfyes. Nëpërmjet këtyre, ti shkoje vetëm drejt këtij.

Kur u zgjua Drita pa të ëmën, që po flinte aty te fundi i shtratit të saj.

III

Të fejuarit i bënë një vizitë teto Nastës. Kjo i gostiti me liko, llokum e kafe. Pastaj ata shkuan te nënë Cija.

— Edhe te xha Aliu, s'mund të rrini pa vajtur — u thoshte Efigjeni. — Fatimeja, e shoqja, do të më zemërohet. — Dhe të fejuarit shkuan edhe atje. Ata shkuan edhe te xha Yzeiri, edhe te xha Nikua. Kurse te teto Dhoksia akoma nuk kishin vajtur.

— Ajo do të zemërohet — thoshte Efigjeni.

Iliri e Drita dëgjonin të heshtur.

— Dhoksia është e vetmja që i ka mbetur Vangjelit nga gjaku i tij.

Të rintjtë dëgjonin e heshtnin. Efigjeni e kuptonte, që ata ishin lodhur me këto vizita. «Po duhet bërë zakoni...», thoshte ajo me fytyrën kuqaloshe, gati duke u lutur.

— Të lutem, — i tha më në fund vjehrра dhëndrrit, — sot Dhoksia ju pret, si të mos i veni?

— Po mirë, — i tha Iliri së fejuarës, — ne kemi shkuar kudo, pse të mos shkojmë edhe atje?

Kur të rintjtë kapërcyen portën e shtëpisë, Efigjeni u mbështet mbi parmak të drithares, ashtu si dielli mbështetet mbi kodrat e qytetit, në të perënduar të tij. Të rintjtë ngadalë filluan të zbresin rrugën poshtë. Efigjeni i ndiqte me sy gjer sa ata humbën tutje në kthesë. Nëna nuk luajti nga dri-

tarja. Qëndronte atje e heshtur dhe e menduar. Dhëndrrri i hyri asaj përnjëherësh në zemër sa tani plaka nuk mundkish ta ndante dot atë nga Pirrua, i biri. Kurrë nuk e kishte menduar këtë. Në atë mbrëmje vjeshte Efigjeni ndjeu një gjësim të ngrohtë në shpirt dhe nuk lëvizi që aty nga dritarja.

Kurse të fejuarit kishin arritur para shtëpisë së teto Dhoksisë. Te dera kishin dalë e i prisnin vetë plaka dhe i shoqi i saj, xha Nasi. Ata i puthën «fëmijët» në ballë.

— Të na trashëgoheni e ju falemi nderit që na shkelët në shtëpi.

Pastaj të gjithë bashkë u ngjitën lart. «Ki kujdes», i tha Nasi Ilirit duke i treguar parmakun e shkallëve të drunjta që po ngjitnin «mos përpjekësh kokën këtu», tha ai duke treguar me dorë një tra të madh, të ngjyer me kafe. «Shyqyr ti, dhëndërr, qenke i gjatë...».

Dhe, ashtu duke qeshur, i futi në dhomën e madhe të pritjes. Sa u ulën, shtëpia u mbush me fëmijë e gjitonë, të cilët sakaq e morën vesh vizitën dhe u derdhën atje. Teto Dhokzia nuk i përzuri. Përkundrazi me sytë e saj ajo i përgëzonte fëmijët e vegjël.

— Unë ju kam pritur të më vinit — u tha plaka të fejuarve.

E ulur në karrigë, e veshur gjithë me të zeza, ajo fliste ngadalë.

— Edhe ne kemi dashur të vijmë... po prisnim që të ishim më të lirë e më të qetë.

Iliri e shikoi me habi Dritën. Ai nuk e priste atë përgjegje të së fejuarës. Po teto Dhokzia e falënderoi të mbesën. Dhe me zemrën e vet të dhemshur, filloi t'i pyesë të rinjtë për shëndetin, për punën e për njerëzit e tyre.

— Vangjeli si éshtë?

— Më mirë duket.

— E po shyqyr...

— Po Efigjeni?

— Mirë éshtë... tē fala keni.

— Falemnderit... Tē fala pastë.

Pastaj biseda ndërpritej. Qetësi. Ndërsa çamarokët e mëhallës venin e vinin nëpër shkallë e në dhomë.

— Nga Pirrua keni marë letër? — pyet xha Nasi.

— Pregatitet për provimin, prandaj s'na ka shkruar. Po në telefon kemi biseduar...

— Po për fejesën e lajmëruat?

— I bëmë telegram.

— E po mirë...

Plaka vendos dorën e saj tē majtë mbi gju e pastaj mbi atë dorë vë edhe tjetrën. Ahere një nga nuset e mëhallës u nxjerr miqve likonë e llokumet.

— Për tē mirë, — dhëndrrri vetëm tanë foli.

— Tē na trashëgoheni.

Ahere teto Dhoksia ngadalë, po pa harruar asgjë, e pyeti dhëndrrin për emrin, për moshën, për prindërit, a kishte vëllezër dhe sa, po motra, po mbesa, a ishin tē bucura ato dhe a ishin tē fejuara, apo tē martuara, sa fëmijë kishin dhe ku punonte ai dhe kur do tē martoheshin...

Ata mbetën tē dy, tej shtëpisë, në rrugën e kalldrëmtë tē teto Dhoksisë. Ata dhe nata, që tanimë ishte shtrirë mbi qytet e errët dhe e madhe. Pas fejesës ishte hera e parë që mbeteshin vetëm. Gjithnjë nëna, gjithnjë babai, gjithnjë tē njohurit. Papandehur ai e kapi atë prej dore. Ajo u drodh,

sikur një flakërim vetëtimash t'ja përcëllonin trupin. Ai e tërhoqi dhe ajo i shkoi pranë. Zbritën përposh rrugës. Qytetarët kishin filluar të kthehenëshin për në shtëpitë e tyre.

«Tani jemi vetëm», tha ai duke afruar kokën e vet te flokët e saj të butë. Zëri i tij nuk ishte i mëparshmi. Ai fliste ulët, me një zë të dridhshëm e të mbytur në vetëvete. Ajo s'përgjigjej. Ashtu ecën ata një copë herë.

— Thuajmë diçka — i pëshpëriti ai prapë të veshi, me atë zë të ulët e të panjohur.

— Ç'të të them... unë nuk di...

Ajo deshi të thoshte: «Unë nuk di ç'të të them tani...» po ai s'e la. E ndali dhe e ktheu me fytyrë drejt vetes.

— Si? — tha duke qeshur — ti nuk di?! Dhe ja dha prapë të qeshurit. Ishte një e qeshur e gëzueshme dhe e papërbajtur.

— Domethënë ti s'di... — dhe duke e shikuar atë në sy, ai i zgjati dhe u mëshoi fjalëve me qëllim.

— Unë s'desha të të them atë... — tha ajo. Po në atë çast ai e kapi fort nga koka dhe e puthi.

Për herë të parë atë e puthte një mashkull. Ajo ishte e puthura e parë, e pritur dhe e ndezur nga fantazia. Po asaj iu duk e ftohtë, e akullt. Kurse ai, duke e mbajtur prej dore, filloj të bridhët nëpër rrugë e ta tërhiqte pas:

— Hajt...

— Ku? — pyeti ajo ngadalë.

— Ku të jetë... sonte...

— Sonte do të kthehem i në shtëpi — tha ajo duke e shikuar në sy.

— Sonte nuk kthehem i në shtëpi — tha ai.

Si ecën edhe pak, ata u kthyen e u futën në një rrugë të ngushtë. Mbi ta ngriheshin grumbull shtëpitë, që lëshonin shtat njëra mbi tjetrën. Në errësirën e natës, godinat ngriheshin mbi rrënjet e tyre të bardha. Dhe mbi këto rrënjet ato lëshonin degë të dendura, që bashkoheshin e shkriheshin njëra me tjetrën dhe, duke u shtrirë gjatë rrëzës së malit, mplekseshin e krijonin mëhallën e qytetit të dikurshëm. Ashtu e vjetër, mëhalla, me rrugë të ngushta, kishte ardhur gjer në kohën tonë. Ata u futën në ato rrugë. Papritur ai qëndroi. E kapi dritën nga supet dhe e vendosi në cep të një muri kulle të vjetër. Vetë i ktheu shpatullat rrugës. Ajo e pa me habi, po ai pëershkoi gishtërinjtë e tij nëpër flokët e saj. Gishtërinjtë mplekseshin nervozë nëpër bishta flokësh sikur diçka kërkonin, kurse ai u ul mbi të e diçka i murmuriti. Ajo s'e kuptoi. Edhe ai e mori vesh që ajo s'kuptoi gjë, e, megjithatë, prapë vazhdoi t'i murmuriste. Më në fund ai qeshi, me atë të qeshurën e parë të gëzueshme, të pandalshme. Ahere ajo e kuptoi: gjithshka kishte ndjerë gj'er atë çast pér atë njeri, kishte qenë vetëm një topitje. Dhe në atë topitje, si në një kazan, llokoçitnin edhe druajtja, edhe mosbesimi, edhe dëshira edhe neverija kundrejt atij njeriu të huaj, kundrejt vetë të panjohurës drejt së cilës shkonte dhe prej së cilës prapë diçka e mbante larg e i rëndonte e qullur me atë të puthurën midis dy buzëve të veta. Instiktivisht ajo zgjati krahët dhe e afroi pranë vetes. Frymëmarrjet e tyre u përzien. Ajo ndjeu që po humbte midis mureve të gurta e të trasha të asaj mëhalle të vjetër.

Drita u zgjua dhe, e shtrirë në shtrat siç ishte, duke hedhur sytë nëpër muret e dhomës, kujtonte fjalët që Lauresha i kishte thënë ditën e fejesës, kur njerëzit ishin larguar prej dhome. «Tani hiqi këto... tjetër jetë duhet të hyjë këtu...»

Një tufë fotografish të vjetra qëndronin brenda një kornize të madhe e të rëndë prej druri. Kushterinj, kushërimi, një ushtar pa armë i ulur në karrigë, me kapën që i varej mbi gjysmën e ballit, sikur do t'i binte nga një çast në tjetrin; në dy zemra dy fytyra të bashkuara, njëra grua, tjetri burrë... dhe midis tyre, me atë syun e ndezur të saj, teto Lena. Ishte ulur në karrigë. Pas saj, si sfond në mur, varej një qilim i zi. Që nga fotografia teto Lena, me atë noçkë të fryrë, ja kish ngulur sytë Dritës aty në shtrat e s'ja hiqte. Kurse ajo edhe tani e mbante mend atë të gjallë, me zërin prej këmbore. Pa zbardhur dita, ajo vinte aty, në mes të oborrit të shtëpisë e thërriste:

— Efigjeni, Efigjeni moj, ngreu, moj korbë, se erdhi dreka.

Në të vërtetë akoma s'ishte gdhirë.

— Si flini, moj xhane, ku e gjeni gjithë këtë gjumë — thërriste teto Lena, me zërin e saj këmbanë. — Si s'ju vjen turp, xhanëm. Dhe ajo shkonte e vinte nëpër rrugë duke i thirrur kones së vet: — Balo! balo! Ku je, o ditëshkurtër! Ty do të të ndjek pas, që të të jap bukë?.. balo! balo! balo!

Ahere ndonjë grua e mëhallës hapte dritatën.

— Plaq — i thërriste ajo teto Lenës. — Flamë. Zgjon mëhallën, që me natë...

— Ngreuni, pela...

Tani ajo, teto Lena, që nga fotografia, i kishte ngulur sytë e ndezur Dritës. E shikonte e sikur i thoshte: «Ngreu, pelë... ku e gjen gjithë këtë gjumë?...»

Në anë të majtë, në mur, qëndronte, e vetme, fotografia më e madhe që gjëndej në dhomë. Në të, të ulur në karrigë, bri njëri-tjetrit, qëndronin gjysh Aleks i gjyshe Aspasia. Gjyshja, nën dorën e majtë, të lëshuar mbi gju, mbante një shami të bardhë, kurse gjyshi, i veshur me shajak, këpucë të reja, me një qylaf të zi dhe me një zinxhir qosteku sahati, që i varej nga xhepi i vogël i jekut. Gjyshja kërkonte të shihte pak nga gjyshi, po ky vetë shikonte diku larg, pa u kujdesur për njeri.

Në faqen e murit përpara ishte shtrirë një qëndizmë me një dre. Kur kishte qenë çupë, atë e kishte qëndisur dhe e kishte prurë pajë Efigjeni. Dreri kishte shtrirë qafën drejt tokës, me sa dukët, që të kulloste, po bar gjékundi s'shihej.

Me kokën mbështetur mbi krahët, Drita shikonte e çuditej me atë botë të vjetër, që varej aty nëpër mure e qëndronte, frysëmerrte e jetonte brenda atyre kornizave të drunjta. Ajo nuk i shihte për herë të parë. Që kur ishte e vogël, që kur e mbante mend veten, fotografitë aty kishin qëndruar, në ato vende, të patrazuara. Vetëm ato që griseshin, apo i prishnin mizat, i hiqnin. Dhe vinin të tjera, sepse korniza e madhe duhej të ishte gjithnjë e mbushur. Edhe vetë ajo, Drita, ka varur aty fotografinë e klasës së saj. Së edhe ajo vetë është një pjesë, një fytyrë brenda asaj kornize të drunjë, të rëndë e të vjetër. Sa herë

që pastrohej dhoma, shkundej gjithshka. Edhe fotografitë pastroheshin nga pluhuri e prapë vareshin aty në kornizën e madhe. Çdonjëra prej atyre fytyrave të ndryshme, të përhershme në heshtjen e tyre, çdo lëvizje e vetullave apo picërrim i syrit, tkurrja e vijzës së cepit të buzës, apo dridhje e mjekrës — ishin stamposur në trurin e Dritës, si format naivë të një mblaci mbi brumë. Po vetëm tashti asaj gjithshka po i dukej i zbetë, pa shije, thua sikur sot po i sheh për herën e parë.

U ngrit prej shtrati. Veshi fustanin. Pastaj shkoi te korniza e madhe, në të djathtë, e filloj tē zgjedhë ndër ato fytyra, të zverdhura nga koha e nga harrimi. Fotografinë e teto Lenës nuk e hoqi menjëherë. Syri i pishtë, i ndezur i plakës, e trembi dhe iu duk sikur, sa ta prekte atë fotografi, përnjëherësh do të gjëmonin gjithë këmbanat e qytetit. Por pastaj ajo e rrëmbeu. Asgjë s'ndodhi.

Dhoma sikur u bë më e madhe. Ajo mori fshesën në kuzhinë e filloj tē fshinte ato hije të përhime pluhuri, që kishin lënë kornizat mbi muret. Pastaj u ul e menduar mbi karrigë. Ja nguli sytë qilimit. Ai ishte i trashë e i ashpër, por i dendur, me disa katrore si gurë kalldrëmi të vendosur radhë-radhë. Në këtë qytet tē gurtë, edhe brenda në shtëpi ajo duhej tē ecte nëpër gurë. Dhoma gjithnjë rrinte e shtruar me këtë qilim. Po tani asaj diçka s'po i pëlqente. Ata katorë gurësh i qëndronin para syve tē rëndë e tē palëvizshëm. Sikur tē kishin rënë një herë e për gjithmonë aty para saj. Kurse tani ajo do tē dëshéronte që ata tē ishin zaj tē bardhë e tē lehtë, tē lëvizshëm, si ata tē lumit që rrjedh. Herë tē tjera kish shkelur me këmbën e butë mbi ta. Kurse

tani i pengoheshin në këmbë. Do të dëshéronte të hiqte atë qilim, po me se do ta shtronnte dyshemenë? Ngadalë e mblodhi qilimin dhe e nxori jashtë. E nisi të lajë dhogat me gjithë fuqitë e saj. As krevati nuk ishte në vendin që duhej. Aty, në cepin e fundit, ku ishte vendosur, ai jo vetëm që e shëmtonte dhomën, po nuk e linte të shihte, veçse këto mure. Kurse pranë drifores mund të shihte edhe qiellin përjashta. Dhe tani ajo kishte nevojë edhe për qiellin.

Kur Efigjeni hyri në dhomë, Drita po ngrinte krevatin.

— Ç'bën ashtu?

Vajza nuk u përgjegj. Efigjeni shkoi përqark muret.

— Pse i ke hequr fotografitë? — e pyeti nëna.

— Eja e më ndihmo të ngremë pak krevatin.

— Ku do ta shpriesh?

— Pranë drifores... — Ajo deshi të thoshte «Dua të shoh yjet natën», po s'foli.

Efigjeni shkoi ta ndihmonte të bijën. Që kur ishte fejuar, ajo bënte ç'të donte dhe nëna, e heshtur, e bindur, nuk ja prishte.

— Fotografitë duhen vënë prapë në vend. Muret s'mund të rrinë kështu të zhveshura. Ç'është kjo?!

— Do t'i mbulojmë — tha e bija duke murmuritur me vete.

Ngadalë e vëndosën krevatin dhe Drita kërkoi që koka e tij të binte pranë drifores. Pastaj ato shtruan qilimin. Vajza nuk donte që ai të mbulonte gjithë dhomën. Efigjeni edhe tani deshi t'i thoshte së bijës se nuk bën dhe s'është mirë që një pjesë e dyshemesë të mos mbulohet, dhogat

të mbeten zhveshur e miqtë të shkelin më dërrasë. Po nuk tha gjë. Në këmbë, e heshtur, ajo shihte të bijën, që me vete jepte e merrte, se si do ta shtronnte atë qilim të madh e të ashpër, që gurët e tij të mos i pengoheshin më në këmbë. Më në fund Drita e mbështolli atë tri cepash, pothuaj se gjer në gjysmën e dhomës.

— Edhe kështu s'është mirë — tha ajo, — po të paktën ata gurë sikur u rrokullisën nga vendi.

Efigjeni pa qëndizmën e drerit hedhur mbi karrigë. Dhe pranë saj fotografia e madhe e vjehrrit dhe e vjehrrës. Gruaja u zbe e u kullua në fytyrë.

— Moj, ti... — i tha së bijës. — Atë fotografi aty e ka vënë me dorën e vet yt atë...

E bija s'bëzajti, Lëshoi në mesin e dhomës tavolinën e vogël e shkoi të këputte lule në vazot e oborrit. Ahere edhe nëna doli nga dhoma e shkoi në kuzhinë të merrej me punët e veta. Drita vendosi mbi tavolinë një tufë lulesh. Vërtet shtëpia dukej disi e zhveshur. Po, sidoqoftë, më mirë kështu. Ajo botë e vjetër, naive, e ngrënë dhe e gërryer nga kohërat, që e rrethonte në mëngjez dhe brenda së cilës ajo kishte jetuar, sikur u zhduk. Të paktën tanë dhoma ishte e freskët, plot ajër e dritë.

Iliri i pruri një portret të tij. Ja kishte piktuuar një shok. Të dy e vendosën atë në mur, përkundrejt krevatit. Pastaj Iliri gjeti edhe një kuadër të bukur të Llogorasë. Dhe në dhomë gjithshka u përtëri.

— Më ndryshe është tanë — tha ajo duke parë ndryshimet që kishte bërë dhoma.

— Krejt e re — tha Iliri duke qeshur. Dhe

u afrua pranë saj. — Shumë mirë e mendove...

— Unë as që mendova gjë — tha ajo. — Lauresha më tha e kur u zgjova sot, ndjeva se gjithshka, që më rrighthonte, po më merrte fryshten.

Në darkë, pasi përçollti të fejuarin, ajo u kthye në shtëpi. Po kur hyri në dhomë, papritur e pakujtuar u gjend midis një bote të panjohur përtë. Megjithëse çdo gjë atje e kishte vënë e rregulluar vetë, prapë ambienti i mëparshëm, i ngulur me vjet në ndërgjegjen e saj, ishte rrënjosur aq, sa ajo priste t'i dilte përpara po ai dreri i vogël, që kullotte në tokën e zhveshur e po ajo kornizë e madhe e mbushur me lloj-lloj fotografish të vjetra. Ky nuk çante kokën për njeri. Ajo do të hynte midis këtyre fytyrave, kur papritur e pakujtuar, para saj doli një dhomë e madhe, e re, e përtëritur. Drita hyri në të duke ndjerë një çlodhje gëzimi. Dhe përnjëherësh pa portretin e vogël.

Ngjyrat e kuqe, të verdha e blu përziheshin e, duke u shkrirë, krijonin një sfond të ndezur, që dukej se, po të mos ishte i largët e i thellë, do t'i derdhë ato ngjyra në tërë bardhësinë gëlqerore të murit. Në gjithë kuadrin kalonte një tis i hollë gri, i ngrohtë, e nëpër të vetë Iliri qëndronte i papercaktuar e i pakapshëm. Thua sikur humbiste në atë sfond të kuq e gri. Nën dritën e llambës së elektrikut, përzierja e atij sfondi me vetë portretin ishte më e dashur përtë.

Drita u afrua më pranë. Qëndroi para tij për një kohë të gjatë. Po Iliri ishte prapë i largët e i pakapshëm. Përshtypja e parë kishte qenë më e forta dhe më e pandryshueshmja.

Kur u shtri në shtrat, përnjëherësh, mbi kokë të saj, u afrua nga pafundësitë, një copë qelli, me madhësi e formë të dritares, e mbushur me kokrriza të panumërtë yjesh, që digjeshin nën një vello të hollë, reje. Vajza mori fryshtë thellë. Iu duk sikur vetë ajo ishte një copë e atij qelli e sikur ata vi të vegjël vezullonin diku, në pafundësinë e shpirtit të saj. Sa pak kishte kërkuar e sa pak gjëra i duheshin në jetë, që të ishte e lumtur! Kishte ardhur Iliri. Me dorën e tij kishte lëvizur brenda në shpirtin e saj diçka të vogël, fare të vogël, e përnjëherësh turbinat e mëdha të gëzimit njerëzor ishin vënë në lëvizje. Dhe ajo shihte tani brenda saj të ndizej një dritë e bardhë, si në zemrën e natës ndizet agullimi.

Dhe fjeti.

Shtëpia e usta Vangjelit është shtëpia e «usta Vangjelit». Dhe të gjithë e dinë që ustaj është usta si në dyqan, ashtu edhe në shtëpi. Kështu ka qenë qëmoti e kështu është edhe tani, që ustaj është plak e dora s'i punon më. Po shtëpia e tij edhe tani duhet të jetë e rrrethuar me një mur të trashë e të rëndë, me një oborr të vogël, ku janë mbjellë dy kumbulla e një fik dhe ku njeriu ecën në një kalldrëm të ngushtë, të shtruar me gurë të bardhë, që janë zbardhur më tepër nga të larët e Efigjenit. Anës së kalldrëmit janë mbjellë lule lloj-lloj. Dy dhoma. Në njérën fle vetë usta Vangjeli me të shoqen, në tjetrën flinin fëmija. Tani atje fle vetëm Drita. Kjo dhomë shërben edhe si dhomë pritjeje. Një kuzhinë, një sobë, një musandër, një dollap. Dhe gjithshka që duhet të ketë shtëpia. Çdo send është në vendin e vet. Dora e usta Van-

gjelit e ka kapur dhe e ka vendosur këtu kusinë e madhe të bakërtë e sininë, atje damixhanën e vajit e të uthullës. Dhe ahere kur këtë e kanë bërë duart e Efigjenit apo të Dritës, mendja e urdhëri kanë qenë të usta Vangjelit. «Edhe dhëntë kanë një përçor, e jo pastaj shtëpia». Ustai është usta, si në dyqan ashtu edhe në shtëpi.

Vetëm djali, Pirrua, nuk e dëgjoi Vangjelin, kur ky donte t'i jepte zanatin e vet.

— Xhokaxhi? — kishte thirrur djali, duke zgjatur para të atit qafën e tij të gjatë e të hollë.

— Pse, si të duket ty?

— Mos u çmenda unë?! Sot...

— Sot e mot zanati është.

I biri queshte.

— Zanati... — Pirrua ngërdheshesh mbi fjalët që thoshte. — Pse, s'paska zanat tjetër, më të mirë se të xhokaxhiut?

Kur pa atë ngërdheshje, Vangjeli u platis. Gjithshka u shua në të: krenaria për mjeshterinë e vet, këmbëngulja që t'i jepte të birit zanatin e dikurshëm të familjes. Vangjeli u ftosh, si ftohet një trup, që vdes. Dhe sapo i biri u largua nga dhoma, plaku lëshoi kokën e këputur mbi kraharon.

Që zanati i tij po perëndonte, ai e kishte kuptuar prej kohe. Ku ishte ajo rruga e njëherë motit e xhokaxhinjve, që gjëmonte nga mjeshtrat, çirakët e myshterinjtë, e ku tani, ajo karakatinë në noçkat e buldozerit.

Sa herë që kalonte atje, ai ndjente se si mbresat e kujtimet e jetës së dikurshme të asaj rruge rendnin të frikësuara përparrë gërhimës së hekurt të buldozerit e të ekskavatorit e vinin, e, si në

një istikam të vjetër, strukeshin aty, në kafkë e në krahëror të usta Vangjelit. Gjithshka kishte perënduar për ata, xhokaxhinctë. Bota ishte ndryshuar. Edhe sikur të mos donte, usta Vangjeli s'kishte si të mos i thoshte e t'i kuptonte të gjitha këto. Por që vetë pjella e tij, Pirrua, të mohonte zanatin, që i kishte dhënë bukën e gojës... Plakut iu duk sikur fëmija, që i qëndronte përpara me atë hundë të vogël, të hakërruar, me ata flokë të shkurtër, të ashpër, po mohonte duart e zhurbavitura, djersën që kish qullur ata 70 vjet jete, ashtu siç kish qullur edhe këmishën e trupit të tij.

— Mos ja verë veshin, Vangjel, — i tha ahere Efigjeni. Dhe ajo iu afrua burrit dhe u ul pranë tij. — Mos ja vërë veshin... ata janë fëmijë e s'dinë se ç'flasin...

Vangjeli heshtte. Por në heshtjen e vet kishte vendosur: që andej e tutje për atë, Vangjelin, për atë, të atin, Pirrua kishte vdekur. Edhe sikur të mos kishte vdekur, prapë i gjallë nuk ishte...

I biri mbaroi maturën, u nis në universitet e prej andej herë-herë dërgonte nga një letër në shtëpi. Atyre u përgjigjej vetëm Drita. Dhe ajo i shkruante në fund të çdo letre: «Nga babai të fala... me zemër si gjithnjë...»

— Le të mendojë vetë, — i tha Vangjeli ngadalë së shoqes duke e ngulur shikimin mbi filxhanin e kafesë që po mbante në dorë.

Kurse Drita ishte ndryshe. Ajo ishte femër e Vangjeli sa mbaroi shkollën e mbylli menjëherë në shtëpi. Shumë shoqe të saj vazhduan kurset. Kombinati kërkonte punëtore. Çupa edhe ajo donte të punonte. I ati ja preu atë rrugë.

— Ç'është kjo ethe për të punuar në punë të huaj? — i tha.

— Jo «të huaj», të shtetit tonë — thoshte e bija...

— Një lloj është. Ti je e vogël e nuk të kanë rrahuur dallgët e jetës.

— Po, baba...

— Gjersa puna nuk është jotja, gjersa nuk punon në shtëpinë, apo dyqanin tënd, e huaj është... Nuk e ke provuar ti sa e hidhur është puna e argatit.

Efigjeni dëgjonte dhe heshtte. Me duart nën përparëse, e ulur atje mbi nim të kuzhinës, Efigjeni heshtte. Ajo e njihet mirë të shoqin.

— Edhe Vera e usta Kristos shkoi — i thoshte e bija Vangjelit.

Efigjeni tundte kokën.

— Edhe Natasha e xha Mehmetit punon. Të gjitha... vetëm unë...

Efigjeni tundte kokën, kurse Vangjeli nuk e kuptonte se si ata baballarë «të mirë» venë e lenë çupërlinat të dalin nga dyert e shtëpive e të punojnë «argate». Usta Vangjeli nuk e kuptonte këtë. Kur bisedonte me shokët e vet, anës së lumit, tek rrinte e çlodhej, apo në kafene, e dëgjonte se gjithë ato çupa familjesh të mira po hynin në punë, plaku heshtte, nuk flitte, po me vete bluanë e bluanë mendimet.

Bota ndryshonte. Edhejeta e tij po ndryshonte. Ai e ndjeu këtë edhe në ata pak vjet që punoi në kooperativë. Tjetër jetë. Nuk e kuptonte mirë atë, po tjetër jetë. Edhe njerëzit përreth, zanatçinjtë e dikurshëm ndryshonin. Ai vetë tanë Pirros nuk i mbante mëri, pse djali nuk mori zanatin e tij, po pse ai, nuk e dëgjoi babanë plak. I ktheu

fjalën. Kurse çupa është delikate. Të tjerat le të bënин si të donin. Ai vetë akoma nuk kish shkuar në atë gjendje sa të kërkonte të shquhej nga ato dy duar të së bijës. Usta Vangjeli e kish pér detyrë që ashtu të pacënuar ta conte atë te burri. Kjo ishte gjithshka që i kish mbetur atij nga nderi e dinjiteti i ustait të dikurshëm.

— A mos ke mbetur pa bukë? Kur të mbetesh pa bukë, mirë, ahere merr rrugët e shko... Sa jam unë gjallë, e kam pér detyrë të të ushqej e të të martoj.

Dhe ai u ngrit.

— Do shkoj të fle — i tha së shoqes, — se nuk jam mirë...

Ato mbetën vetëm. Heshtnin. S'guxonin të shikonin njëratjetrën në sy. Po qysh në atë çast, Drita e kupto se ajo nuk ishte vetëm e bija e Efigjenit, por edhe vazhdimësia jetësore e saj. Prapa atyre mureve të ashpra e të rënda, fatet e atyre dy femrave shkriheshin e, të qullura e të lagura nga lagështia e myku, bëheshin një.

Qysh prej asaj dite çupa nuk u ndie më. Nuk donte ta dëshpéronte babanë plak, me mikardit, tani në buzë të varrit.

Çupa flinte.

Si gjithnjë, usta Vangjeli hyri në dhomën e saj. Po kësaj radhe dhoma iu duk e lirshme, si një kostum, që të varet në trup. Muret të zhveshura e të shplara. Në ato mure plaku pa të varrura dy tablo të reja. Në fillim ai s'u besoi syve. Tablotë qëndronin të varura aty, përpara tij. Ahere ngadalë usta Vangjeli u afrua pranë tyre. I pa, i soditi. S'kupto gjë. U kthyte nga muri i majtë. As Leksi, as Aspasia nuk ishin aty.

Duke qëndruar në këmbë në mes të dhomës, shikoi nga e bija. Ajo flinte e qetë. Usta Vangjeli kërroi me sy atë katorin, ku ishte varur fotografia e pleqve. Dalëngadalë, nëpër bardhësinë e gëlqeres, gjeti gjurmat që kishte lënë në mur koriza e drunjtë.

— Sa të jem gjallë unë... — murmuriti Vangjeli, në qetësinë e dhomës. — Sa të jem gjallë unë... — tha ai përsëri nëpër dhëmbë dhe doli jashtë...

U kthye me fotografinë e madhe në dorë. Hipi në karrige dhe e vari atë në vendin e saj. Si u tërroq disa hapa, ai pa nënën e babanë. Të qetë, ata e shihnin nga fotografia. Ahere plaku u kthye nga çupa. Iu afrua. Ajo flinte. Vangjeli me dorë mbylli pak kanatin e dritares te koka e saj e doli.

Kishte pleq, të cilëve ende u gjëmonin në veshë thirrjet e muezinit e të tellallit. Ende tani këto zëra i ndiqnin pas, si zëra të një të kaluere që kish mbetur diku, ndonëse, po të ngrinin kokën, ata e shihnin akoma muezinin, që nga maja e xhamisë diçka i gërziste allahut. Këmbanat e kishave ndillnin njëra-tjetren e grindeshin nëpër ajër, mbi atë qytet të vjetër, që dergjej në zemrën e dheut e të kohës, ashtu si ata vetë dergjeshin në zemrën e tij. Dhe mbi ta gjëmonte këmbana e madhe e sahatit. Njerëzit qëndronin në mesin e udhës e dëgjonin të goditurat 1...2...3...4...5...6...

— Oh, sa vonë! Gjashtë sahati...

— Të shkojmë në shtëpi... të hamë e të flemë se gdhin shpejt.

— Sa e shkurtër është dita!

Me të vërtetë dita e atij qyteti ahere ishte

shumë e shkurtër. Duke hequr zvarrë jetën orientale e apatike të qytetarëve, ajo mezi arrinte gjer te ora gjashtë, kur qytetin e lëshonin fare fuqitë, e, si ai udhëtari i kapitur, këpuntej e binte mbi tokë.

Ora gjashtë ishte koha kur njeriut nuk i bindej më asnjë gjymtyrë. Ai kishte nevojë për gjumë. Dhe flinte një gjumë të thellë, si të të vdekurit.

Dhe ashtu si binte, ashtu ngrivej qyteti. Trupi i tij edhe në mëngjez ishte po aq i pakur e i cfilitur, sa edhe në mbrëmje...

Tellalli s'dëgjohet më të thërrasë nëpër ato rrugë, të vogla, të errëta e të vetmuara. Muezini e ndërprenë këngën e vet, dhe dita filloi t'i shtrijë gjymtyrët e saj më larg se ai kufi i akullt e i vdekur i orës gjashtë. Njerëzit nuk mendojnë më për akshamin. Një fuqi e hekurt, e nëndheshme ka filluar të përtérijë trupin e qytetit të vjetër.

Nëpër rrugët e esnafëve nuk hapen më dyqanet e vogla të veçuara të zanatçinjve të dikurshëm; nuk rreh më çekiçi i këpuçarëve e s'pret më gërshtëra e vetmuar e xhokaxhinjve. Kraharori i hekurt i kombinatit, me frymëmarrjen e vet, përkund qytetin. Dita e nata mpleksen e shkrihen në një dhe vetëm jeta vazhdon të rrjedhë e pandalshme dhe e përhershme. Kombinati punon pa pushim. Nëpër turnet e natës e të ditës, autobusat çojnë e sjellin punëtorët. Dyert e shtëpive në mbrëmje nuk mbyllen aq shpejt, si më parë; rrinë të hapura sepse në çdo shtëpi është dikush që shkon e dikush që kthehet nga puna.

Gjithshka përtérihet si në trupin e qytetit ashtu edhe në trupin e njerëzve. Përtérihen mendimet,

fjalët, lëvizjet. Njerëzit nuk flasin më për «ditën e të vdekurve». Natën gratë nuk ziejnë grurë e nuk bluajnë arra, për të mbushur kanistrat përshpirtje, as ngrihen më në mesin e natës për të falur ramazanin.

Në sytë e vet të plakur, usta Vangjeli e shihte dhe, me trupin e tij të drobitur, e ndjente ndryshimin që pësonte jetë. Lagjet e vjetra të qytetit zëvendësoheshin me të reja, gjëmimi i këmbanave, me culat e fabrikave, mjeshtrat e çirakët e dikurshëm mbushnin turnet e punëtorëve. Fëmijët e tyre i shtonin dhe i rritnin këto turne. Me sytë e vet të plakur, usta Vangjeli shihte dhe në trupin e tij të drobitur, e ndjente se bota, në të cilën kishte lindur e ishte rritur, gjithnjë e më tepër largohej e po zhdukej tutje. Po pikërisht me atë trupin e vet të drobitur ai ndjente edhe, si pa u ndalur, thellë në të, krijohej një zgavër, që sa vente e rritej. Lagjet e dikurshme zhdukeshin nga qyteti dhe mbi këto ngriheshin bloqe me ndërtesa të reja. Kështu dhe në ndërgjegjen e kujtesën e plakut.

Gjithshka ishte në lëvizje e rridhte me një shpejtësi të çuditshme. Nëpër atë kujtesë shembezin me gjëmim, mes tymit, mëhallë të rrëgjuara prej kohësh dhe mes tyre ngriheshin ndërtesa të tjera të bardha e plot dritë. Usta Vangjeli e shikonte, e kuptonte se kjo ishte e domosdoshme e, thellë në vete, diku ndjente një drithërim gëzimi. Po aty ku fillonte ky gëzim, niste edhe trishtimi i tij. Sepse nëpërmjet asaj lëvizje ai ndjente se ato mëhallët e vjetra të dikurshme, me ato rrugë esnafësh e zanatçinjsh, qëndronin të përhershme e të palëvizura. Këto të rejat, që ndërtoheshin e ngriheshin tani, sikur nuk i përkisnin atij. Tingulli i vetëm i

sahatit tē dikurshëm, kumbimi i këmbanave sikur grindeshin dhe e mbytnin klithmën e sirenave tē fabrikës. Pastaj përsëri grindesh. Kështu ai po ecte nëpër vjetët e fundit tē jetës së tij.

Kur u zgjua Drita, s'u besoi syve tē vet: gjysh Leksi dhe gjyshe Aspasia qëndronin aty, në mur. Vajza pa pastaj portretin e Ilirit. I fejuarit shikonte drejt mbi tē. Kurse gjysh Leksi «sheh diku larg», mendoi ajo me vete e qeshi. Në fillim u trishtua, po pastaj, duke parë fotografinë e portretin, vajzën e kapi një humor i gëzueshëm. Iliri shikonte atë, kurse gjysh Leksi, si plak namuslli që ishte, nuk mund t'i hidhte sytë e vet aty në krevat, ku qëndronte zhveshur mbesa e vetme e tij.

Vajza qeshi prapë.

— C'ke? — Efigjeni, që e kishte dëgjuar atë tē qeshur tē vetëm, e trembur, hyri në dhomë.

— Shih sa serioz duket gjysh Leksi, — tha vajza.

— Sht, e zezë... — gruaja vuri gishtin mbi buzë.

VI

«Sa tē shohim ndeshjen e volibollit», i tha dhëndrri Efigjenit, «do tē kthehem shpejt». Po pastaj tē rinjtë, tē zënë dorë pér dore, u drejtuan nga kodrat e ullinjve e dolën jashtë qytetit.

Tani Drita po rend nëpër një arë tē korru gruri, ngjitet në ledhin e lartë tē kanalit tē porsa-hapur e thërrret:

— Ohuuu!

Zëri i saj përhapet në fushë e, së bashku me zërat e erës, humbet tutje. Qielli është i ngarkuar. Mbi tokë, aty-këtu, bien hijet e reve, ndërsa, midis tyre, digjen liqenet e zjarrta të diellit. Lëkura e tokës është e larueshme.

— Ohuu...

Ai i bën shenjë me dorë e ngadalë shkon drejt saj. E sheh ashtu të gjatë e të gëzuar, me leshrat shpupurit ur që era ja ngjit në atë sfond gri të qiellit. Ajo me duart hinkë në gojë i thërret:

— Ohuuu...

Thua sikur të jenë diku nëpër male, apo në ndonjë pyll e të kenë humbur njëri-tjetrin.

Kur u fejua, s'dinte pothuaj asgjë për këtë vajzë. E kish parë disa herë nëpër qytet, tek kallonte e heshtur dhe e vetmuar. I pëlqeu ajo butësi e ndrojtur, që përpëlitte krahët me qerpikët e saj.

— Ohuuu...

Ajo e thërret që aty, nga ledhi i kanalit, kumbaron ara e mbjellë dhe e korrur dhe nga fillon pastaj shpatulla e gjerë dhe e lartë e malit, që ngjitet përpjetë. Nëpër atë shpatull shtrihet pylli mbi të cilin gushti ka filluar të hedhë blanat përzëritëse, të bronxta, të diellit. Ai shkon drejt saj...

Kur e kish parë për herë të parë, kish ndjerë atë botë të mbyllur, të kyçur në vetëvete, ku, qoftë edhe nga shikimi i shpejtë e i shqetësuar, duket femra që, e drojtur dhe e bindur, shkon drejt fatit të saj, të cilin nuk e njeh, i trembet, por e kërkon.

«Një femër e tillë patjetër bëhet dhe një grua e mirë», mendoi ai.

Tani, tek e sheh mbi ledh, të gjatë, me atë fytyrë të bukur, Iliri çuditet vetë me ato hire, që kanë shpërthyer menjëherë te Drita. Kështu janë

disa vajza tek ne. Ato presin e presin, dhe, në pritjen e tyre, kthehen në folera trishtimi. Po ja ku vjen dashuria. Gjer ahene ato e kanë grumbulluar me vjet, si ai rezervuari ujin, këtë dashuri, përtatë derdhur pastaj përnjëherësh nëpër turbinat e jetës familjare.

— Ohuuu... këtu është një kanal i madh e nuk kalohet dot.

Ai shkon drejt saj, ashtu si ne shkojmë drejt dashurisë, papandehur, përnjëherësh, pa e kuptuar as vetë.

Ne ecim midis turmës njerëzore dhe as që na shkon ndër mend se ja, këtë njeri, me të cilin tanjë përpjekur krah për krah, nesër mund ta dashurosh. Ti e kërkon dashurinë diku... kurse ajo është pranë teje dhe ti, pa e ditur vetë, ecën drejt saj.

Kur i vajti pranë, ai deshi t'ja merrte fytyrën ndër duar, ta afronte e ta puthte, por nuk guxoi, i vuri vetëm pëllëmbën mbi shpatulla.

— Ky kanal është i madh — tha ajo, — nuk kalohet dot.

— Do të kalojmë e do t'i ngjitemi malit. Shih pyllin si është...

— Jo... do të kthehem i në shtëpi.

Ajo përnjëherësh u mbyll prapë në vetëvete.

«Te kjo femër ekzistojnë dy njerëz» mendoi ai në çast dhe ndjeu këtë mejtim t'i përcëllojë trurin, si vetëtima përcëllon fushën e qiellit. «Dy», mendoi. «Ajo e qeshura, e gjëzuara, që në gjëzimin e vet shkrihet një me tokën, me qiellin, që të thérret ty, po në të vërtetë u thérret maleve, fushave, hapësirave të largëta. Dhe kjo, tjetra, e mbyllura me hekura të forta e të rënda të ndjenjave e të mejtimeve të veta, përtej të cilave nuk mund të kalojë kurrkush tjetër veç saj».

— Ke frikë? — e pyeti ai duke qeshur.

— Duhet të kthehem...:

Ata u kthyen.

Dhe vetëm ahere kur ishin larguar shumë nga ajo rrëzë mali kur kishin kaluar fushën e fshatit e u ishin afruar kodrave të gjelbërtë të ullinje të qytetit, vetëm ahere ata e kuptuan se sa larg kishin shkuar. Qyteti ndodhej atje, pas kodrave, dhe u duhej akoma të ecnin.

— Babai sigurisht pret — tha Drita.

Ai u afroa dhe u mbështet tek ajo. Dhe, ashtu i mbështetur, eci ngadalë duke e detyruar edhe atë të mbante hapin e tij.

— Të nxitojmë pak...

— Ne jemi të fejuar — i tha ai gati duke i pëshpëritur në vesh, — e kuption?

Ajo ngriti me dorë flokët.

— Kushedi se ç'do të mendojnë...

— Le të mendojnë ç'të duan... — Ai shtriu krahun dhe e pushtoi. Ajo ndjeu se si humbiste gjithnjë e më shumë në kraharorin e tij. Ashtu ata ecën për një kohë, kur papandehur ajo qëndroi para tij.

— E di? — i tha duke i vënë duart në qafë.

— Lutju babait që të më lejojë të punoj në kombinat.

— Çfarë?

Ai i hapi katërçik sytë e zez e të mëdhenj.

— Ç'farë? — pyeti pa kuptuar mirë se ç'i kishte thënë ajo.

Më është mërziturjeta që bëj... Sikur babai të mos ishte sëmurë, prej kohe do të kisha shkuar të punoja, si shoqet.

— Ti?

— Po.

Ai ja shkrepi të qeshurit. Ajo kurrë s'e kishte parë të qeshte ashtu. I fortë, i téri, thua sikur edhe skajet më të largëta të qenjes së tij qeshnin. Edhe ajo vetë filloi të qeshë.

— Ti je fëmijë e çuditshme — i tha ai.

Nëpër zërin e tij, ajo ndjeu drithërimat e ngrrohta, të buta, të vetë ngjyrave të vjeshtës, që po vinte. Dhe e kuptoi: ai ishte i dashuruar.

Një dhomë begari. Grumbull librash, hedhur nëpër dysheme te koka e krevatit, të tjerë në raft njëri mbi tjetrin të pashkundur, të pafshirë. Mbi qilimin e vogël, një pantofël e kthyer mbapsht. Në cep të dhomës disa ndërresa të palara. Beqar, si gjithë beqarët në botë.

Ai hyri në këtë atmosferë familjare.

I veshur, siç ishte, u lëshua mbi shtrat. Ishte lodhur. Mornicat i shponin tabanin e këmbëve. Hapi «Adriatikun» e vogël mbi komodinë Tingujt e një zëri të urtë femëror u përhapën mbi atë çrrégullim të dhomës. Ndjeu si po i çlirohet balli i blokuar. Tingujt e asaj melodie i futeshin në tru dhe e çlodhnin. Muzika po e çonte në vende që ai nuk i njihte, por që duhej të ekzistonin diku. Dhe ai duhet t'i shihte patjetër. E, duke fluturuar nëpër atë melodi, pa Dritën atje, majë ledhit, në rrëzë të shpatullës së malit, që e thërriste: «Ouuu...» Kjo thirrje po shkrihet e kthehet në një ritëm organik, të brendshëm të kësaj melodie. «Ouuu...» Ajo po thërriste dhe ai po shkonte drejt saj e, duke ecur ashtu, po futej thellë e më thellë në veten e tij... muzika e çonte nëpër hapësirat gjithnjë e më të gjera të ndjenjave e të mendimeve të tij...

Dhe atje në mes të atyre hapësirave, Drita po i thërriste: «Ohuuu...». I vetëm ai qeshte në dhomën e çrregullt.

Ai ishte i dashuruar.

VII

Të nesërmen do të punonte me nxënësit një artikull të «Zërit të popullit», ku flitej mbi prishjen e fejesave në djep. Duke e lexuar atë artikull, ai vetë e cte nëpër shkrepë të maleve, hynte në kulla të gurta, ku, nëpër djepe, të mbështjellë nér shpërgenj të trashë e të lashtë, përkunden koka të vogla, leshverdha, fëmijësh. Mbi ato koka, në errësirën kanosëse, grindeshin zëra të egër:

— 50 napolona.

— Jo — përgjigjet njëri.

Kokat e vogla përkundeshin e dëgjohej pastaj një nina-nana e trishtuar, që arrinte deri te Iliri.

— 60 napolona — thoshte zëri i trashë, në errësirën e ftohtë të kullës.

Tjetri ngrihej në këmbë.

— Më tepër...

— Edhe miqësinë — tha zëri i parë.

Kësaj radhe kurkush nuk u përgjegj. Djepet vazhdonin të përkundeshin aty përparrë tij dhe ato kokë të vogla përpinqeshin sa andej-këndej në dërrasën e drurit. Ahere atij iu duk sikur në një nga ato djepe përkundnin një trup të vogël, me fytyrë të rritur, të madhe. Dhe pikërisht mbi atë foshnjë grindeshin më tepër ata zëra të panjohur, të frikshëm.

— 70 napolona...

- 100! — u përgjegj prerë tjetri.
 — Ehu, burrë... po a je në vete?!
 — Kush lidh krushqi me derën tonë, fiton edhe
 nderin... — tha zëri tjetër.

Ndërsa foshnja përkundej sa andej-këndej, ai u përkul mbi të, po u tmerrua. Në djep ishte Drita. E vogël, e vogël. Vetëm ftyra e saj ishte ajo e madhja, seriozja, me ato vetulla që gati takoheshin njëra me tjetrën e me tufën e flokëve, që mbushte tërë përkresën e djepit...

Artikulli ishte i bukur.

Të nesërmen ai do t'u fliste nxënësve për kahun e për këta zëra të padukshëm që, nëpër natën e errët të kullave tinzare, ende tregëtojnë me jetën e foshnjave, do t'u fliste nxënësve për ata litarë të padukshëm të jetës patriarkale, me të cilët lidheshin njerëzit qysh në djep. E pastaj nga djepi e gjer në arkivol. E njerëzit mësohen me ta, iu duken të natyrëshme e shpesh krenare përtat...

VII

— Uh, shumë, shumë e bukur! — Lauresha përpinqte duart pas kofshëve. — E mrekullueshme, — thërriste ajo.

— Këto... të keqen nëna... ne i kemi që kur ishte çupa e vogël. Nga një çikë, nga një çikë ja kemi mbledhur... Ja dhe sinia e madhe — tha Efigjeni e kërrusur mbi sepetin e drunjtë.

Lauresha ja mori nga duart dhe e ngriti atë sini të bakërtë, të rëndë, po ena ishte e madhe e vajza s'po e voziste dot.

— Këtë e kam timen — tha Efigjeni. — Kur u martova, ja prura Vangjelit. E kam ruajtur. Tani le ta marrë çupa. Mua s'më duhet gjë.

— Ç'të të duhet ty?

— Ashtu them edhe unë. Le ta marrë çupa... Pa nusja e Pirros, kur të vijë, le të sjellë të sajtë. Pastaj Pirrua ja ku e ka shtëpinë brenda. Të djalit janë këto... Kurse çupës ca rrangulla po i japim...

— Këto s'janë rrangulla, nënë Efigjeni.

— Ashtu? — Plakës i shkrepëtinë sytë nga gëzimi. — Hajde me mua, se të kam në vend të Dritës. Të më mësosh pak, se mos turpërohemi, moj Laureshë...

Efigjeni e çoi atë në dhomën e Vangjelit. Atje, ndanë murit, qëndronte një baule e madhe e ruajtur mirë. Plaka e hapi.

— Ja dhe paja — tha ajo. — Të linjta 12 palë...

Efigjeni me dorë të dridhur ngre copat e holla, të palosura njëra mbi tjetrën e pëshpërit ngadalë, gati pa frymë. Kurse Lauresha ka qëndruar në këmbë e shikon... e dëgjon...

— Paja... — Sapo fillonte të hidhët shtat mbi tokë, miendimi i pajës e ndiqte pas femrën tonë, si dhe ajo hija e saj e vogël. Qysh fëmijë nëna e mësonte foshnjën e vet, që çdo ditë, çdo orë, të punonte diçka, të kursente diçka për pajë. Me një top leshi thuret një thember çorapi, me një copë humajie qepet e linjta e trupit. Çdo dhuratë hqet mënjanë për pajën. Dhe ky shqetësim rritet e bëhet më i madh, së bashku me atë hijen e shtatit, ngatërrohet e përzihet me mendimin për burrin, sa herë-herë, vetë paja bëhet e barabartë me burrin. Dhe nënët e dinë këtë.

— Këmishë: 15 palë — thotë Efigjeni.

Dhe Lauresha i sheh e qëndron aty në këmbë e veshur me përparësen e nxënëses, të cilën, edhe tani që e ka mbaruar shkollën e është futur në punë, nuk e heq prej trupit.

Në ditë të shënuara babai kthehej prej pazarit. Që nga dera i thërriste së bijës: «Dritë, eja këtu...» E i lëshonte në duar bohçen e mbështjellë. Ajo e dinte që aty kishte tafta për pajë dhe e hapte.

— Të pëlqen?

— Ehë...

— Shumë e bukur!

Efigjeni linte fshesën në oborr e rendte të shihte se ç'kishte sjellë Vangjeli. «E gjëzofsh» i thoshte së bijës. «Ruaje, të keqen nëna». «Dhe ty të lumshin duart», i kthehej pastaj Vangjelit.

Paja ishte një qenje e gjallë, monstruoze, që rritej ngadalë, duke gëlltitur ditët, netët e njerëzve. Gratë ngrihen në mes të natës që të punonin.

— Jastëkë... — thotë Efigjeni duke i nxjerrë nga baulja.

— Dale, — Lauresha ja merr nga duart e shikon qëndizmën. Sa e bukur!...

— E ka qëndisur vetë.

— Kush, Drita?

— Po... ç'e do, i ka mbushur të gjitha me këto pata të egra, — ankohet e trishtuar plaka.

— Sa e bukur!...

Paja me dhëmbë të padukshëm kafshonte një copë të gjumit të grave. Mbrëmjeve vonë, ato punonin. Paja nuk i linte të flinin. Ajo hynte në gjumin e prishur të njerëzve të shtëpisë. E për të gjitha fajtore ishte ajo, që kishte lindur vajzë. Gjithë familja tani duhej të robohej e të mekej për

pajën e saj. «Po paja është burri e burri është burrë, moj çupë... A më kupton?». «Nderi i vajzës është atje te burri», thoshte babai.

— Grua, shesin një qilim shumë të mirë.

— Ashtu?

— Me 12 pala...

Efigjeni heshtte. Ajo e dinte që Vangjeli s'kishte para.

— Do të marr hua te Vasili.

Gruaja heshtte.

— Nuk e gjen më një qilim të tillë... Po më duhen 40.000 lekë.

— Korba! — Gruaja e zgjatte përpara fytyrën e tultë. Dhe mbetej ashtu me gojë hapët: «Shumë, Vangjel...»

— E di... po...

Babai shikon nga Drita. Ulur në dritare, çupa qëndis, mbi këmishën e vet, krahët e shtrirë të një pate të egër. Me atë majë gjilpëre ajo qëndis mbi pëlhirën e asaj mbasdite. Tani vajzës i është bërë zakon e kudo të jetë merr e bën diçka: qep një bluzë, thur një çorape, qëndis një çarçaf. Në një-rën prej tyre qëndisi disa lepurushë të vegjël, të frikësuar. Qëndizmat vazhdojnë mbi copërat e ndryshme e në baule palosen jo ata çarçafët e bardhë, po ashtu, si çarçafët, një e nga një, duke mbajtur nëpër hapësirat e tyre tufat e patave të egra, palosen ditët, netët pagjumësia, fyerja e skullavëria ndaj burrit të nesërm që, i huaj, i panjohur, qysh nga fëminia ka të drejtë mbi të... nëpërmjet asaj, pajës... Po mbi të gjitha këto, i bukur e i fuqishëm, shtrihet një krah i shpendit të egër. Patat fluturojnë tufë-tufë... ashtu siç i ka parë nga dritarja Drita nëpër ditë thëllimi, kur vargan të bardha lëshohen

poshtë nëpër grykën e maleve e vijnë e afrohen fare mbi qytet. Dhe ahore çdo njëra prej tyre bën disa rrrotullime të çuditshme...

— Çarçafë: 12 — thotë Efigjeni.

— Me bordurë?

— Po... Oh, po këto qenkan lino...

— Gjashtë copë ja bleu i ati një vit.

Nëpër cepa të çarçafit po ai shpend i bardhë, i qëndisur.

— Eh, moj Laureshë, të keqen nëna, të thashë, ma ka mbushur pajën me zogj të egjér. — Ç'e ka hedhur perëndia...

— Sa bukur!

— Nuk është turp, të keqen?

— Pse të jetë turp?!

Palë-palë në atë baule është palosur trishtimi e mërzia. Pas dreke gratë dilnin te praku i shtëpisë e fillonin të punonin me bizat në dorë e, duke punuar, bisedonin.

— Po të shtohet paja, moj çupë e nënës. Edhe ti po rritesh...

— Çfarë the, nënë?!

— Paja po të shtohet — i thotë Efigjeni. —

— Po burri s'po duket gjékundi...

Vajza s'përgjigjesh.

— Eh, edhe ai do të vijë — thoshte pastaj Efigjeni. — Paja e ndjell atë...

Dhe ato vazhdonin të punonin. Të heshtura. Të palodhura. Të trishtuara. Dhe atë trishtim ato e derdhin në lodhjen e tyre kapitëse.

— Katër triko të leshta.

Lauresha rri në këmbë e shikon.

Ej, paja... Në atë baule janë palosur të gjitha: pritja pa fund, lodhja, që s'ka të sosur,

gëzimi i një shprese që s'duket, frika para burrit të huaj, që s'e njeh... Dhe, për t'u ruajtur nga mola, ato janë pluhurosur me naftalinë. Lauresha ndjen erën e saj të rëndë të përhapet ngado nëpër shtëpinë e usta Vangjelit.

— Dëgjo, nënë Efigjeni, — vajza u përkul mbi plakën e i foli ngadalë në vesh. — Paja është e madhe. Shumë keni bërë. Keni gjëra të mira, po ka dhe shumë të vjetra. Pastaj tani është turp...

— Kështu më thotë edhe Drita — tha plaka duke e shikuar çupën e mëhallës në sy.

— Kështu është... Po unë do t'u them shokëve të kombinatit që ta blejmë këtë pajë.

— Çfarë thua, moj bijë? — pyeti plaka e shushatur.

— T'ja shitni kombinatit — tha Lauresha.

— Mos e thuaj atë fjalë! — Efigjeni kërceu. Filloi të mbledhë plaçkat shpejt e shpejt.

— Mos e thuaj atë fjalë — tha ajo, — mos na ndill tersllëk.

— Në kombinat ka mijëra e mijëra vajza. Dhe janë nga të gjitha anët. Po të na e jepni, ne mund ta ekspozojmë që të gjitha ato të shohin, se ç'ka qenë pajë...

Në atë çast në dhomë hyri Drita.

— I them nënë Efigjenit — tha Lauresha — që të na e shitni neve gjithë këtë pajë, që vajzat e kombinatit...

Po Drita ja preu:

— Lëri shakatë.

— Unë s'bëj shaka...

Fytyra e zëri i shoqes ishin të akullt.

— Lëri shakatë, Lareshë.

— Mirë... po patën e egër do të ma mësosh

ta qëndis? — Dhe Lauresha iu afrua ngadalë Dritës.

— Cilën patë të egër?

— Ja, këtë që ke qëndisur mbi lino.

Vetëm ahëre Drita qeshi.

— Ç'të duhet?

— Mua? T'ua jap dizenjatorëve, Kristos...

— Kush është ky Kristo?

— Kristua, moj, — tha punëtorja e vogël shpejt e shpejt duke iu marrë goja dhe e skuqur në fytyrë. — Nuk e njeh ti?

— Cilin, Kriston? Jo — tha Drita ngadalë. — Nuk e njoh, po mos duhet që «Kriston» tënd ta njohë gjithë bota?

Lauresha i hodhi krahët në qafë Dritës.

— Më qafsh — tha, — mendo një fustan blu, si qelli e, nëpër të, derdhur tufat e patave të egra, që mbulojnë trupin e vajzave. E mrekullueshme, ë?! Nëpër trup kudo të na fluturojnë ato, patat e egra. Kulmi. Kurse fustanët e pajës i ke demode...

— Që kur janë qepur ato...

— Duhet t'i rregullojmë. Nuk shkojnë fare ato jaka bufkë tani. Si plakë. Kurse ti ke alamet beli — tha Lauresha dhe i uli krahët e saj dhe e shtrëngoi Dritën fort në bel duke qeshur e duke thirrur. Edhe Drita kukurisej e donte t'i shpëtonte duarve të shoqes, po kjo s'e lëshonte dhe i thërriste: «Me këtë bel që ke ti e çmend...»

— Lëshomë — thërriste Drita.

— Me këtë bel ti çmend...

— Lëshomë — thërriste Drita.

— Me këtë bel ti çmend...

Lauresha erdhi t'i thoshte Dritës se disa nga ish-shoqet e shkollës, që punonin në kombinat, do t'i bënин pasdreke një vizitë për fejesën. Dhe ato i vajtën. Vajzat u puthën e u lëpinë qysh të dera e oborrit. E, duke u përqafuar, hynë brenda. Prapë në fillim gjithshka ishte e ftohtë. Pyesnin për babanë, për mëmën, pastaj për Ilirin. Dhe e uronin.

— Të trashëgohesh... ja dhe kjo u bë...

Dhe heshtnin. Nga që s'dinin ç'të bënин, shikonin njëra-tjetrën në sy, ulnin kokën e shtren-gonin duart e veta. Thoshnin nga një fjalë të rrallë e pa kuptim. Papritur Mira, me trupin e zhdërvjellët, kërceu nga froni:

— Uh... portret... i kujt është? I atij?! — tha ajo duke e zgjatur me qëllim fjalën «atij»...

— Ehë... — Drita tundi kokën.

— C'm'i paska këto noçka... tamam si të Thomait tim... — tha Mira.

— Si?!

— Tamam si noçkat e Thomait.

Dhoma u lëkund nga ata të qeshur të përnjë-hershëm dhe nga ai vrull me të cilin vajzat rendën te portreti. Qeshnin, flisnin e kukuriseshin kokë për kokë. Drita në fillim s'po kuptonte gjë. Asaj vetëm nuk i pëlqeu që Mira foli ashtu për Ilirin. Si guxonë, kur Iliri ishte aq i bukur... Nga cmiri, sigurisht. Po shoqet, grumbull, jepnin e merrnin aty para portretit të varur në mur e pëshpërisnin e qeshnin.

— S'he gjë, Mira... ku Thomai e ku ky këtu!

— Posi. Ku kuptoni ju nga ai ballë i mbledhur e ajo hundë e lëshuar poshtë... Tëpkë Thomai...

— Mos janë vëllezër?

— Kushedi... E ke pyetur, moj, — i tha ajo Dritës, — mos jemi kunata?

Drita, duke qeshur, iu afrua shoqeve, që të shihte edhe ajo portretin.

— Ky është i bukur.

— Shih ç'shikim të lëngëzuar që ka...

— Si the?

— Ç'shikim të lëngëzuar...

Mira ja plasi të qeshurit.

— Këtë s'e kisha dëgjuar gjer tani... «Shikim të lëngëzuar». Shtriga, — tha ajo pastaj, — pse, Thomai im i shëmtuar është? Të m'i merrni të keqen.

— Ne s'thamë gjë.

— Ti vetë...

— Ti vetë kërkon të gjesh noçkën e Thomait kudo.

— Edhe atje ku s'është.

— Sepse e dua. Keni zili ju? Ju lëngëzohet goja?

Duke qeshur e duke thumbuar njëra-tjetrën, ato përshkonin miset e Ilirit, gjithsecila sipas vetes. Pastaj u ulën prapë nëpër karriga. Tani gjithshka ishte e ngrohtë, shoqërore. Vajzat flisnin me këmbë, me duar, duke kujtuar kohën e shkuar në shkollë e duke përsëritur, kushedi për të satën herë, historitë, që kishin thënë e stërthënë.

Ato u larguan vonë. Te dera, më të dalë, i thanë Dritës:

— Dhe tani eja të punosh... ç'më rri gjithë ditën këtu brenda.

— Si në burg — i tha Mira... — Thonë se mësuesi është i mirë. Eja në kombinat... Mbrëmjeve të pret e të përcjell ai... Ke për të parë

sa mirë është... — Dhe ajo i shkeli synë... Edhe Thomai bëhet më i ëmbël ahore... — i tha dhe e puthi.

Kur u kthye Drita, i nguli sytë portretit. Ai qëndronte përballë në mur, i palëvizur. E mbulonte një tis i hollë gri në të verdhë, si në një ditë të thellë vjeshte. Nëpër ato ngjyra tiparet e tij humbisnin dhe Iliri mbetej gjithnjë i papërcaktuar mirë. Atë përshtypje pati ajo që në çastin e parë dhe me atë përshtypje mbeti. Sado që e vërente me vëmendje, s'dallonte dot atë «ballë të mbledhur e hundë të lëshuar poshtë», që thoshte Mira. Balli i Ilirit ishte kattrorë e i prerë, po atë e mbulonte ajo mjergull vjeshte e vendë-vende ai shkrihej me të. Kurse hunda...

— C'ne — tha Drita me vete. — Ai ka hundë të vogël...

VII

— U kënaqa — tha drejtori me flokë të thinjur. Ja, — një orë mësimi e bukur...

— Tema mbi emancipimin e gruas më pëlqen shumë — tha Iliri.

— E kuptova — tha drejtori. — Kur të dëgjova që flisje, e kuptova se e ke për zemër... dhe do kërkoj që ta punosh edhe para këshillit pedagogjik... e vlen.

— Oh, gjer këtu...

— Mos u druaj — tha drejtori, kësaj radhe i afërt e i ngrohtë. — Jam i bindur se do të dalësh mirë — dhe i dha dorën. — Tungjatjeta.

Ata u ndanë.

Iliri doli nga oborri i shkollës e hyri në rrugën e gjerë të qytetit. E ndjente veten të lehtë e të gjëzuar. Në mësimin e asaj dite asistoi edhe drejtori. E çdo gjë shkoi mirë. Mësimi ishte i thjeshtë, aktual, i kuptueshëm. Në dukje lexim i zakonshëm i një artikulli gazete. Po nëpërmjet tij, ai u përpoq t'u zbërthente nxënësve të kaluarën e zezë të malësorëve tanë, krimet e bajraktarëve e të kanunit, spekulimet e fesë. E mbi të gjitha skllavërinë e femrës. U kishte folur nxënësve mbi të drejtat e kësaj: «Le të kujtojmë nënrat tonë — u kishte thënë... Çdonjëri ka një nënë e çdo nënë është një femër... Kur ne themi që gruaja shtypet, do të thotë se nënrat shtypen... Ato s'i gjëzojnë dot të drejtat e barabarta me burrat... S'ka pasur më fatkeqe se nënrat...» Dhe u kishte folur **nxënësve gjer e gjatë, duke u lexuar edhe copë, nga artikulli i gazetës**, mbi jetën e lodhshme që **edhe tani bëjnë femrat** në shtëpitë patriarchale.

Gjatë gjithë kohës që fliste, atij i dilte përrpara fytyra e Dritës e hequr, korozëzë, me ato dy vetulla të holla e të gjata, me flokët e lëshuara mbi supe. Ajo fytyrë vinte e përhapej aty para tij, mbi kokat e nxënësve, pastaj afrohej e qetë, e heshtur dhe gjithnjë e drojtur. Ai fliste e nxënësit dëgjonin. Kurse thellë në veten e tij ai e dinte që mësimin e asaj dite e bënte për Atë.

Nga larg, midis turmës, pa Dritën që kaloi trotuarin e hyri në postë. Iliri shpejtoi hapat. Në sallë ajo s'ishte. «Sigurisht që është futur e flet në kabinë» mendoi. Dhe priti. Me të vërtetë, pas pak, ajo doli prej andej.

— Ti këtu! — e pyeti ajo e habitur.

— Të pashë dhe erdha...

— Bisedova me Pirron.

— Si është?

— Mirë... po për të ardhur s'vjen dot...

Kurse babai është sëmurë...

Ata dolën prej poste, shëtitën rrugëve të qytetit, hynë në mapo, qëndruan para vitrinave. Bisendonin e qeshnin. Në pasticeri morën nga një akullore. Duke pirë akulloren, ajo e shikoi atë në sy. Një dritë e shqetësuar vetëtiti nën ta. Ai nuk ishte si herët e tjera. Megjithëse përpiquej ta mbante veten, ajo e ndjeu që ai ishte nervoz e i padurueshëm. Dhe e pyeti se ç'kishte. Po ai u përgjegj:

— Do shkojmë në shtëpinë time.

Drita e pa me habi.

— Ku? — murmuriti.

— Në shtëpinë time.

Ai donte të thoshte: «në dhomën time».

— Ti s'di asgjë për mua. S'di as ku jetoj. Kurse ne jemi të fejuar, apo jo? — Dhe, duke qeshur, e kapi prej krahu.

— Shkojmë në shtëpinë tonë — tha ajo. — Edhe nëna më pret.

— Sa mirë që të takova. Nuk të lëshoj më... — tha prapë si duke qeshur.

— Ajo ndjente se si e mbante fort prej krahu dhe e tërhiqte pranë vetes.

— Po të kisha familjen këtu, a nuk do të vije në shtëpinë time?

— Do të viaj.

— E, pra, shkojmë...

Dera u hap. Iliri hyri brenda, kurse ajo mëdyshaz qëndronte akoma përjashta.

— Eja... — thirri ai.

Drita qëndronte atje, te praku. Dhe s'luante vendit.

— Ke frikë nga unë? — Ai zgjati dorën drejt saj.

— Jo, — murmuriti ajo... — e nga që s'dinte se ç'të thoshte, tha: — Këtu s'paska ku të vësh këmbët...

Ngadalë kaloi prakun e dhomës.

— Aha! Dhomë beqari... S'besoj të kesh parë gjer tani as një dhomë të tillë.

Drita s'e priste këtë.

— Jo — u përgjegj ftohtë. — Nuk kam parë...

Ajo u përgjegj më tepër seriozisht se sa duhej. Iliri e pikasi e qeshi. Vajza u skuq e tëra në ftyrë. I erdhi inat që përgjegjja e saj nuk i bëri ndonjë përshtypje e do të dëshëronte që t'ja përsëriste prapë: «Unë s'kam qenë kurrë në ndonjë dhomë beqari!», po Iliri i kishte kthyer kurrizin e po hapte radion.

— Të dëgjojmë pak muzikë...

— Një gjë të tillë s'ma kanë zënë sytë gjer tani. Asnjë dorë s'e rregullon dot këtë dhomë... — Dhe ajo qëndronte midis atij çrrëgullimi e palëvizur.

— Oh, as gruaja ime?!

Ai e rrëmbeu në krahë.

Mbi kokën e saj sikur u shpalos e u hap qielli. «Gruaja ime...» Përherë të parë e fare pa pritur ajo i dëgjoi këto fjalë. Ato i tha ai, njeriu i dashur. Drita qeshte në krahët e tij. Dhe Iliri qeshte e vërtitej në dhomë me të ndër duar.

«Gruaja jote...» deshi t'i thoshte ajo, por Iliri qëndroi.

— Dëgjo, ti rri këtu. Unë po shkoj poshtë të blej diçka. Dhe vij shpejt.

Ai doli nga dhoma pa pritur përgjegjën e saj. Shtrati i parregulluar, librat e fletoret hedhur sa andej-këndej, në tavolinë njëra mbi tjetrën grumbulluar një mori sendesh, që nga maqina e rrojes e gjer te marmelata prej kumbulle.

«Ja dhoma e tij... si jetoka kështu!...»

Kjo rrëmujë e ky çrregullim ishte i papritur për të. Në shtëpinë e saj Efigjeni, usta Vangjeli e vetë ajo, Drita, nuk do të kishin jetuar asnje ditë kështu. Atje çdo send e dinte ku e kishte vendin, ashtu si dhe çdo zokth i ajrit e di ku e ka folenë e vet. E megjithatë ato pantofla të hedhura njëra andej, tjetra këndej; ajo këmishë e shukur mbi karrigë, siç ishte nxjerrë nga trupi; ato libra... Ajo qëndronte në këmbë midis tyre e ndjente diçka të afërt, të dhembshme ta përshkonte.

Radioja që Iliri e kish lënë të hapur mbi tavolinë këndonte. Ajo e dëgjonte e shikonte rreth e rrrotull dhomën.

Iliri ashtu e gjeti, si e la.

— C'bën ti kështu? — tha duke hyrë me nxitëm nga jashtë duarplot.

— Oh, — tha ajo, — këtu asgjë s'mund të preket me dorë.

Ai shtyti me krahë ç'ndodheshin mbi tryezë, pastroi një copë vend e lëshoi mbi të shishen me konjak e çokollatat që kishte blerë.

— Të rregullojmë pak shtratin — tha pastaj.

Drita shkoi drejt tryezës e filloi të pastrojë. Pastaj u ul të mbledhë nga dyshemeja një grumbull librash të hedhura te koka e krevatit. I merrte librat, i fshinte, u lexonte titujt e i vendoste njëra mbi tjetrën. Disa prej tyre ajo i kishte lexuar, kur kishte qenë në shkollë. Në shtëpi gjithashtu

kishte lexuar shumë. Lexonte për të harruar mërzinë e trishtimin. Po pastaj edhe librat iu neveritën. Ajo ishte duke rregulluar librat, kur Iliri u përkul mbi të. E kapi nga supet dhe e ngriti.

— Ato nuk rregullohen tani — tha ai. — Të pimë nga një gotë.

U ulën në tryezë, Iliri hapi shishen e konjakut.

— Gëzuar!

Duke ngritur gotën, asaj iu vërtit para syve rrëthi i shndritshëm i unazës. E përnjëherësh iu kujtua dita e parë e fejesës. Iliri i qetë, i panjohur, rrinte para saj me atë unazë në dorë.

— Pse s'e pi konjakun? Gëlltite përnjëherësh

— tha ai. — Këtu kë edhe çokollatën.

Mbushi prapë gotën e vet e sakaq e ktheu.

— Sot jam shumë i gëzuar — tha.

— Pse?

Vajza u kthyte nga ai.

— T'i shihje nxënësit... dëgjonin gojëhapët, si zogjtë e dallëndyshes. Prisnin se ç'do t'u thoshta, ç'do t'u jepja pér ushqim. — Dhe ai filloj të fliste gjërë e gjatë pér mësimin...

Mbushi prapë gotat e konjakut. «Bromp» thirri. Edhe Drita e ktheu gotën e vet. Kësaj radhe të gjithë e përnjëherësh. Ashtu si i kishte thënë Iliri. Dhe sakaq ndjeu një fashë të zjarrtë t'i përhapët nëpër gjithë kokën e dalëngadalë t'i errësojë sytë. Gjithshka para saj u zhduk. Ilirin nuk e shihte më. Vetëm dëgjonte se ai fliste. Fjalët arrinin tek ajo copa-copa, si ato fashat e zjarrit, që i ndizeshin e i shuheshin në kokë. I mbylli sytë. Ashtu e kaloi një copë herë. Kur i hapi, gjithshka ishte e kthjellët. Vetëm dhimbja i qëndronte në ujth. Iliri fliste e queshte. E pinte. Ajo s'pinte më. Përtypëtë çokollatat. Kurse ai pinte e fliste.

— Sot ajri ka qenë kaq i lehtë e i pastër...
dhe toka e fortë... kur ecja më dukej sikur c
përkëdhelja dhe jo sikur e shkelja këtë tokë...
Fastaj të pashë ty...

Ai deshi të thoshte diçka, por iu muar goja.
Ajo ngriti sytë. Fytyra e tij ishte skuqur. Damarët
e qafes po i fryheshin.

— Pi — tha ai.

— Jo — tha ajo. — Më dhemb koka...

— Po unë dua që ti të pish.

Sytë e tij u ngritën mbi të të ndezur, kër-
konjës.

— Besomë — i tha ajo duke iu lutur, — be-
somë se po më dhemb koka.

— Punë e madhe! — tha ai.

Dhe i mbushi gotat.

— Ti duhet të mësohesh të pish.

Dhe ajo piu. Më tepër për t'iu bindur atij.
Dhe nuk e pikasi si ai u ngrit përnjëherësh, e rrëm-
beu ndër krahët e fuqishëm dhe e ngriti lart.

— Oh, gruaja ime... — thirri fort.

Zëri i tij ishte i trashë e fjalët i dilnin të
turbullta.

— Lermë... — tha ajo, duke ndjerë se si i
ndizeshin e i shuheshin në kokë flakërimat e zjarcta.

— Të të lë?

Ai afroi kokën te gusha e saj. «Të të lë?» e
pyeti prapë. Dhe qeshi. Ahere ajo e zuri prej
qafe fort, fort. U var në qafën e tij, si varet një
foshnjë në qafën tonë.

Ahere ai e uli në krevat.

Iliri flinte. Koka i kishte rënë nga jastëku e
fytyrën ja kishte mbuluar një vesë djerse. Tani

ajo e shikonte e qetë dhe pa u ndrojtur prej kurrkujt. E humbur në gjumë, ajo fytyrë iu duk aq e afërt dhe e dashur sa asaj i erdhi për të qarë dhe instiktivisht zgjati dorën mbi flokët e tij të dendur. Midis atyre flokëve të zez, përsëri pa rrëthim e shndritshëm të unazës të shkrepitjë në gishtin e saj. Dhe ndjeu ta rrëmbejë po ajo ndjenjë e parë dhe po ai mendim, që i kishte qëndruar në tru, kur unaza, si një rrëth i zjarrtë, ishte derdhur në gishtin e saj. «Tashmë i përket këtij» kishte menduar ajo për veten, sikur t'i fliste një tjetër njeriu.

Kurse këtë herë ai njeri ishte këtu i shtrirë e i pafuqishëm. Ai nuk ndjeu biles as dorën e saj që e përkëdhelte. Dhe Drita, e heshtur, e sheh atë fytyrë të dashur e të pafajshme, ata krahë leshtorë e të fuqishëm, ato shpatulla të gjera murgashe. Sa pak shembellente Iliri me mësonjësit delikatë e të kujdeshshëm, që dikur i kishin dhënë mësimë dhe asaj vetë. Duke përkëdhelur flokët e dendur të të fejuarit, ajo sillte në mend gjithë ata pedagogë të dikurshëm: atë të historisë, të vogël të vogël, me një zë metalik, që thua se i këpuntej në mes; të matematikës, të hollë, flokëverdhë e delikat dhe, në delikatesën e tij më të ngatërruar se vetë matematika, atë të shkencave shoqërore... kurse Iliri ishte i fuqishëm e muskuloz. Edhe në muskujt e fytyrës, të nofullave të tij, dukej ai shpërthim i fuqishëm i jetës.

Ajo shikoi rrëth e rrotull. Dhe nënqeshi. Nënqeshi me veten e saj. Këtë dhomë e kishte përfytyruar krejt ndryshe. Të rregullt, të pastër, ku çdo send qëndronte në vendin e vet dhe sikur ankohej po të mos e lije në vend të vet. Kurse

tani kuptonte se ky njeri i fuqishëm vetëm kështu mund të jetonte. Këmisha e hedhur atje, këpucët të lëshuara këtu. Libri i hapur, lënë përmbyss mbi radio. Ky nuk ishte një çrregullim i harruar, i mykur. Edhe në këto shprehej ai vrulli i fuqishëm i jetës, që nëpër atë shkujdesje gjente qetësinë e vet të domosdoshme.

Iliri flinte. Ajo e shikonte e qetë dhe pa ndrojtje burrin e saj të ardhshëm dhe çuditej kur mendonte se ditën e parë i ishte marrë fryma dhe një ari i madh i kishte shtypur kraharorin. Kurse Iliri, i mbuluar në djersë, ishte i mirë e i pafuqishëm. Si një foshnjë.

Ahere ai hapi sytë, bëri të buzëqeshte e me dorën e tij zuri dorën e saj të hedhur midis leshrave të zeza.

— Gruaja ime... — belbëzoi. E përnjéherësh i mbylli sytë e prapë ra në gjumë. Konjaku e kishte zënë fort.

Drita donte të qeshte. Do të qeshte fort, sikur ai të mos flinte. Sa qesharak ishte, kur me sytë gjysmë hapët belbëzoi «gruaja ime». Dhe pastaj i mbylli prapë. Gjumi e mundi: «gruaja ime»... Kurrë asaj nuk do t'i kishte shkuar ndër mend se do t'i dëgjonte ato fjalë në një mënyrë të tillë. Iliri mezi i lëvizte buzët.

— Gruaja ime...

Zbriti poshtë krevatit. Instiki i femrës nuk e linte të qetë. Dhoma duhej rregulluar. Dhe atë rregull atje do ta sillte ajo. Po nga t'ja fillonte? Sendet e hedhura sa andej-këndej e bënin dhomën shumë më të vogël nga ç'ishte. E s'kishte ku të rrrotullohesh. Megjithatë, ngadalë ajo filloi të mble-dhë plaçkat. Disa herë ndryshoi vendin e karrigave

e prapë nuk ishte e kënaqur. «Nuk janë mirë kështu», tha me vete. Koha kalonte e pjatat duheshin larë e duheshin vendosur në komodinë. Dollap s'kishte. Këmishët i futi në valixhe, të cilën e vendosi atje ku ishte më parë, nën krevat. Po librat? I vetmi raft, që ishte në dhomë, që mbushur, kurse një pjesë e tyre ish hedhur sa andej-këndej. Duke rregulluar ato, ajo u kujtua se pikërisht kjo dhomë do të ishte edhe shtëpia e saj e ardhshme, ashtu siç ishte për Efigjenin shtëpia e usta Vangjelit. Ajo fshinte e rregullonte ngadalë librat e raftit të Ilirit, ndërsa truri i saj i ndezur vetiu punonte e ajo mendonte se, edhe sikur të shkonin në ndonjë apartament tjetër, prapëjeta e saj do të rridhte një lloj. Mobiljet, sendet e librat e shtëpisë do të zinin po ato vende të përhershme e do të merrnin po atë pamje të zakontë, sa edhe sendet në shtëpinë e babait, ku ajo e dinte se, po të hiqje nimin nga faqja e murit, ahore atë mund ta vendosje vetëm afër dritares e sobës, apo, në goftë se nuk i vendosje rresht karrigat e dhomës, ahore ato mund të qëndronin vetëm rreth tavolinës së vogël. Tjetër mënyrë s'kish. Po përsëri pamja e re që do të fitonte dhoma nuk do të zgjatte më shumë se një gjysmë dite. Syri mësohet shpejt. Dhe gjithshka bëhet aq e rëndomtë, sa edhe më parë. Ajo e dinte këtë nga vjetët e gjatë, të pandryshueshmë që kish kaluar në shtëpinë e vet, midis atij oborri të ngushtë e atyre shkallëve, ku dëgjonte përherë po atë krisje të zgjatur të derës së dhomës e netve molën që brente aty nëpër dérrasat e dyshemesë.

Kur ktheu kokën, pa Ilirin të zgjuar, që shikonte nga ajo.

— Ilir, nuk jetoj dot më kështu...

La librat që kishte në dorë dhe vajti e u ul më gjunjë, para krevatit të tij. Ashtu u ul, me gjunjët mbi çimenton e dhomës e duart i vendosi te parvazi i krevatit.

— Nuk mund të jetoj më kështu — belbëzoi, me sytë përdhe pa përqëndruar shikimin e vet gjékundi. Fytyra e saj ishte e trishtuar, e dhimbshme. Ajo do të dëshéronte të qante, po i vinte turp, ashtu si i vinte turp t'i thoshte këtij djali që e shihte dhe e dëgjonte tani, këtij mashkulli të huaj, të fejuarit të saj, burrit të saj të ardhshëm: «Unë të kam pritur me ditë, me net, me vjet. Edhe kur lexoja libra, sepse s'kisha se ç'të bëja e nuk dija si ta kaloja kohën e ta mbytja trishtimin; edhe kur, duke qepur fustanin kadife, nëna më thoshte: «Ja dhe këtë e mbaruam» e gëzohej, sepse mendonte që ai fustan do të të sillte ty më shpejt tek unë, edhe kur duke parë patat e bardha, që fluturonin në qiell të ftohtë, qëndisja mbi çarçafët e gjerë krahët e tyre të shtrirë, unë të prisja ty... të vije, të më nxirrje nga ato mure të qullura». Ajo do të dëshéronte t'i thoshte atij shumë gjëra... po i tha vetëm:

— Ilir, nuk ietoj dot më kështu...

Gjysmë i përgjumur, Iliri e shikonte dhe e dëgjonte atë që fliste me sytë përdhe, me gjunjë të thyer te krevati i tij, po vetë s'po kuptonte asgjë. Në fillim mendoi se Drita do të qante, ashtu si zakonisht qajnë vajzat kur ndahen nga virgjëria e tyre. Dhe ajo fytyrë e trishtuar dhe e dhëmbshme iu duk atij qesharake. Iliri donte të zgjatte dorën, ta kapte prej flokësh e ta përkëdhelte të fejuarën e vet duke i thënë:

— Pse dëshpërohesh... e bëhesh qesharake, me paragjykimet naive të femrave?..

Po Drita nuk i përmendi asgjë nga ato që mendoi ai. Ajo fliste pa pushuar, po për gjëra të tjera.

Dhe Iliri e dëgjonte dhe heshtë.

— Babai s'ka pranuar kurrë... ai është sëmurë e gjithnjë më është dhimbsur... nuk dua ta hidhëroj. Kam pritur... prandaj kam pritur që të vije ti... Do të më lejosh të punoj, apo jo?

Fytyra e saj i shembelleu atij me një re të zymtë vjeshte.

— Sa mirë që erdha këtu — tha ajo duke marë frymë thellë.

Ajo deshi të thoshte: sa mirë që sot gjithshka ndodhi kështu.

— Po ku të punosh?

— Ku? Ku të jetë — tha ajo përnjëherësh.

— Mjafton të dal edhe unë në jetë, si shoqet...

VII

Drita e fortë e neonit, që binte mbi asfaltin e udhës, arrinte gjer aty në breg të lumit. Ai kapi fort me të dy duart kokën. Sikur të mundte e të mos mendonte për asgjë kësaj mbrëmje. Po në fund të fundit asgjë të keqe s'kishte që Drita të punonte. Iliri e kuptonte sedrën e esnafit, që akoma gjallonte te usta Vangjeli. Plaku nuk do të pranonte kurrë që e bija të punonte. Dhe pastaj punëtore... Kurse Iliri... Ai e dinte se Drita nuk mund të jetonte më brenda atyre mureve të ngushta e të trasha të avllisë të usta Vangjelit. Ajo ishte e re

dhe donte jetën. Dhe le të dilte në jetë. Në këshillin pedagogjik ai kishte arësimtare, që s'ishin më të zonjat se Drita. Po ajo s'e kishte arësimin e tyre. Kurse një sekretare, laborante, apo kujdestare fëmijësh në ndonjë kopësht... Ashtu po. Ato të tjerat as ishin më të zonjat e as ishin më të mira se ajo. Le të hynte nëpunëse diku... «Qindra e qindra të tjera hyjnë në kombinat». Ai e largoi përnjëherësh këtë mendim nga truri. «Nëpunëse» tha. «Drita është e mençme dhe e urtë. Ato të tjerat s'kanë asgjë më tëpër se ajo. Kurse në Kombinat...»

«Jo, murmuriti me vete, kurrë s'kam menduar se gruaja ime do të ishte një punëtore e thjeshtë».

Duke u endur i vetëm nëpër errësirë, papan-dehur u gjend para birrarisë. Pista e çimenttë ngri-hej mbi lumë. Tryezat ishin hapur rrëth e qark e klientët pinin e bisedonin gjithë zhurmë. Ai qëndroi një çast, ashtu në këmbë, me duart në xhepe duke shikuar përreth.

— Dhëndrrush!

Ktheu kokën e shikoi andej nga e thirrën. Gëzimi e Aliu pinin birrë në tryezën e afërt.

— Eja se të presim — i tha Aliu.

Ai u ul.

— Nga bredh kështu natën?

Të tre ishin shokë të këshillit pedagogjik.

— Nuk i vjen zëri — tha Aliu duke e shikuar në sy Ilirin që s'përgjigjej. — Unë e njoh këtë ujk të vjetër, që bredh errësirës me plane të errëta në kokë...

— Prapë me «plane» ti?! Kamerier, një birrë.

Aliu kishte një kokë e një fytyrë si të Cezarit. Dhe në këshillin pedagogjik «Cezar». Prandaj Iliri

i tha: «prapë me plane ti?». Kamerieri e solli birrën e ai fillooi të pijë. E, duke e pirë, iu kujtua prapë Drita. Atëhere ai e pa atë, në mes të punëtorëve. Duke rendur për te autobusi, se fillonte turni i punës; pastaj në mes të maqinave të repartit gjithë djersë, mbuluar me tym pambuku, pastaj midis njerrëzve e shoqeve që ai nuk i njihet, duke folur e duke kakarisur. «Edhe kjo s'më kishte shkuar ndonjëherë në mend» murmuriti përsëri me vete, «gruaja ime një punëtore».

— I zymtë — i tha Gëzimi Aliut, ashtu sikur t'i thoshte për birrën: «E ftohtë»!

— Kështu e kanë këta dhëndurrët — i tha Aliu. — Janë si mëzatët, që sapo u kanë mbrehur kularin. Zverku akoma s'u është vrarë... — dhe Aliu i ra shputë zverkut të tij duke e nxjerrë atë përpara e duke qeshur.

«Shih Cezarin!» mendoi Iliri. Po nuk u përgjegj.

— Ç'ke kështu? — tha Aliu kësaj radhe seriozisht.

— Asgjë.

— Shumë i ngrysur qenke.

— Kokën e kam të rënduar.

— Do një aspirinë? — Gëzimi e nxori nga xhepi.

— Ma jep. — Ai e mori dhe e piu.

Gjatë gjithë asaj nate, kudo që ishte endur rrugëve apo anës së lumit, si nëpër errësirë një teh i hollë thike, atij i ishte shfaqur nga larg mejtimi për mësimin që u kishte mbajtur nxënësve, për kanunin. Po ai e kishte larguar. E kishte shtyr si të thuash, me dorë. Kurse tanë ky mejtim i erdhë përsëri. «Kanuni është i egër» murmuriti me

vete. Dhe atij iu shfaqën prapë ato koka të vogla, që përkundeshin në djep. Dëgjonte zërat e trashë, që i fejonin, i shisnin e i blenin ata fëmijë. «Kanuni është çnjerëzor» tha ai me vete. «Ai është turpi ynë e nderi ynë është ta luftojmë...». Atëhere atij i doli përpara ai djepi i vogël me kokën e madhe të Dritës, që përkundej sa andej-këndej. Dhe ata zëra të trashë, që sa vinin e forcoheshin... «Kjo është tjetër! Ai e gjellti përnjëherësh krikon e birrës. «Kjo është tjetër. Gruaja ime do të jetë e lirë. Unë e dua atë dhe e di se edhe ajo më do. Dhe kjo më mjafton.

...Kanuni... ç'hyt këtu kanuni?! Drita është e lirë të bëjë ç'të dojë, të shkojë ku të dojë. Le të pjellë sa fëmijë të dojë, në dashtë vajza, në dashtë djem. Le t'u vërë çfarë emrash të dojë. Dhe, po të dojë, le të punojë si mësuese, nëpunëse, ç'të dojë le të punojë... po punëtore e thjeshtë?!

— Unë ika — tha Aliu dhe u ngrit.

— Shko, Cezar, se të pret Kleopatra — i tha Gëzimi.

— Të paktën mua dikush më pret — tha Aliu duke u përkulur i téri mbi të e duke i shpupurit me duar kokën, ku, nën një petëzë floku, zbardhoi pista e lëkurës tullace... — Po ty, mor qyq, sone kush të pret? — tha dhe u zhduk në errësirë.

VIII

Që kur Lauresha i tha, se paja ishte vjetër, mëmë Efigjeni e ndjente veten të zbrazët, si ai pusi mbi të cilin, po të ulësh kryet, sheh në fund vetëm tabanin e tokës së tharë. Ta shihte njeriu

thellë Efigjenin, zbulonte tek ajo vetëm trishtimin e dhëmbjen. Me vjet të tërë ishte dërmuar në punë e kishte shpresuar që paja e së bijës të ishte nga më të mirat, që njerëzit të thoshnin: «Nusja — po! Por edhe paja...» Kurse tani vetë kjo shpresë na qenkej vjetëruar.

Sa dëgjoi Lareshën plaka, u bë pikë e vrer. Kudo që ta kafshonte gjarpëri, do të helmohej prej saj.

Edhe e bija prej kohe nuk çante më kokën për pajën. Kur Efigjeni i thoshte:

— Pse nuk merr të punosh diçka?

— Ohu... dhe ti nënë... tani janë kohëra të tjera...

Mëmë Efigjeni nuk qe fare prapa dynjasë. Edhe ajo dëgjonte e shihte. E shihte se tani kishte ikur koha e gjymeve dhe e legenëve të bakërtë, të linjtat nuk qepeshin e nuk qëndiseshin si njëherë motit. Tani vajzat shkonin në mapo dhe i blenin «kombinezonet», si i thoshin ato të mbështjella në pakos tē vogla, tē bukura. Dhe me lloj-lloj ngjyrash. Këto Efigjeni i dinte, po kur Laresha i tha:

— Paja është e vjetër... — plakën përnjëherësh e lanë fuqitë. Dhe u tremb kur dëgjoi:

— Na e shitni neve ta blejmë...

— Korba, blehet paja?!

«C'prapësi nxori nga goja ajo çupë! Le pastaj, po dhëndrrri ç'do të thotë?» «Shitën pajën...» Po çfarë nuk bëjnë këta të rinjtë? Ja, shiko Pirron e Dritën. Ajo i ka fëmijët e saj, po ata kaq shumë kanë ndryshuar... Ajo, Efigjeni, bën të gjitha t'i ndjekë ata pas me mend, po e kuption që s'mundet. Vetëm me zemër ajo ishte përherë me ta. Të rinjtë... ç'u shkrepi në kokë e s'e bënë! «Mund të

shkojë Lauresha e të thotë se paja jonë duhet blerë... e të vijnë ata pastaj....»

Plaka s'dinte ç'të bënte. T'ja thoshte, të mos ja thoshte Vangjelit. I shoqi do t'i gérthiste. Ç'ne ajo të vente e t'i tregonte pajën një çupurline të lagjes.

Më në fund, pas aq ditësh e netësh në ankth, plaka i tha të shoqit.

— Tutkune! — i shfryu ai. — Nga vete e na hap ca belara... Tani që jemi edhe me dhëndërr. Ato na duhen, që bota të dëgjojë këto gjëra...

Gruaja rrinte kruspull para të shoqit.

— Shko e ma thirrë këtu atë Lareshën — tha më në fund Vangjeli.

Dhe ajo shkoi.

Plaku u egërsua. Duart i dridheshin mbi tryezë. Mendimet, si furtunë, i shfrynin në kokë. Kishte për t'ja treguar vendin asaj çupke, dhe do t'i tregonte se si blehet paja në shtëpinë e usta Vangjelit. Ta merrte vesh edhe ajo!

Po kur vajza u duk te praku i derës e i tha «Mirë mbrëma, usta Vangjeli», plaku sikur ndjeu mbi vete një dorë që ja ropi hidhërimin e inatin, si i rjepin lëkurën një qengji.

— Mirë mbrëma, bijë — tha ai. — Si janë nga shtëpia?

— Mirë.

— Babai mirë është?

— Mirë. Falemnderit.

— Po nëna?

— Edhe nëna mirë është... ju, usta Vangjeli, si jeni?

— Ashtu... Ulu, moj çupë.

Lauresha u ul, aty në nim karshi tij. Pranë

saj qëndroi dhe Efigjeni. Për një kohë asnjëri prej tyre s'foli. Pastaj usta Vangjeli tha:

— Po si e nxirrni bukën e gojës, moj çupë?

Lauresha nuk e kuptoi ç'donte të thoshte plaku. Zgjati qafën e saj të gjatë e deshi të thoshte: «nuk e kuptoja, usta Vangjeli», po ndërkohë vajza e kapi mendimin e tij e duke u gugatur nga të qeshurit, u përgjegj:

— Punojmë... puna jonë është e lehtë...

— Puna është punë, moj bijë... punë të lehtë s'ka... — Tani Lauresha shihte mjeshtrin e dikurshëm. Edhe usta Vangjeli qëndronte para saj: si mjeshtër para çirakut të vogël...

— Ashtu është — tha vajza ngadalë. — Po maqinat punojnë vetë. Pastaj jemi shumë, shumë shoqe.

— Po — tha plaku, — kombinati është i madh.

— Do të vijnë edhe 1500 vajza të tjera. Do të bëhem 5000 punëtore.

— Sa?

Një dritë e turbullt vezulloi në sytë e plakut.

— 5000. Ka shumë nevojë pér punëtore...

Usta Vangjeli diçka belbëzoi me vete. Numri 5000 sikur qëndroi e pastaj u shkri në buzët e tij. Gjithë esnafi i xhokaxhinjve, siç kishte dëgjuar prej pleqve, nuk kishte pasur më tepër se 370 anëtarë. Kurse 5000... ky numër iu duk shumë i madh plakut pér ta kuptuar. Prandaj nuk donte të futej më thellë në këtë bisedë.

— Dëgjo, moj bijë e babait, — i tha Lareshës.

— Se çupa ime je. Si e re dhe e hedhur, ti i ke thënë gruas sime diçka pér pajën e Dritës.

Lareshës sesi i erdhi pér të qeshur, kur usta

Vangjeli tha: «gruas sime», po plaku vazhdoi:

— Ne jemi pleq, të vjetër. Mirë, keq — këta jemi. Prindërit tuaj jemi, apo jo?

— Ashtu është...

— Prandaj, si çupë që të kemi, të mos u thuash gjë atyre të kombinatit. S'kemi pajë për të shitur...

Vajza e kuptoi përnjëherësh përsë e kishin thirrur. Asaj iu dhimbën ata dy pleq, të vetëm në botën e tyre.

— Mirë, usta Vangjeli... Unë vetë mendova...

— Jo! — plaku ja preu me rrëmbim.

— Mirë — tha çupa... — Ju kotjeni shqetësuar...

— Nuk do t'u thuash gjë?

— Jo — tha vajza. — Gjersa ju nuk doni... pajë është juaja...

— Paja është jona, po ti mos e bëj muhabet, se nesër bëhet e tyrja — tha usta Vangjeli.

— Mirë — tha vajza. — Nuk i them njeriu e ju mos u shqetësoni. — Lauresha u ngrit. E lehtësuar, duke e uruar, nënë Efigjeni e përcollë gjer matanë derës së oborrit.

IX

Ata nuk ndaheshin më njeri prej tjetrit. Vëtëm kur Iliri ishte i zënë me punë të shkollës, Drita e priste me padurim në shtëpi, ose shkonte në dhomën e tij. Fshinte e pastronte. Herë-herë gatuante drekën, apo darkën, me gëzim të fshehtë që po i preqatit një të papritur. Dhe Iliri vinte dhe e gjente ashtu. Pastaj, të dy ata dilnin zëpër

qytet. Shkonin në ndonjë pastiçeri, në kinema e sidomos në fushë të volejbollit. Dikur Iliri edhe vetë kishte qenë volejbollist. Pleqtë edhe ata u mësuan me të fejuarit, megjithëse një ditë Vangjeli i tha së shoqes me hidhërim:

— Si shumë bën pas femrave ky dhëndrrri ynë.

— Pas së fejuarës së tij — tha gruaja.

— Po edhe pas së fejuarës... burri është burrë, dreqi ta hajë! Kurse ai mbeti pas fustanit të saj...

— Ai i gjorë është njeri jabanxhi — tha Efigjeni, duke kujtar me dhëmshuri të dhëndrrin.

Të rintjtë nuk ndaheshin më njëri prej tjetrit. Orë të tëra i kalonin bashkë. Drita nuk ishte më ajo e drojtura, e ngathëta. Dashuria i zhvidhosi tek ajo dëshirat e forta të femrës. Kur ishin në dhomë, edhe ditë po të qe, Iliri do të mbyllte perdet e dritäres e do të hapte abazhurin. Drita e lehtë e tij sikur i ndante ata nga gjithshka tjeter. Dhe të dy mbeteshin vetëm. Vetëm përballë njëri-tjetrit. Nën dritën e abazhurit, hijet e perdeve të rafteve dhe hijet e atyre të dyve shkriheshin në gjysmerrësirën e dhomës. Dritës i pëlqente kjo gjysmerrësire, sepse edhe në qoftë se nuk ishte më ajo e turpshmja, e para, prapë thellë në të qëndronte e pandryshuar sedra e vajzës së rritur në ambientin e mbyllur esnaf e provincial. Dhe ajo nuk donte që Iliri ta shihte në atë çast. I pëlqente drita e émbël e abazhurit dhe priste gjersa i fejuari, i kënaqur e i lodhur, të vendoste. më në fund, kokën e tij mbi shpatullën e saj të zbuluar. Ilirit i pëlqente ajo shpatull e derdhur femërore. Vendoste në të kokën e tij. Ngrohtësia e trupit të freskët të femrës përzihej me erën e flokëve të saj. Dhe ai e ndjente se si, thellë në të, diçka mashkullore dhe e

papërbajtur qetësohej e zbutej. Ajo femër i takonte atij...

Dhe ai donte ta kishte pranë. Gjithnjë, gjithnjë. Në atë qytet të vogël, brenda asaj dhome të vetëmuar beqari, mendimi i tij papra e tërhiqte tek ajo femër me fytyrë zeshkane e sy të mëdhenj dhe ai ndjente se si një zjarrmi lëngonjëse i digjte kyçet e gjymtyrëve, trupin, një si ethe që donte ta shkarconte tek ajo tjetra. Vetëm atëhere diçka e thellë, mashkullore, e papërbajtur qetësohej e zbutej në të, gjersa, më në fund, i shplodhur, vendoste kokën e vet në atë shpatullën e zbuluar, të bardhë e të derdhur të femrës. Ai e dashuronte atë.

X

Korridor i ngushtë i nëndheshëm. Nga të dy anët e tij. — tuba të shumtë e të çdo kalibri, kablo që zgjateshin e gjarpëronin nëpër faqet e mureve. Lauresha herë ecte përpara, herë e merrte prej dore, «Këndeje». Lart e poshtë venin e vinin punëtore, teknikë, vizitorë. «Banjë për punëtorët» leksi Drita, po në këtë kohë Lauresha e tërhoqi:

— Këndeje — tha ajo — këndeje nga shkallët.
Dhe ato filluan të ngjiteshin lart.

Para një viti e gjysmë, kur lagjja e tyre erdhi të vizitonte «gjigandin» e ardhshëm, atje s'kishte veçse disa ndërtesa të pambaruara. Edhe tani kombinati s'është përfunduar. Po, sidoqoftë, pjesa kryesore e tij është ngritur, rrëth 3500 punëtorë kanë filluar nga puna.

— Kujdes! — Lauresha, duke u tërhequr mënjanë, u mbështet te parvazi i hekurt e hapi udhën.

Një grup punëtoresh, duke qeshur, zbrisnin që lart me shpejtësi.

Drita e Lauresha pritën gjersa ato kaluan.

— Kush është ajo leshverdha?

— E kush i njeh... Këtu ka shumë... të reparteve të ndryshme, të turneve të ndryshme. Të gjitha s'mund t'i njohësh dot...

E ftohtë. E përbajtur. Lauresha fliste ngadalë dhe ecte përpara. Drita soditte trupin e saj të vogël, që ngjitej i lehtë nëpër shkallë. Për herë të parë e shihte kaq serioze. Në shtëpi, në shoqëri, Lauresha ishte tjetër, e qeshur, e papërbajtur. Kurse këtu... Drita shpejtoi hapat dhe iu afrua pranë.

— Ç'nur që të paska rënë — i tha duke qeshur.

Lauresha qëndroi mbi shkallën lart. Ktheu kokën e shikoi nga shoqja.

— Këtu jam në orarin e punës — tha.

Drita pa ato dy vetullat e holla, të palëvizshme që, si një teh thike, qëndronin pikërisht atje ku balli mbaronte e fillonte pastaj zjarri i syve të asaj djallushe. Dhe ajo ashtu deshi t'i thërriste tani: «Djallushe», po Lauresha hapi derën e madhe. Një bu-bullimë e papritur e mbuloi Dritën nga të gjitha anët, si ajo stuhia, që mbulon udhëtarin e vonuar në mesin e fushës së hapët. Vajza qëndroi aty te dera e repartit të madh e të gjerë. E heshtur, serioze. Përpiquej të ruante qetësinë e saj të brendshme. Në fund të fundit s'kishte asgjë të frikshme. Asgjë të jashtzakonshme. Ajo qëndronte e palëvizur te dera. I hidhte sytë sa andej-këndej. Valë-valë vinte ajo ulërimë e hekurt, e egër për veshin e saj. Ai vesh ishte mësuar të dëgjonte fëshfërimën e fshesës mbi dysheme, të dëgjonte fërfëllimën e perit, që kalonte nëpër ildi, ai vesh ishte mësuar

të dëgjonte molën, të palodhshme, që vazhdimisht brente dhogën e dyshemesë, ai vesh ishte mësuar të dëgjonte gjëmimin e lumiit të egërsuar, nëpër net plot shira dimri. Ishte një gjëmim i egër, i bren-dshëm. Po thellë, nëpër të kalonte një motiv, — i butë, nanuritës, që Drita e dëgjonte me dëshirë, sepse e dinte që ai ishte i përhershëm, kurse shpër-thimet e papërmabjtura të lumiit ishin të përkohshme.

— Eja. — Lauresha e kapi atë prej dore.
Po ajo s'lëvizi nga vendi.

Vendi i saj s'e duronte dot atë gjëmim të hekurt. Ndjente dyshemenë e çimenttë që dridhej e, ashtu duke u dridhur e tërë ndërtesa, tërë ai «gjigant» si i thërrisin kombinatit, ulërinte e shfrynte e lëshonte zëra të thekshëm, që ajo s'i duronte dot. Më kot u përpoq mos kapte ndonjë zë të dytë, më të butë e më të ëmbël. Bubullima e hekurt, e thekshme, që e pushtonte tani ngado, ishte një dhe e përhershme.

— Eja — i tha Lauresha. — Ky është reparti i krehjes.

— S'e duroj dot këtë zhurmë — tha ajo e vrenjtur.

— Do të mësohesh.

— S'besoj — tha ajo.

— Kështu kemi thënë të gjitha, po eja. — Dhe Lauresha e tërroqi shoqen e saj.

Drita i shkoi pas. Në të dy anët punonin maqinat. Midis tyre jepnin e merrnin punëtoret. Ato kishin lidhur nga një fjongo, apo shami në kokë.

— Eh, u mësove?

Drita s'u përgjegj. Lauresha e shikoi dhe buzë-qeshi. Dhe prapë filloj të ecë midis maqinave. Në

veshët e saj shfrynte gjithnjë, e egër e therëse, ajo ulurimë e parë, që s'e duronte dot. Vetëm se tani nuk ishte më e panjohur. E përhershme, çjerrëse, ajo ulerinte në veshët e saj. E pikërisht kjo vazhdimi-mësi klithëse sikur e përmblodhi Dritën. Ahere vajza hodhi sytë rreth e përqark. Reparti ishte një sallë e gjatë dhe e gjerë, plot ajër e dritë. Dhe i pastër. Pranë tyre një punëtore tërhiqte nëpër dysheme një krëhër e mblidhte pushin e pambukut. Punëtorja me moshë të thyer, i buzëqeshi Dritës dhe e përshëndeti me kokë. Edhe Drita e përshëndeti atë.

— Shumë pastër — i tha Drita Laureshës.

— Cfarë? — Shoqja u afrua pranë saj. — Folë fort — i tha — se nuk të dëgjoj.

— Shumë pastër — tha prapë Drita.

Po Lauresha e shikoi në sy dhe ngriti supet.

— Nuk të kuptoj — i tha.

Vazhduan prapë të ecin. Maqinat punonin në mënyrë ritmike, pa u ndalur, dhe ashtu ritmikisht gulçonin të gjitha së bashku.

— Shpresë!

Lauresha rendi midis maqinave e shkoi drejt punëtores së vogël, topolake, me një rrip të kuq mbërthyer te flokët. Kjo e pa dhe hapi krahët. Ato u përqafuan, u puthën. Dhe, duke qeshur, mbareshin dorë për dore. Drita u afrua e Lauresha diçka i tha Shpresës. Kjo hapi prapë krahët e saj që të pushtonte të porsaardhurën. Po ishte tepër e shkurtër, kurse Drita e gjatë. Kështu që njëra u përkulë tjetra u zgjat në majë të këmbëve. Shpresa e puthi Dritën me po atë afsh që puthi edhe Lareshën. Dhe, duke mbajtur nga njëra dorë njérën e nga tjetra — tjetrën, i vështronët ato në sy, qeshtë e s'thoshte asgjë.

— Kjo është një shoqja ime — i tha Lauresha asaj.

— E mirë? — Shpresa i picërroi sytë.

— Si të thuash — tha Lauresha, duke ngërdheshur fyttyrën. Shpresa u kukurisi. Po ajo pa Dritën, që qëndronte e heshtur e përnjëherësh u bë serioze.

— Eh, — tha ajo — sa e mirë qenka — dhe deshi ta pushtonte edhe një herë, po s'mundi dhe e kapi prej beli. E tërroqi pranë. — E mirë është — tha ajo dhe e mbështeti kokën e saj në shtat të Dritës. Kjo e kuptoi që vajza ishte naive dhe pa nga Lauresha. Ajo, prapa saj, qështe.

— Me këto maqina punoj edhe unë — i tha Lauresha Dritës.

— Këtu?

— Këtu... Shpresa punon tani, kurse unë punoj në turnin tjetër.

— U mbush — i tha Drita Shpresës, duke i trenguar koshin prej kartoni — gjer në grykë me fije të krehura.

— Jooo. — Shpresa kaloi dorën mbi lesh. Susta u ul dhe një pjesë e mirë e koshit u boshatis.

Drita u çudit. Vuri edhe ajo dorën në kosh e ndjeu suspasionin e tij; pastaj preku ato fije të bardha, të përdredhura e të endura të pambukut. Asnjëherë nuk kishte prekur me duart e saj fije aq të buta. Sa lesh kishin larë, kishin krehur e kishin dredhur ato nënë e bijë! Po kjo ishte një fije e hollë, e butë, e bardhë, si shkumë qumështi. Asnjë dorë njeriu s'mund ta prodhonte atë. Drita u ul e tëra mbi maqinë. Rulat e hekurta rrrotulloheshin në drejtime të kundërtë dhe nga buzët e tyre rridhte ajo shkumë qumështi prej pambuku.

— Maqinat punojnë automatikisht — tha Shpresa.

Pambuku i pastruar shkrifej... Shpresa fliste. E Drita e dëgjonte. Po ajo s'po kuptonte shumë gjëra nga ato që thoshte punëtorja. Vetëm, nëpër fjalët e saj, kapte disa terma të njohura, si «korenti», «dinamoja»... Kurse përgjithësisht s'po merrte vesh gjë.

Lauresha e zuri prej dore dhe ato u ndanë nga Shpresa. Punëtorja i puthi, po me atë zgarr që i puthi dhe më parë. Po kur ato u larguan, Shpresa u thirri:

— Laureshë, mos harro të vish në mbledhje pasdreke. Të dy turnet janë bashkë. «Kontrolli i klasës punëtore». Do vish?

Fytyra topolake e punëtore u vrenjt.

— Do vish? — pyeti ajo përsëri Laureshën.

— Do vij... — u përgjegj kjo e menduar. Për herë të parë Drita pa vetullat e saj të holla të ulen poshtë.

— Nuk do t'i lëmë më — tha punëtorja. — As shefi i repartit, as zëvëndësdrejtori s'do të bëjnë më si të duan. Këtu jemi ne.

Duke parë punëtoren, Drita u çudit se si ajo fytyrë topolake, e butë, mund të egërshej ashtu.

— Kontrolli i klasës punëtore — tha kjo nëpër dhëmbë.

— Do të vij — tha Lauresha.

— Ç'është? — e pyeti Drita atë.

— Telashet tonë... — Lauresha vuri buzën në gaz. — «Kontradiktat tonë» — tha a'o dhe u nis.

— Këndejej — i tha pastaj Dritës dhe ato u kthyen në të djathtë.

Një repart tjetër, po aq i gjerë e i gjatë dhe

po ashtu i pastër e i mbushur me ato maqineri të reja, që shkëlqenin prej së largu e dridheshin nga ajo fuqi e padukshme, që i ushqente dhe i bënte ato qenje të hekurta të lëshonin atë gulçimë konvulsive.

— Reparti i endjes — tha Lauresha.

Tani ngadalë, e çliruar, Drita ekte pranë shoqes së vet. Punëtoret e ndryshme e përshëndesnin dhe i buzëqeshnin. Edhe Luaresha i përshëndeste. Dhe sytë e saj ndizeshin çdo herë e më tepër.

— Kush është kjo? — Drita u përkul mbi shqen e vet.

— Është nga Qyteti Stalin.

— E bukur qenka!

— Oh, sa të bukura ka këtu!.. Të shohësh, do të të njoh me ca... — i tha ajo, duke i shkelur synë.

Drita ja dha të qeshurit. Vetëm ajo e shkelur syri nuk i shkonte Lareshës. E, megjithatë, prandaj ishte e lezetshme.

Maqinat atomatike punonin. Masuret me perin e bardhë rrrotulloheshin e nga ruleja tendosej pëlhura e bardhë. Drita qëndroi. Punëtorja, që shërbente, ishte larg në maqinat e tjera dhe Drita e vetme shkonte e qetë; vërente me kujdes çdo vegël e çdo lëvizje të maqinës. Lauresha u përzie me disa punëtore të tjera dhe ato diçka po bisendonin. Drita ndiqte me vëmendje pëlhurën e bardhë që grumbullohej e mblidhej top, kur, përnjëherësh, maqina u ndal. Punëtorja rendi aty. Këputi nja dy fije e pastaj i lidhi majat e tyre. Maqina filloj të punojë e të gulçojë, si më parë. Drita u largua prej andej.

Ashtu vizituan disa reparte. Dhe vetëm në fund Lauresha qëndroi para një dere.

— Këtu — i tha ajo Dritës.

Në krahasim me sallat e reparteve të mëdha, kjo ishte një dhomë e vogël, e ngushtë. Kishte disa tryeza të gjata. Tri vajza e dy djem, të kërrusur, punonin mbi disa karta e bojëra.

— Kristo, ta prura «patën e egër».

Dikush ngriti kokën, shikoi Dritën e vazhdoi prapë të punonte. Nga mesi i bankës së dytë, u ngrit ai që quhej Kristo.

— Mirë se ardhët!

Ata u përshëndoshën.

— Tani — i tha Lauresha Dritës -- ilu -- dhe i zgjati karrigen.

— E more pagën? — Njëra prej vajzave pyeti Lareshën.

— Pse, sot është dita?

— Oh, ti s'ditke as ditën — tha tjetra duke qeshur.

— Qajini hallin Lareshës — tha Lauresha — se të vegjëlit duhen ushqyer.

— Po të tutë janë ata? — i tha prapë vajza e parë.

— Jo, janë të babait — tha Lauresha duke i shkelur synë e duke qeshur.

— Dhe i ushqen ti? — e pyeti atë një zë burri Ai që pyeste s'e ngrinte kokën.

— Po edhe unë... vëllezër i kam...

— Qendizma juaj është shumë e bukur — i tha Kristua Dritës duke i treguar çarçafin lino që Lauresha kishte sjellë aty. — Sikur të mund të bënim një disenj të tillë... Më pëlqen shumë jo

vetëm shpendi i bardhë, po edhe kjo përkulja elegante e krahëve...

Dritës sesi i erdhi kur dëgjoi fjalët: «përkulja elegante». Dhe, ndërsa ai fliste, ajo e vërente me kujdes. Ja kush na qenkej ky Kristua! Pastaj, kur të ishin vetëm do t'ja tregonte ajo Laureshës. Kurse... ai ishte një djale me flokë kaçurrel, të zez, me trup të hollë e delikat. Duke e parë ashtu, Drita e kuptoi: në atë «përkulje elegante» Kristua kishte përcaktuar vetë qenjen e tij.

— Po këtë rrotullim të kësaj tjetrës... —
dhe Kristua filloi të shpaloste çarçafin para Dritës.
Kjo e shihte me vëmendje. Kur ai afroi pranë, ajo
ja mori çarçafin nga duart, e pa dhe tha:

— Unë ashtu e kam parë.

— Si, ashtu e keni parë?!

— Ato kalonin tufë, njëra pas tjetrës. Vinin
varg nga gryka e lumi. Vende-vende kishte re.
Duke fluturuar, ato iu afroan qytetit. Të tjerat flu-
turuan drejt, kurse kjo hyri midis reve. U lëshua
lart. Krahët e saj sikur u shtrinë me atë lëmsh
reje...

Kristua shihte qendizmën mbi çarçaf. Një shtë-
llungë e bardhë, spirale, që sa vinte e hapej. Nëpër
të fluturonte pata e egër. Kur mbaroi Drita, ahore
Kristua pa se si krahët e shpendit me të vërtetë
shkriheshin në tymin e reve.

— Si nuk e kam parë këtë — murmuriti aì
me vete.

— Kurse këto — i tha Drita duke ndjekur
bordurën e çarçafit, — këto po këndojnë.

— Këndojnë?! — Ai e shikoi atë i habitur.

— Po — tha ajo. — Ahore ishte ditë e vrenjtur.
Dhe, kur patat iu afroan qytetit, një vetëtimë

shkrepi në qjell. Unë prisja që të bubullinte, kur shpendët u lëshuan poshtë si shigjetë, u ulën fare mbi qytet dhe ahore m'u duk sikur këndonin...

Kristua e pa atë në sy. Po nuk i tha gjë. Atij as do t'i kishte shkuar ndër mend se ajo tufë patash të egra, që lëshohej poshtë si shigjetë, këndonte nëpër dritën e vetëtimave.

Lauresha hyri tërë gjësim. Ajo e kishte marrë pagën.

— Ke fat — i tha Dritës, duke i treguar të hollat. Do të shkojmë në bufe. E Kristo, — iu kthyte pastaj djalit. — Mbarove?

— Mbarova.

— Si të duket?

— Më duket se mbarova dhe ju mund të shkonë në bufe.

— Po bëhet dot?

Kristua s'u përgjegj.

— Po unë nuk qëndisa gjë — i tha Drita atij.

— S'ka nevojë — i tha ai. — Ju më shpjeguat kaq gjëra.

— Ti nuk do vish në bufe?

— Më vonë, Lareshë. Ju shkoni.

— Po të presim.

Ato dolën.

Bufaja ishte plot e përplot. Tryezat ishin zënë. Grumbuj punëtorësh rrinin në këmbë. Te banaku kishte një sulm të vërtetë. Qofte, sallsiçe, byrekë dhe birrë. Birrë në këmbë. Nëpër tryеза. Lauresha e kapi Dritën prej dore dhe çau midis disa punëtorëve, që rrinin më këmbë. Ata u hapën udhë. Vajzat kaluan. Po para se ato të afroheshin te banaku, një grumbull punëtoresh i arriti e, duke i shtyrë, i ndau nga njëra-tjetra.

— Më falni... — tha njëra prej tyre.

Ajo ishte një vajzë e re, nja 19 vjeçë, leshverdhë. Kishte mbathur sandale të sheshta e, si shumica e punëtoreve, kishte veshur pantallona. Të ngushta. Te hekurosura. Ajo e dinte që ishte e bukur e s'kishte lënë asgjë për ta treguar këtë.

— Më falni — i tha Dritës, duke e goditur më bërryle, në ije e duke u shtyrë me shoqet e veta drejt banakut.

— Asgjë — tha Drita, ndonëse i dhëmbi brinja.

Vala e vajzave e nxori Laureshën në krye të banakut.

— Laureshë, merrmi edhe mua.

Vetëm ahere Drita e pa shoqen e vet. U çudit se si kishte arritur gjer atje. U tërhoq mënjanë dhe u mbështet pas murit. Ju duk vetja e tepërt, e huaj në atë botë të madhe, të panjohur e të pakuptueshme për të.

— Paguaj unë.

Ishte një zë i fortë dhe i ashpër femre.

— Paguaj unë...

Ajo ishte një vajzë me një fytyrë të rrumbullakët, të zezë, kishte një hundë pince e mjekër disi të kthyer para. Në mes të mjekrës — një gropë.

— Jo — tha një djalë midis tyre. — Paguaj vetë.

Punëtorja e zezë e shikoi atë me inat.

— Pse? — tha ajo. — Sot të gjithë morëm pagën e dua të paguaj unë.

Dhe ajo përplasi pëllëmbën e vet mbi banak.

Cupat e tjera qeshën. Edhe banakierja qeshi.

— Oj, — i tha punëtorja asaj — sikur nuk vlekan paratë e mia...

— Jepu... — i tha ajo banakieres, duke shikuar me inat atë djalin që foli.

— Mbaje... — Lauresha e lëshoi gotën e birrës në dorë të Dritës. Po në dorën e saj mbetën dy gotat e tjera. Drita e vështroi me një shikim pyetës.

— Kjo është e Kristos — tha vajza.

— Ja kush na qenka ai, Kristua yt... — buzët e Dritës u tkurrën në romuzin e vet.

— I mirë është, ë?

Pjetja e Lareshës ishte aq e papritur dhe naivë, sa Drita përnjëherësh qeshi. Dhe ajo do të dëshëronte t'ja shante Kriston, po s'gjeti përsë, prandaj i tha vetëm:

— Delikat... Po ti e do?

— E dua...

— A e di?

— E di, po bën sikur s'e di, dreqi...

Në këtë kohë Kristua po vinte drejt tyre. Ngadalë dhe i heshtur, ai ecte midis turmës së punëtorëve.

— C'djallin ka — tha Lauresha, duke e parë të menduar.

— Çfarë?

— Shumë serioz. Kurrë s'e kam parë kështu.

Në këtë kohë punëtorja bjonde kaloi pranë tyre. Me duart futur në xhepe të pantallonave, ajo ecte duke lëvizur sa andej-këndej vithet e hajthme.

Lauresha i shkeli synë Dritës. Ishte prapë e shkelur fëminore, çapkëne e Drita ja dha të shurit. Kur u bashkua Kristua me to, vëparteve ecte pranë qeshnin.

— Na — i tha atij Lauresha e staj ajo radhë birrës. — Tani mba dhe qoftet tonë mat e ndryshme të i lëshuar letrën e bardhë në d

- S'ka vend? — Kristua shikoi rreth e rrotull.
 — Siç e sheh... gëzuar.
 Ata pinë.
 — E si — i tha Lauresha Dritës, — të pëlqen?
 — Dhe ajo filloi të imitonë të ecurit e bjondës.
 Ato qeshën prapë. Kristua, i menduar, shikonte Dritën.
 — Eh? — i tha Lauresha atij — mos re në dashuri? Thuaja motrës...
 — Jo — i tha Kristua...
 — Sidoqoftë, të paralajmëroj: Drita është e fejuar me një king.
 — Mortje. — Drita i mbylli asaj gojën.
 — Nuk di — tha Kristua — a do krijojmë dot një disenjo me ata shpendë... do të ishte fantastike.
 — Të kam thënë. Ti s'më besoje... T'i shpjegoi Drita?
 — M'i shpjegoi... po hajde jepe këngën e patës së egër në shtërgatë...
 — Jo vetëm në shtërgatë, por edhe në trupin e vajzave të reja — tha punëtorja, duke qeshur e duke treguar me dorë shtatin e vet.
 Në veshët e saj e pérhershme, e pandalshme gjëmonte ajo ulërima e egër e gjigantit të hekurt. Atje në heshtjen e dhomës ai gjëmim bëhej më i padurueshëm e therës. Dritës, që ishte shtrirë mbi shtrat, i dukej sikur vetë dhoma, shtëpia e tërë dridhej e tundej, së bashku me dyshemenë e gjimentitë të reparteve. Thua sikur një botë e madhe, e hekurt, e panjohur dhe e paftuar, ngjiti atë ditë me Dritën ato shkallë të drunjta të shtëpisë së vëtmuar të usta Vangjelit.

U ngrit nga shtrati. Shkoi te dritarja dhe shikoi jashtë. Tej, kantieri i punimeve ziente. Buldo-

zeri vente e vinte, po zhurma e tij qe e largët, e pafuqishme për të thërmuar atë rënkim të thellë të patrandshëm të kombinatit. Duke ndenjur në këmbë aty te dritarja, ajo ndjente se si çdo vibracion i hekurt i frysëmarrjes së tij ishte futur në trupin e saj.

Lauresha e kishte ftuar të vente e të bisedonte me Kriston për qëndimën e patave të egra; me këtë rast të vizitonte edhe kombinatin. Dhe ajo vajti. Po seç ndodhi me të nuk e kuptoi. Ajo turmë e madhe dhe e pambaruar punëtoresh, të ndryshme, të vjetra, të reja, të bucura, të shëmtuara, të ngjallura, të dobëta, po shumë, shumë... Numra ajo kishte dëgjuar 3000-3600-5000... «Do të bëhen 8000» i kishte thënë Lauresha. Po numrat janë numra. Njerëzit-njerëz. Dhe të shohësh këta mijëra njerëz tek punojnë nëpër ato reparte të mëdha, të pastra...

Një shtëllungë e ftohtë ajri i rrënqethi trupin. U largua nga dritarja dhe mbërtheu bluzën e vet. U shtri prapë në shtrat. Të shohësh ato vajza të reja, të gëzuara, tek punojnë nëpër ato maqina e maqinat vetë të pandaluara, të palodhura tek prodhojnë... Asaj i doli përpëra prapë Shpresa. Ajo hapi krahët, u zgjat në majat e këmbëve dhe e puthi, pastaj qeshi, pastaj u përkul mbi të pér t'i shpjeguar procesin e prodhimit të maqinës. Drita ktheu kokën dhe e pa në sy. Shpresa fliste paresh-tur, kurse maqinat punonin pa pushim. Kjo ishte diçka e panjohur, e pakuptueshme për atë, Dritën. Në fillim ajo pati frikë, përpëra atyre reparteve të mëdha. Iu dukën të pafund, prandaj ecte pranë Laureshës. E ndrojtur. E pasigurt. Pastaj ajo radhë e pandalshme dhe e pafundme maqinash, që të gjitha së bashku, të reja, me format e ndryshme të

tyre, shkonin e formonin një pamje të paparë e të habitshme. Po ajo s'e dha vete. Gjatë gjithë kohës kishte qëndruar ajo që ishte. Kudo një lloj dhe e njëjtë. Si në shtëpi, si në rrugë, si në kombinat. E heshtur. E mbyllur në vete. Kurse thellë në të bota e mëparshme e saj ishte thyer e thërmuar e ajo ndjente tani një zbrazëtirë të pafund.

Sa zbriti nga autobusi e hyri në oborrin e kombinatit, që kur u ndodh midis atij lumi të madh e të pandalshëm njerëzish, asaj iu duk sikur humbi, sikur nuk ishte vegse një pikëz uji, e panjohur, e parëndësishme. Dhe kur pa Laureshën, fytyra i ngazëlloi. Shoqja po e priste, aty brenda oborrit të kombinatit.

Drita u ngrit nga shtrati. S'dinte ç'të bënte. Donte të harronte gjithshka, të qetësohej e të flinte. Nata kishte rënë e të gjithë po flinin. Mori një libër dhe e hapi të lexonte. Po, duke lexuar, përsëri eci midis atyre punëtoreve të kombinatit. Gjithshka përreth ishte e panjohur dhe e pakuptueshme. Ajo qëndronte e patronditur në pamjen e jashtme, por për herë të parë në jetë ndjente përbrenda një rrokullimë të turbullt, të pandalshme, si një ortek që përmbysej thellë diku. Ndërsa Shpresa, e përkulur mbi të, i shpjegonte se si punonin ruletë, masuret e prodhohej pambuku. Ajo ngriti sytë dhe e pa përsëri punëtoren. Shpresa qeshi. Sytë iu mbushën me shkëndija. Dhe në atë xixëllim të syve, Drita e ndjeu: punëtorja ishte naive. Edhe Lauresha ja bëri nga pas me sy. Drita qeshi. Po thellë në vete për herë të parë ajo ndjeu një cmir, që iu fut në zemër si një majë thike e mprehtë, e hidhur. Dhe deshi të thërriste, të ulërinte. Lë të bashkohej thirrja e saj me këtë gulçim të hekurt të dheut

e të qiellit këtu e le të humbiste e të shkërmorëj në këtë rënkim. Veç ajo do të thërriste një herë. Po nuk thirri. Pa Shpresën në sy dhe ndjeu si shkëndijëzat e zjarrta të shikimit të saj e verbuan, ashtu si shpeshherë na verbon një flakërimë dielli. Po ne prapë e shohim, duke i mbajtur me zor sytë e hapët. Ashtu dhe ajo e shikonte Shpresën. E nuk thirri. Kurse tanë, në vetëminë e dhomës, me librin hapur midis duarve, po e kuptione: nuk kish thirrur, sepse nuk kish dashur të pranonte që ajo, Drita, nuk ishte gjë para atyre, s'merrte vesh fare nga ato që i thoshte e i shpjegonte ajo Shpresa bullafiqe e përkulur mbi të, veç disa termave të përgjithshme; ajo s'kuptione asgjë e nuk ishte njeri i po asaj bote që ishte ajo, Shpresa. «Dhjetë maqina» — tha punëtorja, kur Drita e pyeti se sa maqina kontrollon. «Dhjetër... të tilla, të hekurta, me një forcë të pakuptueshme e të panjohur». Dritës iu duk sikur të dhjetë këto maqina ishin një vazhdimi e hekurt e të dy krahëve të Shpresës. Kurse vetë ajo, Drita, kishte mbajtur në duart e veta vetëm dy biza, apo një gjilpërë. Ajo ishte e një bote tjetër. Të vogël, të pafuqishme. Gjithë forca e asaj bote qëndronte te një gérshërë e te një gjilpërë. Asaj bote i kishte përkitur e ëma. Asaj bote i përkiste dhe ajo, Drita. Fjalët që përdorte Shpresa, «tension», «ritmike», «elektrike» edhe në qoftë se i njihte si terma të përgjithshme, ishin të panevojshme e të papranueshme për këtë botë të vogël, këtë botë që dhe tanë, atje midis atij gjëmimi të hekurt, mbante prapë atë qetësinë e jashtme të saj, të heshtur, dinjitoze, por që brenda ulërinte nga dhëmbja, sepse ajo Shpresa e botës tjetër ishte shumë e fuqishme. Ajo kish forca të nëndheshme,

të pashtershme, pikërisht atë «tension», atë «dynamo», atë «frikë», që s'i njeh bota e asaj, e Dritës. Ajo kish forcë ato katër maqinat që i bindeshin asaj, Shpresës, me atë urtësi e lehtësi, me të cilat ajo vetë, Drita, i bindet usta Vangjelit.

E mbylli librin. Hapi derën dhe shkoi në kuzhinë. Qetësi. Nëna e babai flinin në dhomën tjetër. Pjatat e darkës kishin mbetur mbi tryezë të pambledhura. Vajza i mblodhi e filloi të pastrojë e të rregullojë tryezën. Si e rregulloi kuzhinën, ajo u ul në nim. Po mendimi i fluturoi prapë në kombinat. Dhe ajo pa atë punëtoren flokëverdhë, që i kaloi përpara te parvazi e shkallëve të hekurta, kur ngjitej për në repart. «Kush është kjo?» «E kush e njeh... sa ka këtu në reparte të ndryshme, në turne të ndryshme...» Si ishte e mundur! Të mos e njihte... Po në lagjen e tyre ato njiheshin të gjitha. Njerëzit atje dinin me rrënëjë e dhëmballë gjithshka për tjetrin. Bile ata dinin edhe ato që njeriu s'i di për vete. Ku ta dish ti, Nikua i Kates, se nuk je i biri i Spiros? Po usta Vangjeli dhe Efigjeni e dinin. Atje në mëhallë njerëzit dinin se kush kish govatën më të madhe për të larë rrobat, kush kish hekurin më të mirë për të hekurosur dhe se Moisiu do ta linte të shoqen... E shoqja s'e dinte, po ata e dinin... Kurse atje në kombinat, nuk njihnin dot njëra-tjetren.

«Edhe ato telashet... kontradiktat tonë», si tha Lauresha duke qeshur, edhe ato ishin të tjera, jo si grindjet e vogla e të pafund të Efigjenit me usta Vangjelin, apo të xha Nasit e të tetë Dhoksisë me usta Vangjelin. Jo. Ato ishin të tjera. Të një bote tjetër. Në to futej ai shefi i repartit, ai zë-vendësdrejtori dhe ai i «kontrollit punëtor». Ja, kjo

madhësi e kësaj bote ishte e pakuptueshme për atë, Dritën.

U ngrit nga nimi dhe doli nga kuzhina, zbriti shkallët e jashtme të oborrit. Natë. Errësirë. Vazot e luleve të heshtura, qëndronin në të dy anët e kalldrëmit. Hijet e kumbullave nxinin nëpër terr. Ajo ecte ngadalë. E vetme. E menduar. Nuk mund të rrinte dot në një vend. Zhurma e kombinatit i gjëmonte në kokë. E ndiqte pas. Dhe ajo shihte ata rreshta të pafundmë punëtoresh. Ato punonin pranë maqinave. Pastaj asaj iu kujtua dhoma e vogël e disenjatorëve. Iu duk «e vogël», sepse ajo vajti atje, nga repartet e mëdha. Kristua qëndronte para saj, i heshtur, kureshtar. Pastaj bufeja. Sa shumë njerëz!.. O sa shumë njerëz, që kishte atje! Ajo s'kishte parë kurrë aq shumë njerëz të grumbulluar bashkë. Dhe në errësirë, e vetme, ajo murmuriti tani: «Oh sa shumë njerëz...»

Ngadalë u kthyte e filloj të ngjitte shkallët e shtëpisë së heshtur.

XI

Iliri mbështeti kokën e vet mbi shpatullën e saj, po ajo s'po dëgjonte më atë frymëmarrje ritimike, të thellë, atë rënkim të lehtë, me të cilin tashmë ishte mësuar. Frymëmarrja e shpeshtë e Ilirit herë pas here ndërpritej dhe ajo e kuptonte që i fejuari ishte i zemëruar dhe i papërbajtshëm. Kësaj radhe ai i mbështeti kokën mbi shpatullën e saj më tepër për të ndërprerë bisedën midis tyre. Pastaj folën për shumë gjëra e, si zakonisht, fjala ra prapë te Drita dhe te puna.

— Ty tē duket e lehtë — tha Iliri, — sepse s'e ke provuar. Kur tē shkosh e ta shohësh një herë...

— Unë e di që s'është e lehtë, po s'është dhe e pamundur. Me mijëra tē tjera punojnë.

— Ato s'janë si ti.

— Pse? Edhe ato shoqe tē mia janë. Unë isha nē kombinat...

— Prapë me kombinatin?! — Fytyra e tij u skuq dhe ajo i pa duart se si përnjéherësh filluan t'i dridhen. — Unë shkoj nëpër komitete tē tē gjej punë; kérkoj miq e shokë që t'i fut shefit mos tē tē emrojë diku, kurse ti më bredh kombinateve.

— Unë nuk shkova atje tē kérkoja punë.

— S'ke pse tē shkosh atje!

Ky ishte urdhër. Dhe Iliri ashtu e tha, tē prerë, si një urdhër. Dhe ajo e kuptoi: ai që i fliste këtë herë nuk ishte i fejuari i saj i dashuruar, po burri i ardhshëm, i rreptë. Zemra filloi t'i ftohej në krahror. Pikërisht ahene ai u ul, e mbështeti kokën e vet mbi shpatullën e saj. Ajo ndjente se si frymëmarrja e tij, herë pas here, ndërpritej.

— Ilir, — ajo fliste ngadalë... fjalët mezi i dëgjoheshin... — Unë s'ta kam thënë, kam pasur turp, po dhe pensioni i babait nuk na del...

Ai u ngrit. Me kurriz tē kthyer nga Drita, qëndroi në mesin e dhomës. Filloi tē ndezë cigaren.

— Mos duhej tē ma thoshje ti pér ta kuptuar? — tha ngadalë. Dhe filloi tē vinte rrrotull nëpër dhomë, i heshtur. Drita e shihte atë tek thithte thellë cigaren, shfrynte shtëllungat e tymit, prekte me dorë librat e pastaj largohej prej tyre. S'dinte ç'të bënte. Hapi radion. Një zë i zgjatur oriental filloi tē zvarritej nëpër dhomë. Duke bluar disa fjalë tē pakuptuara, ai e mbylli çelësin. Zëri sikur

u shkrumbua e në dhomë ra prapë qetësia. Ahere ai përnjëherësh flaku përposh cigaren, kapi kokën me të dy duart e, duke i tërhequr fort flokët e dendur, tha me një frysë:

— Po mirë, xhanëm, mirë... po mua më kishit pritur?... Duhej të via unë që të bindja tët atë, të të gjeja punë, të kuptoja që pensioni nuk ju dilte? Duhej të via unë, që ti, gruaja ime, të shkoje e të bëheshe një punëtore e thjeshtë kombinat!?

Ai fliste shpejt, pa u ndalur, shikonte drejt Dritën dhe, sa më shumë fliste, aq më tepër sytë e tij zmadhoheshin prej hidhërimit.

Ajo dëgjonte dhe heshtte.

— Mirë — tha më në fund ai, — do bisedoj unë me babën.

XII

Vangjeli nuk e shikonte të bijën në sy. Heshtte kokulur dhe merrte frysë rëndë. Vajza u drodh. Ajo nuk ishte frysëmarrje. Ishte një rënkim i thellë, i papërmabjtshëm, që babai përpinqej ta mposhtë, ta fshihte e nuk arrinte dot. Vajzës iu dhimbs i ati. Mori diçka t'i thoshte, po në atë çast ai ngriti kokën e tha:

— Unë të bëra e të rrita...

Dhe heshti. Hodhi shikimin te Efigjeni, pastaj rrotulloi sytë mbi sobë, musandër, mbi muret e kuzhinës. Mendimi iu këput në mes. Ai përpinqej ta kapte e s'po e arrinte dot. Më në fund e përqëndroi shikimin përsëri mbi të bijën.

— Kështu... — tha ai... — Unë të bëra e të rrita... — Mendimi prapë iu këput e përsëri heshti.

Kësaj radhe Vangjeli nuk i hoqi sytë nga e bija.
— Mirë, keq, — tha duke u përpjekur me çdo kusht të lidhë mendimin e vet: — mirë, keq, po unë të bëra ty... kështu si je... dhe burrin ta gjeta...

Efigjenit iu drodhën duart nën përparëse. Frika sikur po i shtrëngonte zemrën. Shihte me sy të bijën, të ulur aty mbi karrigë e dëgjonte të shoqin që fliste. Zëri i tij sikur vinte nga largësi të thella e të errëta.

— Unë e kisha për detyrë — tha ai — dhe burrin ta gjeta...

Ata u shikuan në sy. Fytyra e zhübavitur e plakut iu duk vajzës e akullt dhe e huaj. «Ta gjeta burrin» pëshpëriti ajo instiktivisht fjalët e tij. Në fillim nuk e kuptoi as vetë pse i pëshpëriti ato fjalë, si i pëshpëriti. Kurse i ati para saj filloj prapë diçka të thoshte. Fytyra e zezë dhe e madhe e tij ngadalë lëvizte buzët, po çupa s'dëgjonte gjë nga ato që thoshte ai. «Ta gjeta burrin», këto fjalë sikur i ranë asaj shuplakë e tanë po i shungullonte timpani i veshit e dhimbja po përhapej ngado në trupin e saj. Ballin filluan t'ja mbulonin djersët. «Ta gjeta burrin» ... Ajo përshkoi me dorë fytyrën. Mbuloi sytë. Kishte turp të shihte njeri, qoftë edhe të atin e saj. «Ta gjeta burrin...» Ajo vetë s'kishte qenë e zonja të gjente një burrë, një mashkull, që do t'i duhej për tërë jetën. Duhej dikush tjetër t'ja gjente. Qoftë dhe i ati i saj. Dhe ai tanë po ja përplaste në fytyrë. Dhe ajo kishte turp ta shikonë në sy. I mbulonte sytë me pëllëmbën e vet. «Ta gjeta burrin...» i gjëmonin asaj si ushtimë në vesh.

— Kurse ti po e përzë... arriti gjer në vesh të
saj zëri i rëndë i të atit.

— Unë?!

Ajo brofi në këmbë.

— Po kush, unë?!

Duke e parë nga lart, ajo fytyrë e zezë, me
ato buzë të trasha, që lëviznin, iu duk asaj e gurtë,
indiferente, si një maskë që dikush ja kishte ngjitur
babait në fytyrë. «O zot!» mendoi ajo, me vete.
«Kurrë s'e kam parë kështu... vërtet i tillë është?»

— Ulu — tha ai.

Ajo u ul.

— Kërkon të punosh në kombinat?

— Po — tha ajo.

— Po përsë?

— Si përsë?

— S'ke krodhë të hash?

Për herë të parë fytyra e zezë lëvizi e tëra.
Vangjeli i dha kokës pas dhe me sy të stërhapur
shikoi të bijën.

— Ti, moj çupë, i ke të gjitha — tha ai. —
Mbase nga pak, por i ke. Edhe dhëndrrri nuk
është i keq. S'kërkon asgjë. Çfarë t'i japim. Dhe
ne diçka do t'i japim... Nuk do ta lemë duarzbrazët.

— Po unë çdo të bëj? — tha vajza ngadalë. —
Gjithnjë kështu...

— Ti?

Sytë e usta Vangjelit sikur u mblodhën, u
bënë të vegjël të vegjël e filluan të lëshonin një
dritë, që binte mbi të bijën. «Këta janë sytë e ba-
bait...» mendoi ajo.

— Ti ç'do të bësh, moj çupë e babait? — tha
ai. — Ti do të jetosh në shtëpinë tënde, zonjë me

burrin tënd, me fëmijët e tu. Edhe ne duam tani në pleqëri të na gjëzosh me ndonjë nip, me ndonjë mbesë. —

Plaku hapi duart e thata e filloi t'i lëvizë përpara këmbëve të tij, sikur me të vërtetë të kishte diçka përpara. — Duam edhe ne — tha — para se të myllim sytë e të shkojmë në varr, të lozim pak e të çlodhemi me ndonjë «kukull të gjallë...» Apo jo, moj Efigjeni, — iu kthye ai gruas.

Rrallë usta Vangjeli i thërriste së shoqes në emër.

Efigjeni po qante. Lotët i rridhnin mbi faqe dhe ajo s'i fshinte. I linte të rridhnin.

— Ja — tha usta Vangjeli. — Të të vijë keq edhe pér këtë të mjerë. I kujton nipin apo mbesën e shkrihet në vaj. Ç'ke, moj, ti? — I tha ai me zë të gjuar së shoqes. — Edhe nipi do të vijë në shtëpi, edhe mbesa... Dhe ti do t'i gjëzosh e do t'i trashëgosh... Po unë, me sa duket, nuk do të jem... — tha.

«Ti, moj çupë e babait? Ti do të jetosh në shtëpinë tëndë, me burrin tënd, me fëmijët e tu...» Babai deshi të të thoshte: «Ja, si jot èmë». Po ai nuk e tha. Veç ajo e dinte: babai ashtu do të dëshéronte të thoshte. «Ja, si jot èmë. Zonjë në shtëpinë e vet. Dhe në jetën e saj ç'i ka munguar? — Asgjë. Ndoshëta i ka pasur të pakta. Jetë èshtë kjo. E unë në fund të fundit nuk kam qenë ndonjë tyxhar. Me një dyqan e me këto duart e mia e kam mbajtur shtëpinë. Dhe sat ème s'i ka munguar asgjë. Nuk ka vajtur të shesë krahët e saj pér një kothere bukë, si bënин të tjerat...» Babai këto nuk i tha, po ajo e dinte që ai kështu do të dëshéronte

t'i thoshte asaj. Kurse ai e hodhi fjalën te nipërit, te mbesat dhe Efigjeni qau. Kjo me të vërtetë ëndërronte të mbante në krahë një «kukull të gjallë». E kish marrë malli. Kur shihte foshnjet e nuseve të mëhallës, s'u gëzohej dot. Koha kur të dy fëmijët e saj, Pirrua e Drita, ishin të vegjël, kërthi, kish kaluar e kish mbetur shumë pas. Kurse atë e kish marrë malli. Donte të bëhej gjyshe...

Babai ashtu do të dëshéronte t'i thoshte: «Ti? Ç'do të bësh ti? Do të jetosh si zonjë në shtëpinë tënde. Që të të kenë zili... Ashtu siç kanë pasur dhe tëtën emë... Po ju jeni të çuditshëm, ju të rinjtë». Drita shihte prapë sytë e butë e të shndritshëm të t'et. «Ju jeni të çuditshëm, mendoni sikur vetëm ju jeni e sikur vetëm ju jetoni... Po ne pleqtë? Edhe ne kemi qenë dikur të rindja, ja, kështu siç jeni ju sot... të rindja... kemi jetuar si jetoni ju... Dhe u martuam, më të rindja, bile. Kur e mora Efigjenin, ajo kishte vetëm 17 vjeç. Dhe kaloi në këtë shtëpi, me mua, një jetë të tërë... Dhe s'e kaloi keq... si thua ti, moj çupa ime?»

— Kohët kanë ndryshuar — tha ajo nxituar.

Si dy shushunja që ngjiten kokë më kokë, vetullat e plakut lëvizën e u afruan njëra pranë tjetrës.

— Po, moj bijë, kohërat ndryshuan... Ato që ishin njëherë, nuk janë më... — tha duke folur për kohërat e dikurshme, sikur ato të ishin të gjalla, si njerëzit, si rrugët e ngushta e dyqanet e vogla... — Kanë vdekur — tha pastaj ngadalë.

Efigjeni e dinte: këtë shprehje Vangjeli e përdorte vetëm për prindërit e tij.

— Vangjeli... — i thirri ajo.

Në këtë kohë një stuhi shiu u përplas në xham

të dritares. Ujët e përzier me erë përnjëherësh filloj të rriddhët nga parvazet e të hynte brenda. Ai ishte shiu i parë i asaj vjeshte.

— Shiu... — tha tërë gëzim Drita.

— Shpejt, ujët po hyn nëpër shtëpi!

Nënë e bijë ato u ngritën. Usta Vangjeli mbeti i vetëm aty, te tryeza, duke dëgjuar breshërimën e shiut nëpër xhame. Pas asaj vere të gjatë, trokitja e tij e gëzuar e rrokëllima e piklave të çlodhët. Efigjeni hapte kanatet e dritareve të tkurrura nga të nxehtit e verës. Herë-herë ajo e nxirrte ftyrrën e saj të vogël e të mbushur jashtë. «Erdhi dhe vjeshta» thoshte dhe, sikur të ishte e vogël, ndjente pikat e mëdha të shiut t'i pëlcisnin nëpër faqe. Drita as që e kishte mbyllur dritaren e dhomës së vet. Pranë saj, ajo qëndronte në këmbë e shihte se si vezullonin në shi dritat e prozhektorëve të kantierit. Kalldrëmi i hollë e i gjatë shkëlqente, gjersa shkonte e humbiste në atë uturimë të thellë të lumit.

Të gjithë në shtëpi ishin të kënaqur, që biseden e tyre e kish prerë ai shi i dëshëruar vjeshte.

Ajo shihte endërr.

Me atë copë qelli në kokë, që i vinte nga dritarja e hapët, rrötullohej e përpinqej në shtrat. Dhe qante... E kishin veshur nuse me të bardha. Fustanin e nusërisë e kishin pajtuar për 1500 lekë. Tani, në dhomën e madhe, e mbuluar me vello të bardhë, nën portretin e Ilirit, ajo qëndronte në këmbë, nusëronte e qante. «Nus'a duhet të qa'ë», i pëshpëriti në vesh teto Nasta. «Kështu ëshë zakoni. Dhe është mirë... Kujto prindërit pleq, që do të lësh. E loti të vjen vetë në sy. Të rrjedh, si

shiu nga ullukët. Babën e nënën tënde lë, moj korbë. Dhe te një i huaj shkon...»

Iliri s'ishte njeri i huaj. Po ajo filloi të qajë në fillim ngadalë, e heshtur. Pastaj sesi i erdhi. Lotët e ngrohtë e të kripur i rrëshkisnin nëpër faqe dhe i zbrisnin te cepi i buzës. Ajo qante fort, me ngashërim. Supet i lëkundeshin...

Teto Dhoksia i erdhi pranë.

«Mos kështu» i tha. «Pse mërzitesh ti, të keqen?.. Ti ke fatin tim, atje ku do të vesh s'ke për të pasur vjehërr...»

«Këndoni» u thirri usta Vangjeli sazeve, që kishte sjellë për dasmën e saj. «Këndoni. Mezi e kam pritur këtë ditë.» Dhe lëvizte duart nëpër ajër.

Dhe defi gjëmoi, gërneta ulériu:

*Nuse moj, ku kalle këmbët,
atje më të rënçin dhëmbët...*

Kjo këngë e mbështolli atë, si një çarçaf i bardhë e i ftohtë mbështjellë një kufomë.

*Dhëmbët e dhëmballët,
kockat e kokallët...*

Defi gjëmonte. Gërneta ulérinte dhe usta Vangjeli ishte në qejf.

«Ashtu më rruashi» — u thërriste me zërin e saj të hollë teto Nasta sazexhinje... Kurse Drita shihte se s'i shkërmiqeshin në tokë, binin e përziheshin me baltën dhëmët e bardhë, dhëmballët...

Efigjeni uleriti. Mbuloi me duart e veta fytyrën e vogël e të kuqe e ja plasi të qarit. Në-

përmjet ahengut e thirrjeve, Drita dëgjonte vajin e së ëmës, gjerrës, rrënqethës, qante edhe vetë, me dënesë, me ngashërim...

«Qyqja! Na u mbyt çupa» i tha teto Dhoksi... «Largohuni ju» dhe i shtyri gratë, që ishin grumbulluar rrëth nuses... Ngriti vellon e, duke i bërë me dorë, i tha: «Jo kështu, moj budallaqeja e teto Dhoksisë... Pse kështu?...»

Po në këtë kohë fotografia e madhe, në anë të majtë, lëvizi. Kornizat kërcitën e u hapën me një zhurmë kërcënonjëse e prej andej të gjallë, të mëdhenj, filluan të zbresin poshtë gjysh Aleksi e gjyshe Aspasia. Kjo, sa shkeli mbi dysheme, përplasi pëllëmbët e, duke thirrur: «Mbesa më martohet» brodhi drejt Dritës... E rrëmbeu në krahet e hapur që tutje, e puthi në faqe, në sy, pastaj, duke u larguar pakëz, i tha: «Dale të të shohë gjyshja...» e duke kapur, me gishtin e saj, gishtin e mesëm të mbesës, filloi të rrotullojë atë rrëthvetës.

E bukur — tha Aspasia, «si unë... Të kam pjellë vetë» i tha ajo Dritës... «Kur u martova, ja, kështu si ti, me fustan të bardhë, nusërova edhe unë... Ata që më kanë parë...»

Në këtë kohë, kokën e së mbësës e mori në duart e veta gjysh Aleksi. Ngadalë ai e puthi atë në ballë... Ahere mbi dhomë ranë kokrra orizi të bardha, të vockla. Ato binin kudo, mbi qilim, karrigë, mbi flokë të njerëzve, mbi goditjen e deficit e grykën e gërnetës. Teto Nasta thërriste e me grushte hidhte përpjetë orizin, që vinte e përplasen mbi tavan e pastaj, si re e bardhë, përhapej poshtë kokrriza-kokrriza...

Ajo hapi sytë. Natë. Vetëm në qiel të hapët e të ftohtë digjeshin yjtë. Po asaj iu rëndua prapë koka. Sytë iu mbyllën. Dhe ajo ra prapë në atë gjumë të thellë e të shqetësuar... Dhe përsëri në ëndërr.

Tani ajo ishte në dhomën e Ilirit. Në po atë dhomën e vogël me dritharen në mes të murit karshi. Vetëm se tani çdo gjë ishte në vendin e vet. Dhoma e vogël shkëlgente nga pastërtia e rrëgulli. Iliri hëngri mëngjezin e do të nisej përpunë.

«Mos shkel në dysheme... Ja ku e ke qilimin».

Ai e pa atë e qeshi. Pastaj në majë të këmbëve, mori te dalë.

«Ç'do të bëj sot?»

«Ç'të duash... unë ha çdo gjë...»

«Të gatuaj tavë me patate... apo të bëj kunguj të mbushur?»

«Ç'të duash...» ai u përkul mbi të e përkëdheli e doli. Po kurj u kthye të mbyllë derën, ajo ishte e hekurt dhe e rëndë. Iliri kyçi bravën, futi çelësin në xhep dhe u nis për në shkollë.

Drita mbeti e vetme pas hekurave të rënda të derës së mbyllur. Ajo u ul në karrigë. E heshtur, hidhte shikimin rrëth e qark nëpër dhomë. Pastaj pa derën e hekurt. Pa kuptuar as vetë, duart i futi nën përparësen e bardhë, kur përnjëherësh ndjeu se po mblidhej e po transformohej e tëra. Në vend të fustanit vishnje, që kishte veshur, filloj të mbulohej në fustan të zi. Një shami e zezë i mbodhi flokët e përparësja e bardhë u kthye edhe ajo në të zezë. Nën atë përparëse mbante duart e saj të mbështetura mbi gjunjë. Ajo u tmerrua: ishte kthyer në Efigjeni. Dhe, ashtu e tmerruar, u zgjua. Jashtë ishte ditë.

XIII

Një nxënës i vogël para shkollës i tha: «Më-suesi ka shkuar në zbor». Drita u habit dhe u pezmatua shumë. Pse Iliri nuk e kishte lajmëruar? «Sigurisht që s'ka pasur kohë» mendoi. «Sido-qoftë, vetëm sa të vinte e të më thoshte...» Që kur, asaj nate, pa èndrrën, lloj-lloj mendime të zymta i vërtiteshin në kokë. Dasma gjithnjë qëndronte e gjallë dhe e pashlyeshme para syve të saj. Edhe pastaj e shihte gjyshe Aspasinë tek përplaste pëllëmbët në ballë.

Nënë Efigjenit nuk i tha asgjë. U nis e shkoi vetë te mëmë Maria, një plakë gjitone, e dëgjuar për shpjegimin e èndrrave. Tek ajo venin plakat e mëhallës e vajzat e mëdha e të pamartuara. Hyri në shtëpi të gjitones pa trokitur fare. Vetëm në mes të oborrit thirri një herë. Kurrkush s'iù përgjegj. Drita hapi derën e dhomës së vogël përdhese. Ulur në qoshe të vatrës, mëmë Maria rrotullonte në duar një filxhan kafeje. Plaka tundte kokën e murmuritte me vete, duke parë filxhanin. Në vatër ishte kutia e sheqerit dhe e kafesë dhe xhevzja e vogël.

— Mirë mëngjezi — e përshëndeti Drita që nga praku i derës.

Plaka përnjéherësh e mbuloi filxhanin me dorë dhe e futi nën përparëse.

- Ti qenke? — tha pastaj duke parë Dritën.
- Unë jam. Si jeni ju, nënë Maria?
- Shyqyr. Vangjeli si është?
- I sëmurë.
- Kështu jemi ne pleqtë... Ju të rinjtë ç'do prisni tjetër prej nesh.

— Ç'të bësh... — Drita u ul edhe ajo në shilte, rrëth qoshes së vatrës. Po mëmë Maria u çua. Mori kutinë e sheqerit e të kafesë, ngriti xhevzen e shkoi te rafti në mure të dhomës.

Ahere Drita i tha.

— Mëmë Maria... kam parë një ëndërr.

Plaka s'u përgjegj. Përpiquej t'i hapte vend kushtisë prej teneqeje në raft.

Gjatë rrugës Drita kishte menduar t'ja trengonte fije për pe gjithë ëndrrën, kurse tani i tha vetëm:

— Kam qarë gjithë natën...

— Në ëndërr? — pyeti plaka dhe u kthyen nga ajo.

— Në ëndërr...

— Loti është për të mirë — tha plaka dhe erdhi e u ul te vatra pranë Dritës. — Po ç'ëndërr pe? — e pyeti.

— Unë isha bërë nuse... — tha Drita.

Mjekra e gjatë dhe e thatë e mëmë Maries u drodh e, duke u zgjatur, u lëshua poshtë. Goja pa dhëmbë mbeti e hapët. Po, me sytë e vegjël e të mbledhur, vazhdoi të shihte Dritën.

Kur çupa tha, se «kam qarë shumë...» Mëmë Maria mendoi, se ajo do të kishte parë në ëndërr Vangjelin, të atin të vdekur. E do kish qarë, e gjora. «Çupë është e zemër të dhemshur ka. Fémijëve gjithnjë u dhimbsen pleqtë» mendoi. Plakës mendja i fluturoi te e bija e martuar në Fier. Ajo gjithnjë i dërgonte lajme: «Unë s'vij dot aty. S'kam ku të lë fémijët e burrin. Po ti mos rri më vetëm në atë shtëpi përdhese e gjithë lagështi. Ngreu dhe hajde këtu. Tani je plakë dhe mendo se kush do të të lidhë buzën». Kaq

herë Mëmë Maria darkave, duke folur e duke u ngrindur me vete, e kishte mbledhur mendjen top e ishte gatitur që të nesërmen të nisej për në Fier. Po të nesërmen, sa gdhinte dita, pendohej e kthente mendim. Si të merrete udhët e të shkonte midis njerëzve që s'i njihte... duke qenë mirë e bukur në shtëpinë e vet? «Rapi rrëzohet atje, ku ka hedhur rrënjet», thoshte... «Do gjendet dikush të më lidhë edhe mua buzën... Kurse fëmija është e dhimbur. Mendon për prindin plak. Edhe Drita do ketë parë èndërr, që ka vdekur Vangjeli. Dhe ka qarë... Gjithë natën ka qarë. Mirë ka bërë. Kurse për shpjegimin e èndrrës, kur ke parë vdekje, ahere ajo është larg...»

Po vajza tha:

— Unë isha bërë nuse...

Mjekra e gjatë dhe e thatë e mëmë Maries u drodh e, duke u zgjatur, u lëshua poshtë. «Kuckat» mendoi plaka e vrerosur, «prindët i kanë në buzë të varrit, kurse vetë gjithë natën qajnë përburrë...».

Plaka nuk u ndie. Drita fliste e ajo dëgjonte. Vajza tregonte se si nga korniza e fotografisë zbriti gjyshe Aspasia, si teto Nasta hidhte orizin mbi kokë të saj, si babai u thërriste sazexhinjve që të këndonin, kurse Efigjeni qante e ulërinte, dhe ajo, Drita, duke e dëgjuar të èmën, ngashërehej. Mëmë Maria mori me mashë një kongjill nga vatra e ndezi cigaren. Dhe dëgjonte Dritën e, duke e dëgjuar, i vërente fytyrën e zeshkët, të menduar, me sytë e mëdhenj, gjithnjë të hapët. Ata sy iu dukën të platitur, si kongjijtë e zjarrit në vatër. Por, po t'i trazoje me mashë ata kongjij, ndizeshin... Mëmë Maria e dinte këtë dhe ajo mendoi

me zili e cmir, se si ndizeshin sytë e asaj vajze të re, kur e trazonte ndonjë mashkull. Ajo i shihte Dritës shpatullat e gjera, gjitë e fryrë, belin. Dhe freskia e vajzës e tërboi. Plakën s'po e mbante dot vendi. Piste kur Drita të tregonte, si vajti dhëndrrri e mori dhe e çoi në shtëpinë e tij; ç'i tha dhe si e zhveshi; dhe ç'i kishte bërë. Ajo donte me doemos të dinte... kur Drita tha:

— Unë pashë e tmerruar që isha kthyer në nënën time.

— Vetëm kaq? — pyeti mëmë Maria.

— Kaq — tha Drita dhe shikoi plakën në sy. Ahere kjo u ngrit, i shkoi afër dhe përnjëherësh e zuri nga fustani, te shpatullat. Duke ja hequr me forcë, i zbuloi gjysmën e kurrizit.

— Kështu nuk të zhveshi ai? — pyeti ajo me zë të dredhur.

— Jo — tha Drita, duke e shikuar në sy e habitur.

Plaka e kapi në gji me dorën e djathtë e filloj t'ja shtrëngonte fort.

— Po kështu — i tha — as kështu nuk të zuri?

— Jo... — Dritës i dhembnin gjitë, po i duroi.

Ahere mëmë Maria qeshi mbi të. Të qeshurit e plakës ishte histerik e poshtëronjës. Po kur Drita po mbërthente fustanin, plaka përnjëherësh heshti. Kujtoi usta Vangjelin të egër e hakmarrës dhe tha ngadalë:

— Që të vdekurit janë ngjallur e kanë zbritur nga fotografia, nuk është mirë. Duhet të ruhesh...

Usta Vangjeli ra në shtrat. Sëmundja po e vinte poshtë. Gjithnjë e më tepër e ndjente zemrën të përpëlitez në kraharon, si një mullenjë e plagosur. Ashtu i përpëlitez, si mullenjë me krahë të thyer.

— Korba unë — i tha Dhokzia Efigjenit, duke e puthur te porta. — Si e kam Vangjelin?

— Ashtu është... Dhoksi — zemër...

— Dhe ato u ngjitën lart. Vangjeli ishte firuar e verdhur shumë, dukej që prej së largu se ishte rëndë, po Dhokzia, duke e përqafuar e duke e puthur, i tha:

— Oh, po ti qenke mirë... Kurse mua ma bënë...

— Ashtu e kanë njerëzit — tha Vangjeli ngadalë.

Ajo ishte e vetmja që i kishte mbetur nga gjaku i tij. Pas babait e nënës, në moshën 27 vjeç i kishte vdekur edhe i vëllai, nga malarja. Vetëm ajo, Dhokzia, kushërrira e tretë nga babai, kishte mbetur gjallë. Gjaku s'bëhet ujë... po, në rini, ata të dy nuk bëheshin shumë. Që kur Dhokzia shkoi e u martua me atë Nasin, Vangjeli u xhindos.

— Ty të duhet burrë, e jo brumë — i tha të kushërirës.

— Burrë po marr...

— Ai s'është burrë! Unë e njoh: ai është buf!

— Le të jetë — i tha ajo prerë.

— Po ti atë do — i thirri ahore ai të kushërirës. — Ti do që gjithë jetën ta heqësh prej hunde atë buf...

Qysh ahene ata u ftohën shumë. Megjithatë as ditën e emrit e as vitin e ri nuk rrinë pa ja festuar njëri-tjetrit. Dhe Efigjeni, kur ishte akoma e re e kur Vangjeli i kanosej, ose e qëllonte, nuk shkonte në derë të saj, po të teto Dhoksia. Dhe i shoqi aty vente ta merrte... Po këto janë të kaluara. Tani, ata, «kushërinj të një gjaku», ishin pleq, të pafuqishëm, që kishin bërë një rrugë të gjatë në jetë e s'u kish mbetur veç edhe pakëz... S'u kish mbetur asgjë: as dufet e as fuqitë e mëparshme, as ftohtësia e as dashuria e dikurshme. Trupat e tyre të pafuqishëm, sikur ishin zbruzur... Dhe atë copëz rrugë që u kish mbetur ata donin ta bënin së bashku. Prandaj ajo pyeste: «Korba unë, si e kam Vangjelin?» dhe «oh, po ti qenke mirë»... Kurse ai e dinte që s'ishte mirë. Dhoksia kështu e kish, ajo ishte «gjaku i tij».

- Drita nga është?
- Këtu nëpër mëhallë...
- Dhëndrrin si e kemi?
- Mirë, mirë është...
- Kemi dhëndërr të mirë — thotë teto Dhok-sia, duke shikuar Vangjelin e duke qeshur...
- Për veten e tyre — thotë Vangjeli.
- Jo, mos e thuaj atë — thotë Nasi. — Jo vëtëm për veten e tyre, po edhe për ne...
- Nga Pirrua kemi ndonjë lajm?
- Vangjeli hesht, Thyhet xhami e jo të mos thyhet, pastaj, zemra.
- Ti, Vangjel, je i lig — i thotë Dhoksia. — Kështu ke qenë e kështu mbete. E vure përpara djalin e s'pranon as të të flasim për të. Të të vijë keq të paktën për Efigjenin.

I mbështetur në jastëkët e bardhë të krevatit,

Vangjeli dëgjon symbyllur... Dikur Dhoksia s'do të kishte guxuar t'i fliste kështu. Po tani ai nuk i zemërohej të kushërirës. Vetëm ata të dy kishin mbetur. Kurse djali le të bënte ç'të donte... për Vangjelin ishte një lloj.

— Të fejuarit nuk do të martohen?

— Kur të duan...

Dhoksia do që të gëzojë edhe Vangjeli.

— Sa më shpejt — thotë ajo, — s'kemi ç'të presim. Edhe kohën e kanë. Por për pajën si ja bëtë?

— Ne gati jemi...

— Dhëndrrri s'ka thënë gjë.

— Vetëm dikush na tha, se e paskemi pajën të vjetër... — tha Efigjeni.

— Po punë e madhe! Drita le t'i kthejë fus-tanet e t'i bëjë sipas modës. Kurse të bakërtat s'kanë mort.

— Kam frikë se mos nuk pranon dhëndrrri.

— Efigjeni foli ngadalë, gjithë frikë, thua sikur fjalët e saj do të vrissnin Vangjelin.

Dhe me të vërtetë i sëmuri hidhet përpjetë. Me sy të çakërdisur éshtë gati ta përpjë të shqen.

— Çfarë nuk pranon dhëndrrri?! — thërret.

— Pajën.

— Pse të mos e pranojë?

— Të rintjtë nuk pranojnë. Kështu thonë...

— Oh, po ti je tutkune! Zaten kështu ka qenë gjithnjë.

— Vangjel, — Dhoksia ulet mbi të dhe e mbulon — mos u shqetëso. Ti je i sëmurë...

— Ajo më sëmuri. Ajo më sëmuri çdo ditë e më shumë...

— Nuk bën kështu — thotë Nasi.

Po Vangjeli sa dëgjon:

— Çdo orë vjen e më thotë «pajën e kemi të vjetër, pajën e kemi të vjetër». Se nga vete e bisodon me disa lloçka nëpër mëhallë... Po mirë, ja dhe e kemi pajën të vjetër. Po unë aty kam 200.000 lekë plaqë. Pastaj, kur the ti, vjetërohet bakri?

— Jo — thotë Dhoksia, — po ti mos kështu.

— Vjetërohet leshi, moj? Pastaj ja, dhe në qenka e vjetër.... Edhe ne të vjetër jemi. Po nuk kemi turp nga vetja jonë.

— Ashtu është — thotë Efigjeni, më tepër për të zbutur të shoqin. Po ai nuk zbutet.

— Dhe tani vjen e më thotë që dhëndrrri s'dashka pajë. Po pse? Sepse të rinjtë nuk duan pajë... Jo, moj! Që qenka e vjetër, hajde... e pranoj.

Usta Vangjeli fliste rrëmbyeshëm dhe i merrej goja; fliste me duar e me këmbë.

— Nuk e pranojnë pajën të rinjtë... — thoshte, duke e rrrotulluar fytyrën herë nga Dhoksia herë nga Efigjeni... — Tatkunë! Ka njeri që s'pranon t'i japësh diçka? Dhe t'ja japësh pa lekë e për fare... Qenka e vjetër. Po edhe unë edhe ti të vjetër jemi. E nga kjo do të kemi turp? Ata janë të rinj dhe u duket sikur kështu do të janë gjithnjë. Edhe mua kështu më është dukur. Po ja që u plaka. Eh, sa shpejt plaket njeriu...

— Plaket... — tha Nasi.

— E sheh? Edhe Nasi e di: njeriu plaket shpejt. Dhe, nga i ri, bëhet i vjetër. Këtë unë e kuptoj. Jemi plakur. E kuptoj. Shoh rrugët e qytetit, kanë ndryshuar; shoh njerëzit, ndryshuan; shoh fëmijët e mi e më duket sikur s'i njoh...

Zëri i tij u bë i butë e i shtruar. Të gjithë sa ishin filluan të bisedojnë ngadalë për ndryshimet që kishin ndodhur e që ata të katër pleq i kuptonin e s'i kuptonin, i pranonin e s'i pranonin...

Teto Dhoksia e xha Nasi flisnin me të sëmurin ngadalë, qetë dhe i shpjegonin se rinia e ka mirë. Ata vetë s'kishin fëmijë, po ata e shihnin rininë ngado.

— Mirë bën rinia që shkon në shkollë; që dashurohet e s'rri brenda mureve të shtëpive të vjetra; që punon... Ti e di, puna është gëzim — thoshte xha Nasi.

— Ti e di vetë — thoshte Dhoksia. — Ti vetë gjithnjë jetën tënde ke punuar. Me ato dy duar e ke mbajtur me nder shtëpinë tënde.

Usta Vangjeli i dëgjonte. E thellë në veten e tij i vinte mirë. Me të vërtetë «me ato dy duar ai e ka mbajtur me nder shtëpinë, gjithë jetën». Po kur biseda erdhi sërish te paja, plaku shpërtheu.

— Poqë s'pranokan pajën, — jo, këtë s'e ha! Gjer këtu... Pse s'e pranokan? Sepse qënkan të rinj... oho! Pyet leku për të rinj... Pyet interesni. — Ai lëvizte nëpër ajér duart. Herë-herë i mbushej goja me pështymë. Po Vangjeli fliste e fliste e nuk donte të ndërpritej nga njeri.

— Mjaft — i thoshte Dhoksisë. — Qenkan të rinj e s'e dashkan pajën! Mbushua shtëpin e ke për të parë se si do të thonë «të falemi nderit». Këtu s'ka ndryshime, grua... Këtu unë s'pranoj asnje ndryshim — gërzhitit usta Vangjeli, por në çast iu ndal firoma dhe u këput me kokë të përkulur mbi shtrat.

Dhoksia turfulloi më këmbë.

— Korba! — klithi.

Efigjeni rrëmbeu shpejt një hap e ja vuri të sëmurit në gojë. Të dy plakat e mbanin atë në kraharon dhe e ndihmonin të merrte frymë.

— S'bën kështu, Vangjel, s'bën kështu, xhan,
— i pëshpëriste te koka teto Dhoksia.

XV

Vjehrri e kishte pyetur: «kur do ta bëjmë dasmën?», dhëndrri ishte përgjegjur «kur të do ni... unë dhomën e kam». Kur ja kishin hedhur fjalën pér pajë, ai s'kishte thënë asgjë. Vetëm ngadalë kishte lëvizur dorën në ajër. Tani Iliri ishte bërë njeri i shtëpisë. Hynte e dilte kur të donte. Qëndronte pér drekë e pér darkë.

— Shok... tamam shok. Të ma thoshin më parë se dhëndrri u dashka kështu, kurrë s'do të besoja — thoshte usta Vangjeli.

Atë natë ai e ndjeu veten më mirë. Frymë-marrjen e kishte më të lehtë e botën përreth e shihte më i gjuar. — «Sa të martoj... Dritën» mendoi duke lëshuar poshtë kapakët e mëdhenj të syve. «Sa të martoj Dritën... pa pastaj...» Pastaj mendimi rrođhi vetë: «Eh, dhe një nip e dua...» tha me vete.

— Unë po shkoj... — Iliri zuri të ngrihej nga tryeza.

— Ti s'ke ku vete... — plaku zgjati dorën e vet e kapi atë të dhëndrrit. Sonte do të rrish këtu. Drita, na sill rakinë — i tha së bijës.

Efigjeni e shikoi në sy të shoqin. Ajo gati sa s'po qante.

— Vangjel..

— Nuk pi, jo... sa ta mbaj përpara.

— E di unë...

— Mjaft, tani, de...

Plaka heshti. Drita solli rakinë e shtroi në tryezë ullinj e djathë. Pastaj edhe ajo shkoi e ul në nim, pranë së ëmës.

— Të trashëgoheni! — Vangjeli ngriti gotën e rakisë.

— Të shkuara, baba. U shërofsh sa më shpejt.

Burrat filluan të pinë.

«Një nip e dua...» mendonte Vangjeli. Dhe me mendtë e tij ai shikonte se si mbante në duar foshnjën e vogël, të butë, që dalëngadalë fillonte të fliste, të ecte. Vangjeli e shihte se si rritej foshnja nëpër këmbë të tij dhe e ndjente veten trung të ngulur në tokë, në rrënje të shumta. Çdo rrënje, thellë nën dhe, lëshonte rrënje të tjera të reja. Edhe Vangjeli lëshonte rrënjet e veta, nëpër shtresat e jetës.

— Si shkove sot me punë? — e pyeti ai Ilirin, kur pa që po heshtte.

— Mirë.

— U lodhe?

— Pak...

— E po... fëmijë janë... s'është lehtë të merresh me ta...

Dhe Vangjelit i shkoi prapë mendja te fëmijët, lisat e rrënjet e tyre. Ai e dinte se edhe lisat e mëdhenj e të vjetër, sado rrënje të shumta e të thella të kenë nën tokë, vjen një ditë e rrokullisen. Veç ai e dinte se, po në atë vend, ku bie trungu i parë e po nga ato rrënje, shpërthejnë të tjerë, të rinj. Ata janë vazhdimësia e të parit.

Edhe nipi i ardhshëm do të ngrihej, në vendin ku do të binte Vangjeli. Atij i shkoi mendja te Pirrua, po në çast e hodhi atë mejtim tutje, sikur të kishte zënë me dorë një hekur të nxehjtë.

Iliri bisedonte me Dritën.

— Psikologjinë? — pyeti.

— Po — tha ajo. — Na shkruan se është duke pregetitur psikologjinë.

— Ajo është lëndë e bukur, po unë s'e kam pasur qejf. S'i duroja dot përcaktimet — tha ai duke qeshur.

— E marr me mend, se sa qejf e ka Pirrua — tha Vangjeli, duke ndërprerë bisedën e tyre.

Ata heshtën.

— E marr me mend — tha Vangjeli, se si bresh ai nëpër Tiranë...

Iliri dhe Drita shikuan njëri-tjetrin në sy. Vangjeli e pikasi shikimin e tyre dhe e kuptoi që të rintjtë nuk donin ta zgjatnin atë bisedë. Aty ishte edhe Efigjeni. Ahere Vangjeli shkoi nga e shoqja. Fytyra e plakës ishte mbledhur kulaç dhe ishte bërë më e bardhë se sa qe.

«Po ajo fytyrë» mendoi usta Vangjeli me vete. Dhe iu kujtua dita e parë e martesës. Dhe ktheu përnjëherësh gotën e rakisë.

— Vangjel...

— E di — i tha ai Efigjenit. — E di se ç'do të më thuash. Nuk pi shumë. Qejf kam. Po dhe frikë kam. Kur isha i ri — iu kthyte ai Ilirit, — e pija «ujin e tërbuar». Më ndizte gjakun. Kursetani, sa ndjej zemrën të llokoçitet në kraharor, e kuptoj se gjithshka ka mbaruar përmua... Po e di ç'po mendoja? — Ai u kthyte prapë nga Efigjeni. — M'u kujtua dita e parë e martesës sonë —

tha duke shikuar gruan drejt ne sy. — Në derë tonë dy javë përpara kishte filluar dasma. Baba kishte thirrur çengitë. Kënga e ahengu fillonte në aksham e mbaronte më të gdhirë, kur njerëzit do të niseshin për punë. Unë isha djalë i vetem.

Për herë të parë Iliri e shihte të vjehrrin aq gojtar. Ngadalë, duke i lëshuar fjalët, si rruaza tespihesh, po prapë usta Vangjeli fliste... e fliste... Iliri, duke e dëgjuar atë, pinte raki. Dhe gjithnjë e më shumë kishte qejf të pinte. Plaku i sëmurë nuk e ndiqte dot. Ai ngrinte gotën, e çokte me të dhëndrrin e vet e shpeshherë e linte në vend, pa e vënë në buzë.

— Shtatë vjet të tërë ndenja i fejuar me Efigjenin — thoshte Vangjeli. — Kurrë s'e pashë n'ë herë. Shkoja në shtëpinë e vjehrrit të dielave, ditët e emrave, të pashkëve... I hapja sytë ka'ér mos e shihja gjékundi... ishte e pamundur. Pyesja djemtë e lagjes: «Si éshtë?» «Chu» më thoshin ata «e madhe, me fytyrë të bardhë e të kuqe». Shkallova nga gëzimi.

Iliri qeshi. Plaku trokiti gotat, po gotën prapë e la në vendin e saj, pa e pirë.

— Darkën e dasmës, çdo mik i shtëpisë sillte edhe nga një dash. Ashtu e kishim: të ftuarit sillnin me vete kuleç të mëdhenj, verë e mish... Në oborr u bë një kope e tërë më desh. Blegërinin bagëtia përmes ahengut e valles. Tym e mish i pjekur dynjaja. Dhe «ujë i tèrbuar» — tha ngadalë, duke u përkulur nga Iliri.

— C'na i kujton këto? — tha Efigjeni e quditur.

— Pse, ty s'të kujtohet?

— Jo — tha plaka.

— Nuk tē kujtohet se si, kur kalove prakun aty poshtë, — e usta Vangjeli tregoi me gisht, pértej dritäres së kuzhinës, prakun e oborrit pérjashta... — Kur kalove atë prak, këmba jote shkeli në mbllacën e gjakut tē trashë tē dashit tē therur pér ty. Dhe kur ti vure këmbën mbi to, teto Lena klithi prej gëzimit: «Këmbën nusja e paska tē mbarë» — thirri. — Nuk tē kujtohet?

— Jo, s'më kujtohet gjë...

Me fytyrën e saj tē brumtë plaka shikonte tē shoqin në sy. E çuditej me ato që thoshte ai. Asaj s'i kujtohej asgjë. Vangjeli sikur fliste pér njerëz tē një jetë tjetër. Efigjenit i kujtohej vetëm vjehrra. Ajo s'kish qenë e keqe. Po nusja nuk kuptonte pse e kishte pasur shumë frikë. Vjehrra kish qenë e gjatë dhe e thatë. E heshtur. Pa shumë fjalë. Efigjenin e kish dashur dhe në fillim tē gjitha punët i bënte vetë, «që tē mësojë nusja» thoshte... «Të dijë si ta mbajë shtëpinë...»

Këto që thoshte Vangjeli gruaja s'i mbante mend. Fejesa, dasma... Ato ishin aq shumë tē largëta! Kurse usta Vangjelit i kujtoheshin tē gjitha. Atij i kujtohej, se kur tē martën mbrëma (sepse vetëm tē martën dhëndrrri mund tē shihte e tē flinte me nusen), hyri në dhomë, ajo qëndronte më këmbë kokulur, ashtu siç e kishin lënë. E palëvizur. Vangjeli e pa atë pér tē parën herë. Efigjeni ishte e shkurtër. Me një fytyrë tē mbushur, tē brumtë. «Si tanë», mendoi ai me vete.

Në këtë kohë Iliri ngriti gotën e rakisë dhe e pérpoqi me vjehrrin. Të dy ata i vunë gotat në gojë.

Drita, duke parë tē dy burrat që pinin e bisedonin midis tyre, mendonte, e trishtuar, se si e

ëma nuk mbante gjë mend, as nga fejesa, as nga martesa e saj. Vetë ajo, Drita, kurrë s'do ta harronte atë ditë, kur pa për herë të parë Ilirin. Ajo kapi e rrotulloi në gisht unazën. Kujtimi i asaj dite ishte lidhur me atë unazë. Duke e rrotulluar në gishtin e vet, kokulur, vajza mendonte për të ëmën. Ajo ishte plakë. Po babai ishte më plak. E prapë mbante mend e kuptonte gjithshka. Kurse nëna... Ajo deshi të shikonte nga Efigjeni, po s'guxoi. Pati frikë mos ai shikim zbulonte mendimet e saj.

Vangjeli e preu bisedën. Ishte lodhur së foluri. Pastaj koha kishte kaluar e qe bërë vonë. Kurse Iliri pinte e hante meze. Plaku, që vetë ishte i sëmurë, kur shihte dhëndrrin të ri, të fuqishëm, ndjente një kënaqësi të brendshme, që e nxitte t'ja mbushte pa ndërprerje gotën e rakisë. Dhe kënaqej edhe vetë... Kurse i dhëndrrri, çakërqejf, i skuqur në fytyrë, fliste e queshte me zë të lartë.

Ahere Drita e pyeti:

— Ç'të thanë për mua... kur do shkoj në punë?

Vangjeli shtrëngoi gotën e rakisë në dorë dhe i hodhi së bijës një shikim të akullt. Po heshti. S'tha gjë. Iliri bënte sikur zinte me pirun një kokërr ulliri, të madhe, të zezë. Kokrra rrökullisej nëpër faqe të lëmuar të pjatës e ai e ndiqte pas. Ndjente mbi vete shikimin e Dritës e s'donte të ngrinte kryet. Veç thellë në të zemërimi zgjohej. Drita me këtë «çështjen e saj të punës» po e ngacmonte, ashtu si ajo fëmija që, me kallam në dorë, zemëron qenin e egër. Po ai s'donte të shpërthente atë kohë atje. Kokulur, përpiquej ta zotëronte veten.

— Ti akoma me këtë avaz? — I tha Vangjeli prerë së bijës.

— Unë dua të punoj. Desha të studjoja. Ti nuk më le. Tani dua të punoj.

Për herë të parë ajo ngriti kokën e shikoi të atin drejt në sy. Ky u drodh. Ata s'ishin sytë e urtë, gjithnjë të menduar të së bijës. Një zjarr i turbullt flakéronte në të. Ata ishin sytë e një njeriu të egërsuar. Vangjelit iu kujtua Pirrua. Po ky ishte fëmijë, çunak. Vetëm ngërdheshej me ato që i thoshte i ati, ndërsa përbrenda qëndron-te ai që ishte, i lehtë, i butë. Kurse Drita...

— Çupë e babait, — filloi ai...

E bija s'e la të vazhdonte:

— Unë dua...

Asaj i dridhej buza e poshtme kur fliste.

— Unë desha të studjoja — tha ajo. — Ti s'më le. Tani unë s'mund të jetoj më këshitu, dua të punoj.

Sharra pret hekurin, ndërsa ato fjalë e pre-në plakun për gjysmë. Dhëmbja ishte shumë madhe. Dhe ai s'u ngrit më. As guxoi të thoshibë ndonjë fjalë. Ishte i plakur, i lodhur, i sëmëmishte në buzë të varrit, s'kishte më forca t'ar të ftonte. Ajo që po i fliste nuk ishte Drita, net nga po një njeri tjetër, i egërsuar dhe i huaj. Ajo. Dhe njeri ai nuk e njihte. Nuk po kuptonte së nga të te me këtë njeri atë që, tanimë ishtë i pakallur». Usta Vangjeli heshti, »dhe i plakur, të tjerëve. Për një çast iu kujtuë të varrit» siç xhokaxhinjve, buldozeri, kombinuabai i fëmijëve, ta... e deshi të thërriste me sa çdo lëvizje e do-prej meje, xhanëm?!» — Po që rigjenin. Kështu kish mëdha, ishte një hapësirë e ishte, gjersa të ishin

mbi të, e shtypte e i merrte frymën. Dhe ai uli kokën, heshti i dorëzuar.

— Do që të punosh patjetër në kombinat? — Iliri vetëm këtë herë foli.

— Kudo që të ketë punë — tha Drita. — M'u mérzit kjo jetë. Kurse bota qenka e madhe...

— Punë ka vetëm në kombinat — tha ai.

— Mirë, ahore, në kombinat.

— Punëtore e thjeshtë... Nëpunëse është diçka tjetër. Pastaj unë mund ta ushqej vetë gruan time — tha dhe, si shtyti me trup karrigën pas, kapërciu në anën tjetër të fronit krahun e vet.

Përnjëherësh ajo ndjeu kraharorin t'i shty-
pej e mbi të ecte ai ariu i madh, që i merrte fry-
mën. Iliri nuk ishte më ai i vogli, i pafuqishmi,
që, i shtrirë në shtratin e vet, i përgjumur, i
thoshte asaj: «gruaja ime...» Dhe, dhe prapë i
përgjumur, lëshonte kokën mbi jastëk e flinte.
Tani përpara saj qëndronte Iliri tjetër, burri i
fuqishëm, i dashur, i pakuptueshëm, i huaj.

— Unë e kam për detyrë të të ushqej — tha ai.

— Gruaja jote është njeri — tha ajo. Zëri
i saj ishte i ulët, pajtonjës. Ajo fliste duke mbaj-
për gisht. — Gruaja jote është njeri — tha —
dhe duhet të ushqehet me punën e vet.

Askush nuk u përgjegj. Heshtje. Dhe në atë
heshtje kokulur, siç ishte, Drita po mendonte mbi
ato që tha. Ajo e kuptoi se gjithshka e rrëthonte
gjer ahore: shkolla, shoqet, kombinati, dhe këta
mure të shtëpisë së usta Vangjelit, të gjitha e
çonin drejt këtij mendimi: Ajo është një njeri
dhe duhet të jetojë me punën e vet.

Iliri u ngrit me rrëmbim.

— U bë vonë — i tha ai usta Vangjelit — falemnderit. Natën e mirë. Unë — i tha pastaj Dritës — nuk martohem me një punëtore kombinat... Këtë ta dish...

Zëri i tij dridhej prej zemërimit. Papritur ta përcjellin, zbriti shkallët e humbi në errësirë.

— Ah, Dritë, ah, të keqen nëna. Ju jeni të rinj e mbase i rregulloni punët vetë...

Efigjeni e vogël, e shkurtër, qëndronte te dera e kuzhinës përpara së bijës, e shikonte me sy përgjonjës, sikur i lutej.

— Ju jeni të rinj — i tha ajo prapë... — mbase merreni vesh...

Kaq vjet ato kishin kaluar bashkë e vajza e kuptonte të ëmën jo nga ajo fytyra e palëvizur, nga ato rrudha, që, si rrjetë e ngatërruar, i plekseshin e i shtriheshin në ballë, por nga ai tingulli i dridhshëm, i brendshëm, i zërit të saj, që papandehur këpuntej nga dhëmbja.

«Ah, të keqen nëna...» Vajza u përkul mbi Efigjenin dhe ndjeu se zemra e saj qullej, bymehej, nga frika e dhëmbja që kishte pushtuar të ëmën, ashtu si një kore buke e thatë bymehet nga uji. «Mbase e rregulloni...» pëshpériste ajo. Dhe Drita e kuptonte: Efigjeni kishte frikë nga të gjithë.

Kishte frikë nga babai, sepse, edhe i plakur, edhe i sëmurë, edhe ashtu në «buzë të varrit» siç ishte, prapë ishte burri i saj, babai i fëmijëve, zoti i shtëpisë. Çdo fjalë e tij, çdo lëvizje e dorës së tij, ishte urdhër për Efigjenin. Kështu kish qenë gjithnjë e kështu do të ishte, gjersa të ishin

gjallë. Ajo kish frikë nga Iliri, sepse, po të donte, mund t'ja përplaste çupën e turpin te praku i derës. E t'ja mbathte. Ç'do t'i bënte djalit të botës?! Pastaj sonte, kur ai pinte raki e bisedonte herë me Vangjelin e herë me Dritën, Efigjeni pa se si iu frysë e i kërcyen damarët e qafës nga zemërimi dhe iu kujtua i shoqi kur ishte i ri. Iliri për sytë e plakës i shembellente aq tepër Vangjelit, sa ajo s'u besoi syve të vet. Po nëna kishte frikë edhe nga e bija. Vajza kishte të drejtë që kërkonte të punonte. Pse të ndahej nga shoqet? Pastaj, ajo, Efigjeni, dhe ajo Drita e dinin se si mund të mbahej shtëpia vetëm me pensionin e Vangjelit. Kurse të gjithë punonin, edhe në mëhallën e tyre. E s'bënn keq. Nëna ja kishte thënë njëherë edhe usta Vangjelit, po ky ja kishte prerë:

— S'janë punë për ty këto!

Dhe ajo kishte heshtur. As dhëndrrri s'donte që Drita të punonte. Sado që thoshte ashtu-kështu, Efigjeni e kuptonte se ai s'donte që gruaja e tij të punonte si punëtore e thjeshtë. Mësuesi e donte gruan të madhe. Fati i keq i vajzës që ta kalonte gjithë jetën brenda mureve të shtëpisë, si ajo, Efigjeni. Po q't'i bësh! Gruaja është grua. Kurse ajo Drita... perëndia e dintë se ç'mund të bënte. Efigjeni kishte frikë prej saj.

Efigjeni shtrëngonte derën e kuzhinës e shikonte Dritën në sy. Kjo mendoi t'i thoshte së ëmës: «S'e mban mend fejesën tënde?» Dhe e dintë që nëna do t'i përgjigjej: «S'e mbaj... ohu, sa kohë kanë shkuar!» «As martesën?» «As martesën... po mos ma vëré veshin. Unë jam shushatur, moj bijë... Po ju mbase e rregulloni vetë...»

Nëna kështu do t'i përgjigjej. Prandaj ajo nuk i tha asnje fjalë.

Shtrëngoi me dorë tëmthat, që i rrighnin pa pushim. Një djersë e ftohtë i kishte mbuluar ballin. Shkoi te tryeza e vogël në mes të dhomës, hapi kutinë e mori një aspirinë. Kur ngriti sytë, pa kuadrin e Llogorasë. I vogël, brenda një kor-nize të lehtë druri, peizazhi qëndronte para saj. Ajo iu afrua ngadalë. Një përzierje e papritur e maleve me qiellin. Dhe sa më tepër ata i afro-heshin njëri-tjetrit, aq më të kaltëra bëheshin malet e aq më i gjelbër qielli. Përposh, në blunë e tij të thellë, i gjallë, i gëzueshëmi buçiste deti. Vetvetiu shikimi i Dritës i shkonte te rripi i holllë, i lehtë, ku bëhej ajo përzierje e ajo shkrirje e pashpjegueshme e dritave të maleve e të qie-llit. Ajo nuk e kuptonte pse, po shikimi i saj gjithnjë atje shkonte e, duke soditur ato maja të gjelbëra që futeshin nëpër hapësirë qiellore, gjithnjë ndjente se në kraharorin e saj frynte vetë gë-zimi i freskët, i kaltër i kuadrit të vogël. Kështu i ndodhët përherë. Kurse tanë, ajo qëndronte para peizazhit e ftohtë dhe indiferente. Male, qiell e det. E asgjë tjetër. Përkundrazi, përhedhja e pan-dalshme e maleve drejt qiellit atë sikur po e ndan-te nga bota dhe e shtypte nën peshë të vet.

U largua prej kuadrit të varur në mur. Shkoi e qëndroi në këmbë pranë shtratit të saj. Nga dritarja nuk pa asgjë. Vetëm natë. Errësirë. Asnjë yll në qiell. U shtri në shtrat. Ashtu, e veshur dhe e mbathur, siç ishte. Mbylli sytë. Donte të pushonte. Megjithëse po shkonte mesi i natës, gjumi i ishte larguar prej syve. Koka i gjëmonte e tëmthat

i rrighnin. Aspirina nuk po e lehtësonte. Ajo i mbante sytë të myllur. Nuk donte të shihte as gjë; nuk donte të kujtonte as mbrëmjen, as rakinë, as babanë e as Ilirin. Asgjë. Vetëm të ishte larg. Të fluturonte diku. E hodhi mendjen në jetën shkollore, kujtoi shokët e shoqet, kujtoi provimet. Brodhi sa andej-këndej nëpër rrugë e kadora të qytetit. E la mendimin e saj të shtegtojë me patat e egëra nëpër grykat e lumi. Po gjithshka sa shfaqej edhe zhdukej në mendjen e saj. Të gjitha fluturonin e digjeshin në tru si figurat e një filmi të vjetër, të përdorur e stërpërdorur. Dhe midis tyre vetëm një mendim qëndronte i përhershëm dhe i paluajtshëm. Ajo përpinqej t'i langohej, t'i ikte; nuk dëshëronte ta shihte, ta prekte. Po ai qëndronte aty, si një shkëmb i madh, i vrenjtur në mes të dallgëve të mendimeve të saj. Ajo i hapi sytë.

Iliri ishte aty, në kuadrin e varur në mur përballë. Vetëm se tisi i hollë, gri, që e mbulonte gjithnjë dhe e bënte të pakapshëm e të papërcaktuar, ishte zhdukur. Për herë të parë nëpërmjet atij sfondi të kuq e të verdhë, ajo pa Ilirin e vërtetë, të gjallë. Me sy të zez, depërtues, me hundë të derdhur të vogël, ai e shikonte Dritën nga kuadri. Dhe ajo u çudit. Kurrë s'e kishte vënë re, që midis atyre shpatullave të gjera, muskuloze të Ilirit, koka e tij qenkej aq e vogël dhe elegante. Tani ajo po e pikaste këtë. Dhe sa më shumë e shikonte, aq më tepër në veten e saj ngrihej ajo ndjenjë e turbullt, e dhimbshme që e kishte pushtuar, kur e kish parë për herë të parë këtë njeri. Ajo e dashuronte shumë. Dhe kur shikimet e tyre ishin kryqëzuar për herë të parë, ajo ishte

dredhur e tëra. Ishte trembur nga dashuria e saj. Tani, duke parë atë kokë, e kuptonte që s'mund të ndahej kurrë prej tij. Sido që të bënte. Ngado që të shkonte. Vetëm dashurinë e saj s'mund ta braktiste dot.

Drita u kthyte në brinjë, mbështeti kokën mbi krahun e djathëtë e myllitë sytë. Dhëmbja e kokës i qëndronte e përhershme. Tëmthat i rrithnin gjithnjë. Nëpër shtat ndjente zjarmi. Sigurisht që kishte temperaturë. Donte të flinte. Qerpikët po i rëndo-heshin. Ishte e lodhur dhe e këputur. Ajo ditë kishte qenë plot e përplot për të. Donte të flinte...

«Paguaj unë!»

Ai ishte një zë i lartë femre. Vajza, e mbështetur te banaku i bufesë së kombinatit, kishte një fytyrë të zezë, të rrumbullakët, një hundë pince e mjekër disi të kthyer përpara. Në mes të mjekrës, një gropë.

«Jo, paguaj unë!»

Ky ishte një zë i rëndë mashkulli. Ai kishte kthyer kurrizin dhe Drita nuk e dallonte dot kush ishte.

«Pse? paratë e mia nuk shkojnë?!»

«Paguaj unë» tha burri prerë.

Ahere punëtorja përplasi pëllëmbën e vet mbi banak.

«Kështu si them unë» tha ajo. «Jepu!» e urdhëroi banakierën duke e shikuar mashkullin me inat.

Punëtoret e tjera e banakierja qeshën.

Drita u shkund. E mbështetur, siç qe, ja nguli sytë murit të afërm. «Paguaj unë!» i gjëmonte në vesh zëri i punëtores. Pastaj iu kujtua Iliri mbi karrigë, që thoshte: «gruan time e ushqej vetë me

bukë!» «Pse, nuk shkokan paratë e mia?» gërtiste punëtorja me mjekrën të përthyer përpara «Gruan time e ushqej vetë» gjëmonte Iliri.

Drita i kishte ngulur sytë murit të afërm. Shikonte kokrrizat e poret e tij të vogla, të vogla. E dinte që përmbi të qëndronte Iliri. Ky e urdhëronte të kthehej, të mos shikonte indiferente andej nga muri, po me sytë gjithë dashuri të shihte të fejuarin e saj. Ajo s'luante. Shihte murin, poret. Dhe duke parë ato vrimëza, mendonte babanë, zemrën e tij të sëmurë, pajën, për fejesën, mendonte dashurinë e saj dhe vizitën e parë në dhomën e Ilirit, urimet që i bënin njerëzit, muret e rënda të oborrit. Në veshët e saj gjëmonte zëri i babait: «Të linda, të rrita e të gjeta burrë». Kurse Iliri thërriste, «gruan time e ushqej vetë me bukë». Ajo kishte ethe. Duke e ngulur shikimin në mure, ndjente se si truri i punonte sikur të ishte turjelë e mprehtë. Dhe brente mendime e ashkla mendimesh. Duke brejtur ashtu, ajo po kuptonte se si njeriu lidhet çdo ditë, çdo çast, me mijëra e mijëra fije të vogla, të padukshme, e, pa kuptuar as ai vetë, kthehet në skllav të tjetrit. Ajo mbuloi me dorë fytyrën dhe qau.

Jashtë kishte shpërthyer furtuna. Era ulërinte nëpër atë natë të errët dhjetori. Po brenda në dhomë dëgjohej vetëm ngashërimi i thellë, i rëndë, i Dritës.

XVI

Para derës së shefit ishte mbledhur një turmë e tërë njerëzish, që prisnin takim. Dikush hynte e

dilte shpejt e shpejt. Shefi, më këmbë, i përgjigjej aty për aty, i rrihte shpatullat me shuplakë e hapte derën.

— Tjetri!

Po ai që hynte, pasi përshëndetej, ulej vetë në karrigë. Ahere shefi nuk mund të qëndronte e të dëgjonte qytetarin nga kurrizi, prandaj ulej edhe ai në karrigen e vet. E biseda kësaj radhe vazhdonte e gjatë, e shtruar, sa atyre, që prisnin aty përjashta, u dukej pa mbarim.

— Sa shumë i mban! — tha një mësuese e re, që kishte mbështetur gjoksin pranë parvazit të derës.

— Burokrat! Ai është një burokrat, që s'e ka shokun, — iu përgjegj një mësues i gjatë, i hollë, me një zë të metaltë. Kurrë nuk të mbaron një punë...

Iliri ishte mërzitur. Po lodhej e ndjente tabanet e këmbëve të djersitura t'i dhëmbnin. Filloi të nervozohej dhe herëherë murmuriste e shante me vete. Dhe lëvizte sa lart poshtë nëpër sallon. Ai kish ardhur disa herë këtu. Kish pritur. Kish hyrë brenda e kish biseduar me shefin dhe gjithnjë e njëjtë përgjegje:

— Punë? Sa të doni... ja ku është kombinati...

Kështu u ishte përgjegjur ai edhe atyre të tjerëve, që Iliri i kishte futur për t'i gjetur Dritës një punë diku në arësim.

Dera u hap.

— Tjetri — thirri shefi që brenda.

Dhe dikush hyri. Iliri nuk kishte shpresë se do të rregullonte gjë. Ky shef ishte aq burokrat, sa ai nuk do të dëshëronte kurrë të kishte të bënte me të. Po ç'ti bësh?! «Kur të zë gjarpëri», thosh-

nin pleqtë. Dhe atë, Ilirin, e kish zënë gjarpëri. Kur u fejua as që mendoi se ç'punë do të bënte gruaja e tij e ardhshme, veç as nëpër mend nuk i shkonte, që ajo do të ishte një punëtore e thjeshtë. Ka disa gjëra në jetë, që kuptohen vetiu. Baba i tij kish qenë ndihmësmjek. Ai vetë ishte arësimtar. Gruaja e tij mund të ishte një nëpunëse, një arësimtar...

Dhe shefi po të donte mund ta rregullonte. Gjatë kohës që Iliri po luftonte për t'i gjetur Driftës ndonjë nëpunësi, kish zbuluar se shefi i kish rregulluar, më të djathtë e më të mëngjér, ato që kish dashur. Kurse të tjerëve u thoshte: «punë?... ja, kombinati...»

— Tjetri!

Më në fund erdhi edhe radha e tij. Shefi i shkurtër, i zi, me një fytyrë të zgjatur përpara, qëndronte më këmbë prapa derës. Edhe Iliri qëndroi në këmbë para tij.

— Eh? — Shefi zgjati fytyrën drejt qytetarit.

— Unë erdha prapë...

Të dy supet e shefit lëvizën e u ngritën lart, ndërsa duart u mblohdhën para kraharorit. Ai s'foli asnjë fjalë.

— Erdha... — tha Iliri përséri...

Shefi dëgjonte e s'fiste. Shihte Ilirin e madh tek qëndronte para tij e sytë e vegjël i vetëtinin. Herë pas here një nënqeshje e lehtë i përthyente buzën e sipërme, po ai e shuanë shpejt dhe qëndronte serioz e i heshtur.

— Unë jua kam thënë — tha më në fund, — punë ka sa të duash... Ja ku është kombinat...

— Atë unë e di — ja preu Iliri e zëri i tij u drodh prej zemërimit. — Pse të punojë në

kombinat, — tha — kur mund tē punojë edhe nē ndonjë kopsht fëmije. Babanë e ka gati pér tē vdekur.

— Po s'ka vend... — e shefi i ngriti prapë sytë përpjetë e mblodhi duart para kraharorit.

— Gjékundi?

— Gjékundi.

— S'më besohet...

Supet e shefit përsëri lëvizën.

— Ç'tju them unë...

Gjithshka kishte mbaruar. Ai shef i vogël burokrat qëndronte aty, si një shkëmb guri, i palojtshém e përtëj tij nuk mund tē shihej asnë shkëndijëz shprese. Iliri e shikoi me një neveritje tē hapët. Shefi e ndjeu këtë e buza e lartme e tij lëvizi. Jo nga ironia. Kësaj radhe ajo u tkurr nga fyera e zemërimi. Ai zgjati dorën e kapi dorezën e derës. Deshi t'i binte qytetarit nē shpatulla, ashtu si tē tjerëve, po ky ishte shumë i gjatë. Ahere, duke zgjatur drejt Ilirit kokën e tij tē vogël, e shikoi nē sy e i tha:

— Klasa punëtore është klasa, që ndërton socializmin. Çdo gjë nē jetën tonë tē re e krijon ajo...

— S'kam ardhur që tē më japid mësim...

Shefi qeshi. Me sa duket, ai këtë priste.

— Jo, — tha — unë nuk ju jap mësim. Ju u jepni mësim fëmijëve. Po t'ju them tē drejtë, sa herë më keni ardhur këtu, kam thënë me vete: «Ç'mendon ky mësues pér punëtorët?» Dhe pa pritur asnë çast hapi derën.

— Tjetri! — thirri shefi.

Iliri nuk e kuptoi se si doli nga dera, se si kaloi midis turmës së njerëzve, që prisnin jashtë

dhe se si i zbriti shkallët e komitetit ekzekutiv. Thua se këmbët e tërhiqnin vetë atë trup të madh e të trullo sur. Doli në rrugë. Kërkoi paqetën e cigareve në xhep, e nxori. Bosh. Pështyti gjith inat dhe e hodhi tej. Ekte dhe gjithshka rreth tij lëvizte. Bashkë me të ecnin edhe ndërtesa e lartë e komitetit ekzekutiv, mapot e vetrinat karshi. Të gjitha e shoqëronin.

Toka luante. Që të mos binte, kërkoi të mbahej diku, po pranë tij s'kishte asgjë dhe një çast ai qëndroi mbi të dy këmbët e gjata pa lëvizur në mes të trotuarit.

Papandehur u ndodh para derës së dhomës së vet. Nxori çelësin, hapi derën dhe hyri brenda. Gjithshka e kryente pa ndërgjegje. Vetë këmbët e kishin sjellë atje, vetë duart e kishin hapur derën. U rrokullis i téri e ra në shtrat dhe mbuloi fytyrën me duar. Të mos shihte asgjë. Asgjë. As atë njollë të zezë, të gërryer lart në tavan. Me duart e veta shtrëngonte ballin fort. Ndjeu se i dhimbte. Ai prapë e shtrëngoi. Me dhëmbjen e jashtme kërkoi të mundte atë dhëmbjen e thellë, të brendshme. Shefi i vogël sikur e kishte kapur prej zverku, tamam ashtu si ne kapim një dëm. E ja kishte përdredhur e ja kishte përkulur kokën poshtë, që ta shihte më mirë veten e vet. Dhe ajo që ai pa atje nuk ishte shumë e kënaqshme. Ai pa se thellë në veten e tij nuk ishte vetëm ai Iliri i përditshëm, i sigurt në veten, në jetën, që gjithnjë kish menduar se e donte e i shërbente klasës punëtore edhe socializmit. Galuc, në nënshtresat e ndërgjegjes së tij, qëndronte edhe një Ilir tjetër, që me zili mbronte atë jetën e qetë, pa vuajtje e mendime të nëpunësit të vogël, në të cilën ai vetë kishte

lindur dhe ishte rritur dhe ku ai krimbi në më-shikësëndërronte të prodhonte vogëlushët e tij...

Dera u hap. Te praku i saj qëndroi Drita. Iliri e pa, por s'u ngrit nga shtrati. «Ja, edhe kjo», mendoi me vete. «Erdhi në kohën e duhur, thuase më ndjek pas...». Drita mbylli derën dhe, e heshtur, u ul në karrigë. Ajo e dinte që ato ditë Iliri kishte takim me shefin dhe që në shikimin e parë e kuptoi se ç'kishte ndodhur. Tani të dy ata qëndronin të heshtur, dhe shikonin njëri-tjetrin. Për një çast Drita i largoi sytë prej Ilirit. S'e duronte dot atë shikim të ftohtë e të rëndë të tij. Kurse ai shihte dhe mendonte se ç'i lidhte ata të dy. Përse ai duhej të shkont, nëpër dyert e shfave e ta ndjente veten para tyre si një kafshë e trullosur?

— U takove me shefin?

— U takova — tha ai.

Vajza deshi ta pyeste më, por heshti.

«Le të shkojë ku të dojë» mendoi Iliri. «Në kombinat, po të dojë. Ajo është njeri i lirë. Kështu thoshte gjithnjë. Le të shkojë pra ku të dojë». Po në atë minutë atij iu kujtua ajo shpatull e bardhë dhe e pa të derdhur si në statujë. Ai u mësua më të. Ai e donte atë.

— Unë po shkoj — tha Drita. — Iliri s'u përgjegj. Tani ai e kuptoi se të gjitha përpjekjet i kishte bërë e i bënte jo për atë Dritën që kërkonte të shkonte e të punonte në fabrikë, po për atë Dritën tjetër, me atë shpatull të bukur femërore, me atë aromë joshëse, që edhe në atë çast e ndjeu në hundët e veta. Dhe këtë ai nuk do të dëshëronte ta humbiste kurrë...

— Unë po shkoj — tha prapë Drita — në kombinat... — tha ngadalë.

— Ku?

Ai këceu nga shtrati e sakaq u gjend para saj.

— Ku do të shkosh? — Zëri i tij ishte i mbytur. Kurse ajo u përgjegj e qetë:

— Është e kotë, Ilir. Unë e kam menduar gjerë e gjatë... dhe e kam vendosur... Do shkoj të punoj dhe më duket e kotë që ti...

Ajo fliste ngadalë, e sigurt në vetëvete. Dhe, duke folur ashtu, u ngrit nga karriga e iu afroa derës për të dalë. Po atë çast Iliri shikoi derën, Dritën e pastaj veten. Dhe iu kujtua zyra e shefit të seksionit. Dhe atje ata kështu kishin qëndruar përballë njëri-tjetrit. Shefi i kish folur duke mbajtur dorezën me dorë, ashtu si Drita tani... Një forcë e huaj ja ngriti krahun dhe ai e kapi fort vajzën, mu aty ku e prekte gjithnjë, te ajo shpatull e bardhë. Dritës i dhëmbi dhe ajo u përkul. Iliri u çudit kur ndjeu nën pëllëmbën e vet, se si po deformohej ajo shpatull e statujt. Ky mendim e tërboi. E kuptoi se me dorën e tij kishte prishur gjënë më të dashur që kishte kjo femër. Dhe tani s'do të dëshëronte gjë tjetër veçse ta shkatërronte fare. Drita ndjente atë pëllëmbë burri, si një darë të hekurt, ta shtrëngonte fort, aty te qafa, dhe ta shkundte dhe ta ulte e pastaj ta ngrinte... Po ajo s'lëshonte asnjë zë. Vetëm shikonte Ilirin në sy e ftohtë, indiferente.

Dhe nuk e kuptoi as ajo se si u gjend në rrugë. Gjithshka kishte ndodhur papritur dhe ajo nuk ishte në gjendje të mendonte për asgjë. Vetëm thellë në ndërgjegjen e saj ndjente diçka të tur-

bullt e t   pap  ractuar. I dukej sikur e kishte parapar   se k  shtu do t   ndodhте. Dhe s  mund t   ndodhте ndryshe. S  duhej t   ndodhте ndryshe. Iliri ishte vet  m ai q   kishte njohur n   dhom  n e saj at   nat  , kur ajo qau... Vet  m ai. Kurse kjo e k  saj radhe... m   mir   q   kish ndodhur k  shtu.

M   mir   q   kish ndodhur k  shtu? Asaj di  ka iu p  rzie n   kok  . Dhe p  rmes asaj marr  mendjeje pa p  rs  ri at   dor  n e madhe e t   fuqishme ta mb  rthej   aty, n   shpatull, ku fillonte qafa e saj dhe ta shtr  ngoj   si nj   dar   e hekurt... Atje n   dhom   ajo vet  m e shikonte Ilirin n   sy e ftoht  , indiferente... Po atje, n   mes t   udh  s, ndjeu nj   ankth ta shtr  ngonte n   fyt. Dhe deshi t   th  rriste Dhe s  kuptonte as ajo se nga sa deshi t   th  rriste m   tepe  r: nga dh  mbja, apo nga fyerja...

Midis njer  zve pa q   drejt saj po vinte nj   vajz  . Kishte veshur nj   fustan blu me ca njolla t   bardha. Vajza ishte e gjat  . Ajo po afrohej dhe Drita s  po ja ndante syt  . Kur udh  tarja u afrua pran  , Drit  s iu duk sikur ato njolla t   bardha l  viz  n. Ajo u drodh «Patat e egra» murmuriti me vete. Po vajza humbi midis turm  s s   njer  zve. Drita u kthye, shpejtoi hapat dhe iu vu pas. Iu afrua s   panjohur  s af  r, fare af  r. Ecnin pothuaj krah nj  ra-tjetr  s. Dhe Drita shikonte se n  p  r at   sfond blu, n   trupin e vajz  s, patat e egra fluturonin. Dukej ecur, trupi i vajz  s l  vizte e patat fluturonin n  p  r t  , t   gjalla, ashtu si i kishte par   ajo dikur n  p  r qiel. Drita pa sesi, para gjoksit t   fryr   t   vajz  s, mblidhej nj   sht  llung   e holl   resh dhe n  p  r t   shtrihej krahu i ashp  r e i fuqish  m i shpendit, q   ishte shk  putur nga tufa e shoqeve t   saj. «Si ahene...» mendoi vajza me vete. Po n  

atë çast pa sesi një tjetër lëshohej fluturim, përdridhej nëpër quell dhe klithte. «Kënga e vetëtimave». Dhe vetë Drita lëshoi një si klithmë habie. Pastaj qëndroi, u kthye pas e u nis për në kombinat.

XVI

Ditët e usta Vangjelit ishin të numëruara. Sëmundja e kishte vënë te poshtë një herë e për gjithmonë. Këtë e kishte ndjerë edhe ai vetë. «Puna ime mori fund» i tha Dhoksisë. Po kjo e qortoi: «C'janë këto fjalë që thua, apo që të na dëshpërosh...» Po i sëmuri gjithnjë e më shumë po mblidhej në vetëvete. Frymë merrte gjithnjë më thellë e më rëndë. Dhe prapë ajri s'i mjaftonte. Sëmundja, si me grusht ja shtrëngonte kraharorin. E s'donte ta lironte. S'donte të largohej prej tij. Barërat nuk e lehtësonin më. Dhe plaku e kuptoi se tashmë ai kishte mbetur vetëm me sëmundjen, kurrkush tjetër nuk mund ta ndihmonte. Efigjeni e Drita i qëndronin te koka, po ç'mund t'i bënin ato? As mjeku s'mund ta ndihmonte më. Tani duhej të luftonte vetëm me sëmundjen. Ajo ishte e egër, kurse ai ishte i plakur e i drobitur. S'kishte më forca. Kur i zihej fryma, bënte shenjë ta ngrinin, apo t'ja ulnin jastëkun, t'i jepnin barërat. Dhe kaq. Nuk fliste. S'kishte dëshirë të bisedonte e të mendonte mbi asgjë. Një ditë e pyeti Dritën për Ilirin, po kjo s'i përgjegj. Dhe ai nuk e pyeti më. E harroi. Kurse një ditë tjetër u kujtua e tha, që t'i shkruanin Pirros të kthehej. Por ato nuk e lajmëruan. Menduan se ishte shpejt akoma. Njerëzit e njohin edhe hapin e vdekjes.

Që prapa oborrit Efigjeni dëgjoi këmbët e së

bijës e doli te dera. Drita kthehej nga puna. Në duar mbante dy letra me portokalle. Ajo i lëshoi ato në krahë të së emës.

— Na — i tha pastaj, duke i lënë në dorë të hollat.

— Ç'janë këto?

— Paga... sot mora pagën.

Efigjeni i shtrëngoi paret në dorën e saj të vogël. Mbështeti kokën te gjoksi i çupës e përnjë-hërësh qau. Zakonisht, edhe në vaj, ishte e heshtur, e papërmabjatur, si vetëjeta e saj në atë shtëpi të usta Vangjelit. Po kësaj radhe nëna qante me ngashërim, më zë, pa drojtje e pa turp. Dhe e mbështette kokën aty, te gjoksi i çupës së saj.

Për një kohë të gjatë ato ndenjën ashtu, në këmbë, brenda oborrit të shtëpisë. Më në fund Efigjeni tha:

— Ngjitu te babai, se është mirë...

Drita hyri në dhomë. I ati, i shtritur në shtrat, ishte mbështetur mbi katër palë jastëkë. Plaku ishte shumë i dobësuar e fliste ngadalë. Duart i mbante të shtrira dhe nuk i lëvizte fare.

— Erdhe? — e pyeti ai Dritën.

— Erdha... — dhe ajo i shkoi pranë, te ko-ka. — Si je sot?

Ai nuk u përgjegj. Efigjeni vazhdonte të qante.

— Ç'ka ajo që qan? — pyeti me një fije zëri plaku.

— Drita ka marrë rrögën — i tha Efigjeni e, duke i treguar të hollat, iu afrua te shtrati.

Usta Vangjeli shikoi të bijën në sy.

— Rroga e parë? — tha ai.

— Po...

— Si të duket puna?

— Po... mirë... unë jam mirë...

— Mund tē punosh?

— Pse tē mos punoj?

Plaku ngriti dorën e djathtë. Me zor kapi dorën e Dritës dhe, duke u dredhur, e vendosi pëllëm-bën e saj mbi sytë e tij. Babai ishte në agoni, po vajzës, duke qëndruar mbi tē, sesi iu duk. Shikonte dorën e madhe tē dobësuar, po prapë tē ashpër, tē babait. Pastaj dorën e saj. Mendonte se ato dy duar i lidhnin ata më shumë se çdo gië tjetër. Më shumë se ai fakt i thjeshtë, që atë, Dritën, e kish lindur ky nieri në jetë dhe jo dikush tjetër. Kurse plaku në këtë kohë i mbylli sytë dhe s'lëvizi më. Ndjeu se si po i ftoheshin këmbët, trupi. Mbi sytë e tij qëndronte pëllëmba e së bijës. Ai e donte çupën.

Efigjeni ulëriti.

Në duart e ftohta, tē kryqëzuara në krahor, tē usta Vangielit, teto Dhoksia vuri një tufë zambakësh tē bardhë.

— Ai vdiq baba i gjëzuar — tha aio.

Pastai teto Rina, teto Nasta e teto Dhoksia, së bashku, filluan tē qanin, tē ulërinin, duke i përshkruar Vangielit tē vdekur gjithë jetën, duke i numëruar mendimet e duke i treguar dashurinë e dhëmbjen e tyre.

Kur dikush i tha tet, Dhoksisë:

— Mjaft, s'ka lezet kështu...

Teto Nasta u hodh përnjëherësh:

— Kio është hera e fundit... ç'do tē marrë me vete, ky... ja, këtë vajtimin tonë.

Po xha Nasi thirri:

— Pushoni! Pse, për tē qarë është ai? — Dhe tregoi me dorë kufomën e shtruar në arkivol. — Ai është për t'u kënduar. Jetën e jetoi. Fëmijët i rri-

ti... Dhe pa largohuni ju tani — u tha grave. — Erdhi ora dhe i vdekuri do tē ngrihet.

Po pikérishit ahere ato ranë mbi tē vdekurin duke thirrur e lebetitur.

Si pushuan gratë, xha Nasi u ul i pari e, pas tij, tē tjerët që tē ngrinin arkivolin.

— Dale — i tha teto Dhoksia. — Ku është Pirrua? Po Drita? Bini fëmijët tē takohen pér hëré tē fundit me babanë.

Dhe fëmijët vajtën. Si djali, si çupa i puthën tē vdekurit dorën.

— Tani, po — tha teto Dhoksia.

Arkivoli u ngrit.

Turma e njerëzve, e heshtur, e ngadaltë, me kokën poshtë, doli prej shtëpie dhe filloi tē zbrësë kalldrëmin. Pirros i thanë tē qëndrojë atje, kurse Drita nguli këmbë që tē shkonte në vorreza. Sa doli në kalldrëm, ajo pa xha Nasin, që ja la cepin e arkivolit një tjetri.

«U lodh» mendoi me vete.

Kur zbriti arkivoli poshtë e po ecte nëpër atë rrugën e xhokaxhinje, traktorët e buldozerët e kantierit e ndalën punën. Punëtorët, tē heshtur, me kapelën e tyre në dorë, qëndronin më tē dy anët e rrugës e nderonin kalimin e tē vdekurit. Ahere Drita pa se, në vendin e xha Nasit, kishte qëndruar Kristua, që i kishte vënë supin arkivolit. Tre burrat e tjerë që mbanin mbi supet e tyre nga një cep tē arkës ajo nuk i njihte. Kur ktheu kryet pas, vajza u çudit. Arkivolin e shoqëronte një turmë e madhe njerëzish. Teto Nasta, teto Rina e teto Dhoksia dhe ata pak fqinjë tē përhershëm tē mëhallës humbisnin e shkriheshin me atë lumë tē vërtetë punëtorësh e punëtoresh,

që kishin vajtur për të përcjellë «në banesën e fundit» babanë e saj.

Drita pa arkivolin dhe pastaj atë turmë të pambaruar punëtorësh dhe sesi i erdhi. Ju kujtua babai, punëtor, i palodhur, familjar, por që kurdo dhe kudo mbeti po ai, usta Vangjeli. Pastaj pa këta punëtorë, të cilët ai nuk i kuptonte... «Si qenkajeta!», murmuriti Drita me vete. «Këta punëtorë po e mbajnë tani atë, të vdekur mbi supe... Gjatë gjithë jetës së vet babai nuk kishte parë dhe nuk ishte miqësuar, veçse në një grusht njerëzish... Kurse ajo, Drita, i solli atij në varrim një lumë të tërë njerëzish. Dhe ata po e mbanin mbi supet e tyre atë, sepse, në fund të fundit, ajo Drita, punëtorja e re e kombinatit, shoqja e tyre, ishte e bija e tij, «mish i mishit» të tij. Nëpërmjet saj, usta Vangjeli, ndofta pa e ditur dhe pa e kuptuar as vetë, u kishte dhënë atyre punëtorëve atë ndjenjë të përhershme, të pashlodhshme dashurie për punën dhe për njerëzit.

Në vorrezat, së bashku me të tjerët, dhe ajo hodhi një grusht dhe mbi arkivolin e të atit. Pastaj atë e mbuluan e njerëzit filluan të largoheshin. Ajo mbeti pas. E vetme. Pranë saj s'ishte kurrkush. Ajo dhe i ati, atje nën dhe. Ahere Drita u ul në gjunjë e qau. Me ngashërim. Pa pushuar. Qau mbi të atin sa u lodh. Dhe vetëm vonë ndjeu mbi supet një dorë, që e tundi. U kthyte e pa Laureshën me Kriston.

— Mjaft më... shkojmë?

Më tej ishte Iliri. Ai qëndronte larg, i heshtur.

— Mirë...

Drita u ngrit dhe ata të katër u larguan nga vorrezat.

I ra rrufeja lisit të madh të pyllit. Dhe e theu. Dhe e dogji. Goditi rrufeja shkëmbin e ashpër të malit. Dhe e çau. Dhe e thérmoi. Qëlloi rrufeja njerinë... ky e duroi. Njeriu i vogël e i brishtë, i vetëm, nguli fort të dy këmbët në tokën e tij e dëgjoi mbi të të shkrepë rrufeja... Ai u godit, po s'ra. U lëkund, po s'u përbys...

Vdekja e usta Vangjelit ishte një rrufe, që ra mbi atë shtëpi. Ishte vdekja e parë dhe ata fëmijë nuk e njihnin fytyrën e saj.

— Korba unë! — kishte thirruar Efigjeni, kur Vangjelin e kishin varrosur e kur miq e shokë, që ditë e net të tëra kishin ndenjur me ta për t'i ngushëlluar e për të mos i lënë vetëm me dhimbjen e tyre, dalëngadalë filluan të largohen e të rrallohen... — Korba unë, — kishte thirrur Efigjeni — m'u zbulua çatia e shtëpisë!..

Por kur më në fund ata të tre mbetën vetëm e u shtruan të hanin darkë rrreth tryezës, Efigjeni pa Pirron të rritur e të burrëuar dhe zemra iu drodh prej gëzimit.

«Eshtë rritur, si ndonjë lis» mendoi — ... «dhe nën hijen e tij mund të jetojmë edhe ne dy femra».

Efigjeni shikoi nga Drita. Çupa, e heshtur, hante darkë nxituar. Që nga ajo ditë që i kishte vdekur i ati, ajo nuk kishte shkuar në punë. Atë natë do të shkonte në turnin e mbrëmjes.

Kujtimi i vdekjes ishte akoma i freskët në zemrat e njerëzve. Plaga akoma ishte e hapët dhe e gjakosur. Ata hanin të heshtur e askush nuk donte të fliste për babanë, nuk donte ta kujtonte. Bisedonin për tetë Dhoksinë, për xha Nasin, për punëtorët, që, pa i thirrur kush, erdhën përnjë-

herë aty, me ta në atë dhëmbje. Dhe kështu bisodonin për jetën, për të gjallët. Vdekja mbetej diku tutje, larg.

Drita doli prej kuzhine e shkoi në dhomën e vet; rregulloi çantën e punës, e vendosi mbi tryezën e vogël dhe u shtri në shtrat. Po nuk i rrihej. U ngrit. Shkoi te dritarja e hapi kanatet. Jashtë binte një shi i lehtë, i imtë. Buldozeri punonte në rrugën e xhokaxhinje e dritat e prozhektorëve e të llambave të kantierit, të qullura, vezullonin në-për shi. Vajza qëndronte në këmbë, te dritarja. Shihte shiun që binte, kantierin dhe më tej lumin, që gjarpëronte e rridhëte, si gjithnjë. Nga gjëmimi i thellë e i papërmabjatur, ajo e kuptoi se shirat e kishin fryrë lumin që tani rridhëte midis qytetit, nën urën e tutje pishave. Drita e ndjeu veten të vetme e të zbrazët. Gjithshka që ajo shikonte jashtë dritares së saj, nuk kishte më atë shije e atë kuptim të mëparshëm. Midis botës së jashtme e asaj, Dritës, qëndronte Iliri, qëndronte usta Vangjeli, që i ndante. Ajo e ndjente këtë ndarje, këtë zbrazësirë. Dhe, duke qëndruar në këmbë te dritarja, i dukej sikur po qëndronte te buza, te par-maku i asaj zbrazësire.

— Drita, shkojmë?

Ishë Lauresha, që fliste nga poshtë. Tani ato kishin turnin e punës dhe Dritës iu duk sikur zëri i shoqes mbushi përnjëherësh atë zbrazësirë mbi të cilën qëndronte. U përkul e shkoi jashtë dritares. Turmat e punëtorëve po shkonin për punë. Një rrymë mornicash përshkoi gjithë qenjen e saj. Drita kapi fort flokët e i shtrëngoi, i shtrëngoi dhe ndjeu një gëzim. Dhe ndjeu një çlodhje.

— Pritmë — i tha Laureshës. — Tani po vij.

Tirazhi 8000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-65

Shtyp. NISh Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti «8 NËNTORI» — Tiranë, 1970